


# Promovimi i qasjes shumë-palëshe në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm

*Raport përmbledhës i diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta për Strategjinë Kombëtare për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut*



Publikuar nga Njësia për Monitorim e Misionit të OSBE-së në Shkup (2019).

Raporti origjinal është i shkruar në gjuhën angleze.

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem rikthimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo mënyre - elektronike, mekanike, përmes fotokopjimit, regjistrimit ose ndryshe - pa miratimin paraprak me shkrim të botuesve. Ky kufizim nuk vlen për të bërë kopje digjitale ose të shtypura në letër të këtij botimi për përdorim të brendshëm brenda OSBE-së, dhe për përdorim personal ose arsimor kur kjo bëhet për qëllime jofitimprurëse dhe jotregtare, me kusht që në kopje të shënohet se OSBE-ja është burim i tij.

Misioni i OSBE-së në Shkup

Bulevari 8-mi septemvri nr.16, MK-1000 Shkup

[osce.org/skopje](http://osce.org/skopje)

ISBN 978-608-4788-50-8

Materialet në këtë publikim janë vetëm për referencë më të lehtë Megjithëse Misioni i OSBE-së në Shkup i ka kushtuar kujdes maksimal zhvillimit të tij, ai nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe tërësinë e çfarëdo informacioni, udhëzimi dhe këshille të dhënë ose për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në të nuk e pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, nuk mund të bëhet asnjë pretendim kundër OSBE-së në lidhje me pasojat e mundshme nga mbështetja në informacionet ose konkluzionet e përfshira në këtë publikim.



Organizata për Siguri dhe  
Bashkëpunim në Evropë  
**Misioni në Shkup**

---

## **Promovimi i qasjes shumë-palëshe në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm**

*Raport përmbledhës i diskutimeve në tryeza të rumbullakëta  
për Strategjinë Kombëtare për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të  
Dhunshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

---

**Autorët:**

Alush Doda

Marina McLellan

**Dizajni dhe printimi:**

Polyesterday

**Tirazhi:**

100 kopje

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека «Св. Климент Охридски», Скопје

316.647.7(497.7-21)(062)(047)

316.647.7:352(497.7)(062)(047)

МКЛЕЛАН, Марина

Promovimi i qasjes shumë-palëshe në parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm : raport përmbledhës i diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta për strategjinë Kombëtare për kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut / [Марина Мклелан и Алуш Дода ; преведувач Валон Абдиу]. - Shkup : OSBE, 2020. - 86 стр. ; 25 см

Наслов на оригиналот: Promoting a multi-stakeholder approach to preventing and countering violent extremism and radicalization that lead to terrorism : summary report of roundtable discussions on the National strategy for countering violent extremism in the Republic of North Macedonia

ISBN 978-608-4788-50-8

1. Дода, Алуш [автор]

а) Насилен екстремизам - Спречување - Локална заедница - Македонија - Собири - Извештаи б) Насилен екстремизам - Спречување - Локална самоуправа - Македонија - Собири - Извештаи

COBISS.MK-ID 51407365

# Përmbajtja

Akronimet dhe shkurtesat	6
Fjalorth	7
<b>1. Hyrje</b>	<b>11</b>
<b>2. Metodologjia e tryezave të rrumbullakëta me palët e interesuara lokale</b>	<b>19</b>
<b>3. Gjetjet</b>	<b>25</b>
3.1. Ekstremizmi i dhunshëm në kontekstin lokal	25
3.2. Fuqizimi i shoqërisë civile dhe shkëmbimi i praktikave më të mira	27
3.3. Bashkëpunimi midis komunës dhe komunitetit	29
3.4. Ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve dhe qeverisë	31
3.5. Roli i komuniteteve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm	33
3.6. Arsimi dhe mbështetja e të rinjve në rrezik	36
3.7. Mirëqenia sociale dhe shëndeti mendor	38
<b>4. Përfundime dhe rekomandime</b>	<b>41</b>
4.1. Kapacitetet për qasjen që e përfshin gjithë shoqërinë ndaj P/KEDhRÇT	41
4.1.1. Punonjës të trajnuar si duhet	41
4.1.2. Infrastruktura	42
4.1.3. Financat	43
4.2. Bashkëpunimi ndërinstitucional	44
4.3. Koordinimi midis autoriteteve qendrore dhe lokale	45
<b>5. Praktikrat më të mira të rekomanduara për programin P/KEDhRÇT</b>	<b>49</b>
<b>6. Bibliografia</b>	<b>53</b>
SHTOJCA I: TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË ÇAIR (26 nëntor 2018)	54
SHTOJCA II: TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË GOSTIVAR (21 nëntor 2018)	61
SHTOJCA III: TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË KUMANOVË (3 dhjetor 2018)	67
SHTOJCA IV: TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË STRUGË (5 dhjetor 2018)	74
SHTOJCA V: TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË TETOVË (19 nëntor 2018)	80



## Mirënjohje:

Misioni i OSBE-së në Shkup dëshiron t'i falënderojë anëtarët e Misionit, Alush Doda dhe Marina Mclellan, për zhvillimin dhe përpilimin e përbashkët të përmbajtjes së këtij publikimi dhe për dizajnimin, zhvillimin dhe zbatimin e aktiviteteve që çuan në përpilimin e tij.

Misioni i OSBE-së në Shkup gjithashtu dëshiron t'i falënderojë partnerët tanë, Borçe Petrevski, Koordinator kombëtar për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe kundërvënien ndaj terrorizmit; Xheladin Ajvazi, Zëvendës-koordinator kombëtar për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm; Zlatko Apostoloski, Zëvendës-koordinator për kundërvënien ndaj terrorizmit; Marija Mihajlloska Jankullovska, Komiteti Kombëtar për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe kundërvënien ndaj terrorizmit; partnerin tonë implementues, Qendrën për Hulumtime dhe Krijim të Politikave, në veçanti Marija Risteska, Ivan Stefanovski dhe Aleksandar Cekov; dhe Petar Arsovski.

Dëshirojmë të shprehim mirënjohje për pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta për kontributin dhe bashkëpunimin e tyre, dhe t'i shprehim mirënjohje të veçantë Njësisë Monitoruese të Misionit të OSBE-së në Shkup për mbështetjen e tyre.

# Shkurtesat

<b>KMNB</b>	Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive
<b>QHKP</b>	Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave
<b>OShC</b>	Organizatat e shoqërisë civile
<b>KT</b>	Kundër terrorizmi
<b>KEDh</b>	Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm
<b>LHT</b>	Luftëtar i huaj terrorist
<b>TIK</b>	Teknologjia e informacionit dhe komunikimit
<b>IOM</b>	Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
<b>BFI</b>	Bashkësia Fetare Islame
<b>KLP</b>	Këshilli Lokal i Parandalimit
<b>KOM</b>	Kisha Ortodokse Maqedonase
<b>KKKEDhKT</b>	Komisioni Kombëtar për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>P/KEDhRÇT</b>	Parandalimi dhe kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>EDhRÇT</b>	Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi që çon në terrorizëm



## Fjalorth

Ky fjalorth shërben për t'i qartësuar shprehjet kryesore të përdorura në këtë raport. Përkufizimet janë vetëm për qëllimet e këtij raporti dhe nuk janë përkufizime zyrtare të OSBE-së.<sup>1</sup>

**Komuniteti** – gratë, burrat, grupet shoqërore dhe institucionet që janë të vendosura në të njëjtën zonë dhe/ose kanë interesa të përbashkëta.

**Shoqëria civile** – grup i shumëllojshëm i aktorëve civilë, komuniteteve, si dhe i shoqatave formale apo joformale me një spektër të gjerë rolesh, që angazhohen në jetën publike duke kërkuar avancimin e vlerave dhe qëllimeve të përbashkëta.

**Aktorët e shoqërisë civile** – përfaqësuesit kyç të komunitetit, duke i përfshirë gratë, të rinjtë, udhëheqësit e komunitetit dhe udhëheqësit fetarë, që janë në gjendje të japin kontribute të efektshme dhe afatgjata për mirëqenien e shoqërisë.

**Policimi në komunitet** – një filozofi dhe strategji organizative që promovon partneritete midis forcave policore dhe publikut për ta rritur identifikimin efektiv dhe efikas, parandalimin dhe zgjidhjen e problemeve të krimit, dhe i trajton shqetësimet në lidhje me sigurinë fizike, çrregullimet sociale dhe katandisjen e lagjeve në mënyrë që të përmirësohet cilësia e jetës për të gjithë.

**Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm** – veprimet proaktive për të kundërshtuar përpjekjet e ekstremistëve të dhunshëm për t'i radikalizuar, rekrutuar dhe mobilizuar ndjekësit për t'u përfshirë në akte të dhunës dhe për t'i trajtuar faktorët specifikë që e lehtësojnë dhe e mundësojnë rekrutimin e dhunshëm ekstremist dhe radikalizimin për përdorim të dhunës.

**Luftimi i terrorizmit** – politikat, ligjet dhe strategjitë e zhvilluara nga aktorët shtetërorë dhe të zbatuara kryesisht nga organet për zbatimin e ligjit, agjencitë e zbulimit, e nganjëherë edhe nga ushtria, që synojnë pengimin e kompleteve terroriste dhe shpërbërjen e organizatave terroriste.

**„Luftëtarë të huaj terroristë“** – zakonisht përdoret për t'iu referuar individëve që kanë udhëtuar nga shtetet e tyre të origjinës në shtetet e tjera për të marrë pjesë ose për t'i

1 Për më shumë informacion mbi terminologjinë për P/KEDhRÇT, ju lutemi shihni udhëzuesin e OSBE-së "Të kuptuarit e mekanizmave referues për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Kapërcimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut Udhëzues për Evropën Juglindore", gjendet në: <https://www.osce.org/secretariat/418274?download=true>

mbështetur aktet terroriste, duke përfshirë në kontekstin e konflikteve të armatosura, veçanërisht në Irak dhe Siri, siç përshkruhet në Rezolutën 2178 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të vitit 2014. Kjo shprehje është kontestuar për shkak të gjerësisë, paqartësisë dhe çështjeve të lidhura me të drejtat e njeriut.

**Ish-ekstremistë të dhunshëm** – individë që janë larguar nga rruga e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm dhe të cilët mund të kenë një rol të dobishëm në ngritjen e vetëdijes dhe në tregimin e kundër-narrativeve të besueshme.

**Perspektiva gjinore** – vetëdija dhe marrja parasysh e nevojave, përvojave dhe statusit të ndryshëm të grave dhe burrave në bazë të kontekstit socio-kulturor.

**Programet e ndërhyrjes** – programe që synojnë grupet e rrezikuara dhe kërkojnë të ndërhyjnë në rrugën e një personi drejt radikalizmit terrorist përpara se të kalojë vija e veprimtarisë kriminale. Llojet e programeve që i përkasin kësaj kategorie ndonjëherë quhen edhe „rrugë dalje“ ose „programe dalje“. Programet janë vullnetare dhe përfshijnë mekanizma referimi, mbështetje psikosociale, mentorim, debate teologjike/doktrinare, trajnim dhe mbështetje për edukim dhe punësim, etj.

**Programimi i parandalimit** – programe që kërkojnë të zvogëlojnë mesazhin tërheqës të ekstremizmit të dhunshëm dhe të ndërtojnë rezistencë ndaj ndikimit dhe përhapjes së tij. Llojet e programeve që mund të bien në këtë kategori janë: ngritja e vetëdijes për kërcënimin e ekstremizmit të dhunshëm në shkolla, fushatat e informimit publik dhe debatet në komunitet, dialogjet ndërfaqetare dhe ndërmjet feve të njëjta, ngritja e kapaciteteve të mësuesve dhe udhëheqësve të komunitetit në identifikimin dhe mbështetjen e atyre që janë të cënueshëm ndaj radikalizmit, mesazhet mediatike dhe fushatat me narracion të kundër/alternativ, dhe ndërtimi i besimit të komunitetit ndaj organeve të zbatimit të ligjit, etj.

**Faktorët mbrojtës** – karakteristikat ose kushtet pozitive që mund t'i zbusin efektet negative të faktorëve të rrezikut dhe kujdesen për individë, familje dhe komunitete më të shëndetshme, duke e rritur kështu sigurinë dhe mirëqenien personale dhe/ose të komunitetit. Këta faktorë mund të përfshijnë menaxhimin e pritshmërive, rrjetet pozitive familjare ose shoqërore, njohuritë fetare, arsimin që mëson për tolerancë dhe respektimin e të tjerëve, dhe një treg më të drejtë pune.

**Radikalizmi që çon në terrorizëm** – procesi dinamik me të cilin një individ e pranon dhunën terroriste si mënyrë e mundshme, ndoshta edhe legjitime, e veprimit. Eventualisht, mirëpo jo detyrimisht, kjo mund të çojë në atë që personi të përfaqësojë për terrorizëm, të veprojë në mbështetje të terrorizmit ose të përfshihet në terrorizëm.

**Programet e rehabilitimit** – programe që i synojnë individët e radikalizuar për përdorim të dhunës dhe ndoshta familjet e tyre në faza të ndryshme të radikalizmit.

Llojet e programeve përfshijnë edhe programe të deradikalizimit/shkëputjes nëpër burgje dhe të kujdesit pas krimit, që fokusohen në rehabilitimin dhe riintegrimin e autorëve të veprave terroriste dhe luftëtarëve të huaj që janë kthyer dhe rifutjen e tyre në shoqëri. Disa programe ofrojnë trajnim arsimor dhe profesional, këshillim, mundësi punësimi dhe riedukim ideologjik, etj.

**Personat e referuar** – i përfshijnë individët të cilët janë referuar (drejtuar) në programe shumë-palëshe dhe që shfaqin sjellje që duhet të vëzhgohen që mund të jenë tregues se mund të jenë në rrezik ose të cenueshëm për t'u angazhuar në EDhRÇT ose tashmë mund të jenë në rrugë drejt EDhRÇT. Personat e referuar gjithashtu i përfshijnë individët të cilët programi ia referon ndonjë agjencie, institucioni, organizate ose profesionistëve për ndërhyrje apo mbështetje tjetër pas vlerësimit profesional të rreziqeve, dobësive dhe faktorëve mbrojtës të individit.

**Mekanizmi i referimit** – mekanizëm formal apo joformal që i përfshin praktikuesit dhe profesionistët e disiplinave dhe/ose agjencive dhe organizatave të ndryshme që synojnë t'i identifikojnë, vlerësojnë, ndihmojnë dhe trajtojnë ata individë që tregojnë shenja të rrezikut ose të cenueshmërisë ndaj angazhimit në EDhRÇT ose tashmë mund të jenë në rrugë drejt EDhRÇT.

**Qëndrueshmëria** – aftësia për t'i bërë ballë, për t'iu përgjigjur dhe për t'a rimarrë veten nga një spektër i gjerë i ngjarjeve të dëmshme dhe të pafavorshme.

**Vlerësimi i rrezikut** – procesi që përfshin grumbullimin sistematik dhe interpretimin e informacionit që i përket një individit për të siguruar të dhëna për profesionistët e trajnuar në mënyrë adekuate për të marrë vendime të rëndësishme për gjasat që një individ i caktuar të angazhohet në veprime të dëmshme dhe për ta vlerësuar natyrën dhe ashpërsinë e dëmit.

**Mjeti i vlerësimit të rrezikut** – kornizë për grumbullimin e të dhënave për të ndihmuar në marrjen e vendimit, e cila ofron një metodë jodiskriminuese për ta shqyrtuar në mënyrë të strukturuar prirjen e një individit për të shkaktuar dëm, si dhe natyrën dhe ashpërsinë e atij rreziku, duke u bazuar në informacionin e disponueshëm nga burime të shumfishta.

**Faktor i rrezikut** – çdo tipar si p.sh. besimi, pamja, përvoja ose mjedisi, që i rrit gjasat për të ndodhur rezultati që matet (p.sh., që një individ të angazhohet në EDhRÇT).

**Qasja që përfshin gjithë shoqërinë** – një qasje ndaj parandalimit dhe kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm që mbështetet nga krijuesit e politikave dhe profesionistët që parashikon një rol për sektorë të shumtë dhe aktorë të shoqërisë civile në programet e parandalimit, ndërhyrjes, si dhe deradikalizimit/shkëputjes dhe rehabilitimit.







# 1. HYRJE

Përhapja e ekstremizmit të dhunshëm vazhdon të përbëjë një sfidë serioze globale të cilën OSBE-ja është e përkushtuar ta parandalojë dhe t'i kundërvihet përmes qasjes së saj gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë, duke siguruar se respektohen të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Rritja e shpejtë e Daesh-it/ISIS-it në Irak dhe Siri rezultoi me qindra luftëtarë të huaj terroristë që u larguan nga Ballkani Perëndimor për ta mbështetur kauzën e tyre, duke përfshirë edhe rreth 110 qytetarë nga Republika e Maqedonisë së Veriut, numër ky që mund të jetë edhe më i lartë duke pasur parasysh se nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare të fundit.<sup>2</sup> Shpërbërja e shumë strehëve të sigurta të Daesh-it që nga viti 2017 ka krijuar gjithashtu një numër të ri sfidash për shkak të fluksit të kthimit të luftëtarëve të huaj terroristë në rajon.

Në të njëjtën kohë, kërcënimi i ekstremizmit të dhunshëm vazhdon të evoluojë, me shfaqjen e formave të reja - të tilla si lëvizjet e ekstremizmit të djathtë dhe nacionalizmi ekstrem - që i polarizojnë edhe më shumë shoqëritë dhe gjithashtu mund të çojnë në dhunë të bazuar në komunitet. Deklarata e Këshillit të Ministrave të OSBE-së 4/15 pohon se terrorizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk mund të lidhen me ndonjë racë, etni, kombësi ose fe.

Është pranuar gjerësisht se ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi që çon në terrorizëm (EDhRÇT) është një problem i ndërlikuar me dimensione transnacionale, megjithatë shtytësit dhe zgjidhjet e tij janë të lidhura ngushtë me kontekstin në të cilin ai ekziston. Përveç qeverive kombëtare që luajnë një rol kryesor në koordinimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të parandalimit të hershëm, OSBE-ja gjithashtu e pranon nevojën se palët e interesuara lokale duhet të vendosen në krye të përpjekjeve të parandalimit.<sup>3</sup>

2 Strategjia Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm citon informacionin e mbledhur në vitin 2016, i cili thotë se numri i luftëtarëve të huaj terroristë që janë larguar nga vendi është 110. Shihni faqen 16 të Strategjisë Kombëtare për KEDh, që gjendet këtu: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/cve\\_national\\_strategy\\_eng\\_translation\\_sbu.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/cve_national_strategy_eng_translation_sbu.pdf)


3 Roli i shoqërisë civile për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çon në terrorizëm, Një udhëzues për Evropën juglindore, Gusht 2018 [https://www.osce.org/files/f/documents/8/d/411689\\_0.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/8/d/411689_0.pdf)

## Rëndësia e qasjes shumë-palëshe për ta parandaluar dhe për t'iu kundërvënë EDhRÇT-së

Në përputhje me praktikatat më të mira të vendosura në OSBE, P/KEDhRÇT-ja kërkon një qasje gjithëpërfshirëse duke inkuadruar institucione të ndryshme dhe shoqërinë civile së bashku me komunitetet lokale. Në veçanti, qasja e bazuar në shëndetin publik ndaj programeve të parandalimit ofron mundësi që praktikantët të përdorin mësimet të nxjerra nga fusha e parandalimit të sëmundjeve përmes iniciativave shumë-palëshe për t'i identifikuar faktorët e rrezikut dhe ata mbrojtës, për ta ndërtuar qëndrueshmërinë e komunitetit dhe për të promovuar sjellje të shëndetshme përmes angazhimit në komunitet.

Kur këto praktika shumë-palëshe kombinohen me përpjekjet e drejtuara nga komuniteti për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, kanë avantazhin e përfshirjes së gjerë të punonjësve socialë, punonjësve të shëndetit mendor, psikologëve dhe punonjësve të tjerë shëndetësorë, të cilët gjithnjë e më shumë po përfshihen në përpjekjet për ta zvogëluar dhunën në komunitete.<sup>4</sup>

**Figura 1. Modeli i Shëndetit Publik për P/KEDhRÇT**



Burimi: Jonathan Challengren dhe të tjerët, *Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm: Aplikimi i Modelit të Shëndetit Publik*, botimi i parë. (Universiteti Xhorxhtaun, Qendra për Studime të Sigurisë, Grupi i Punës për Çështjet Kritike të Sigurisë Kombëtare, 2016), <http://georgetownsecuritystudiesreview.org/wp-content/uploads/2016/10/NSCITF-Report-on-Countering-Violent-Extremism.pdf>. Terminologjia e përdorur në figurë nuk përputhet domosdoshmërisht me atë të OSBE-së.

<sup>4</sup> Understanding Referral mechanism in Preventing and Countering Violent Extremism and Radicalization That Lead to Terrorism Navigating Challenges and Protecting Human Rights A Guidebook for South-East Europe <https://www.osce.org/secretariat/418274>

Përdorimi i qasjes që përfshin gjithë shoqërinë i njeh rrënjët shoqërore të fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe lejon ndërhyrje të hershme dhe zgjidhje jo-detyruese kur individët ose komunitetet janë në rrezik duke i adresuar faktorët që janë të favorshëm për EDhRÇT-në.<sup>5</sup> Identifikimi i zgjidhjeve të qëndrueshme për ndërtimin e rezistencës ndaj EDhRÇT-së, gjithashtu kërkon një zhvendosje nga qasjet e kaluara të udhëhequra nga siguria drejt një theksi më të madh në parandalimin me bazë në komunitet. Prandaj, përpjekjet për P/KEDhRÇT kërkojnë që t'i mobilizojnë dhe t'i fuqizojnë palët e interesuara, të cilat nuk janë të lidhura tradicionalisht me sigurinë kombëtare.<sup>6</sup>

Për dallim nga kundërvënien ndaj terrorizmit, e cila përdor një qasje represive në trajtimin e hapësirës kriminale, P/KEDhRÇT-ja për nga natyra është jo-detyruese dhe përqendrohet në parandalimin dhe kundërvënien e proceseve të radikalizimit që mund të çojnë në terrorizëm. Pasi që përpjekjet e P/KEDhRÇT-së ndërmerren në hapësirën para-penale, ato nuk përfshijnë ndjekje penale, arrestime ose masa të tjera represive.<sup>7</sup> Qëllimi i P/KEDhRÇT-së është që, në përputhje me rrethanat, të mos merret me individët të cilët tashmë kanë kaluar në fushën kriminale, gjegjësisht planifikimin ose ndërmarrjen e aktiviteteve terroriste, por të ndërtojë qëndrueshmëri midis komuniteteve që shihen si potencialisht të cenueshme ndaj mesazhit tërheqës të ekstremizmit të dhunshëm dhe t'u ndihmojnë individëve të gatshëm të shkëputen nga ekstremizmi i dhunshëm dhe të ri-integrohen në komunitetet e tyre.

P/KEDhRÇT-ja përqendrohet në adresimin dhe zvogëlimin e problemeve dhe kushteve strukturore sociale, ekonomike dhe politike, që mund të jenë të favorshme për ekstremizmin e dhunshëm. Ekstremistët e dhunshëm shpesh përpiqen të nxisin urrejtje individuale dhe kolektive, duke promovuar intolerancë ndaj diversitetit dhe duke krijuar përçarje shoqërore. Prandaj, mbështetja e zhvillimit të komuniteteve rezistuese dhe kohezive në aspekt shoqëror, mund të jetë mbrojtja më e mirë për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm që në rrënjë. Duke punuar së bashku, komunitetet mund t'i kundërvihen mesazhit të dëmshëm të ekstremizmit të dhunshëm duke promovuar tolerancën, respektin e ndërsjellë, pluralizmin, inkluzionin dhe kohezionin. Në fund, përpjekjet e P/KEDhRÇT-së duhet të përqendrohen në mirëqenien dhe sigurinë e komuniteteve dhe të individëve.

5 OSBE, Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që Çon në Terrorizëm: Ide, Rekomandime dhe Praktika të Mira nga rajoni i OSBE-së, Peter Neumann, 28 shtator 2017, qasur në <https://www.osce.org/chairmanship/346841?download=true>.

6 OSBE, Roli i shoqërisë civile për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Fokusi në Evropën Juglindore, gusht 2018, qasur në, <https://www.osce.org/secretariat/400241?download=true>.

7 OSCE, Understanding referral mechanisms in preventing and countering violent extremism and radicalization that lead to terrorism: Navigating Challenges and Protecting Human Rights: A Guidebook for South-Eastern Europe, April 2019, accessed at: <https://www.osce.org/secretariat/418274?download=true>

Përpjekjet e P/KEDhRÇT-së përfshijnë një spektër të gjerë të programeve që mund të përfshijnë, për shembull, ngritjen e vetëdijes, ngritjen e kapaciteteve, mesazhet me narrativë kundërshtuese dhe alternative, programet e dedikuara për shkollat, aktivitetet jashtë-mësimore (p.sh. klubet rinore dhe sportive), mentorimin nga udhëheqësit fetarë dhe të komunitetit, dhe ndërhyrjet e përshtatura individuale, të organizuara nga institucionet publike lokale dhe ofruesit e shërbimeve psiko-sociale. Këto aktivitete mund të kategorizohen në bazë të asaj se a i përkasin parandalimit, ndërhyrjes, ose rehabilitimit dhe riintegritimit.<sup>8</sup>

### *Arsyeja për mbajtjen e tryezave të rrumbullakëta në nivel lokal*

Në shkurt të vitit 2018, Misioni i OSBE-së në Shkup, në partneritet me Ambasadën Britanike, mundësoi mbajtjen e dy tryezave të rrumbullakëta për konsultim publik me palët e interesuara lokale për të informuar për hartimin e Strategjive dhe Planeve të rishikuara Aksionale të qeverisë për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm (KEDh) dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit (KT), në kuadër të Komitetit Kombëtar për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit (KKKEDhKT). Kjo përpjekje për një proces konsultativ të hartimit të dokumenteve të përmendura më lartë ishte e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe një nga shembujt e paktë të tillë në nivel global.

Pas miratimit të Strategjisë Kombëtare, Misioni organizoi një sërë tryezash të rrumbullakëta me aktorët kryesorë lokalë në vjeshtën e vitit 2018, si pjesë e një fushate strategjike të komunikimit në mbështetje të KKKEDhKT-së për ta shpërndarë Strategjinë. Me pjesëmarrjen e koordinatorit kombëtar, tryezat e rrumbullakëta shërbyen për të avancuar transparencën dhe për të siguruar qëndrueshmëri në përcjelljen e mesazhit të strategjisë në nivel lokal. Tryezat e rrumbullakëta u organizuan në dhjetë komuna të shpërndara gjeografikisht: Çair (Shkup), Gostivar, Kërçovë, Kumanovë, Prilep, Shtip, Strugë, Strumicë, Tetovë dhe Veles.

Për të promovuar një qasje shumë-palëshe, të bazuar në komunitet, për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe të Planit Aksional, tryezat e rrumbullakëta u përpoqën të përfshijnë pjesëmarrje të përfaqësuesve nga administrata komunale, shoqëria civile, institucionet lokale, edukatorët, ofruesit e shërbimeve të kujdesit psiko-social, rinia, udhëheqësit fetarë dhe anëtarët e tjerë me ndikim të komunitetit lokal.

<sup>8</sup> OSBE, Roli i shoqërisë civile për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Fokusi në Evropën Juglindore, gusht 2018, qasur në, <https://www.osce.org/secretariat/400241?download=true>.



## *Qëllimet e tryezave të rrumbullakëta*

Përveç ngritjes së vetëdijes së palëve të interesuara lokale për rreziqet e EDhRÇT-së, qëllimi kryesor i tryezave të rrumbullakëta ishte të nxiste ndjenjën e pronësisë dhe të përfshirjes së institucioneve vendore, shoqërisë civile dhe komuniteteve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit Aksional për KEDh. Tryezat e rrumbullakëta gjithashtu ofruan një mundësi thelbësore për t'i vlerësuar nevojat dhe prioritetet në çdo komunë, për të miratuar një qasje të përfshirjes shumë-palëshe në zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit Aksional në kontekstin lokal.

Duke i marrë parasysh aspektet e ndjeshme të P/KEDhRÇT-së, qasja që përfshin gjithë shoqërinë e Misionit kishte për qëllim të arrijë një numër të rezultateve nga tryezat e rrumbullakëta, duke përfshirë:

- Promovimin e një kuptimi holistik (gjithëpërfshirës) të ekstremizmit të dhunshëm që e adreson këtë fenomen në të gjitha format e tij (p.sh., të krahut të djathtë, nationalist ekskluzivist, politik), duke e zvogëluar kështu stigmatizimin e komuniteteve etnike dhe fetare dhe duke mundësuar diskutime të gjera se cilat forma të ekstremizmit të dhunshëm ekzistojnë në vend dhe në kontekstin lokal;
- Mbështetjen për zhvendosjen nga qasjet tradicionale të drejtuara nga siguria drejt theksimit të qasjes që e përfshin gjithë shoqërinë që shërben për t'i fuqizuar palët e interesuara të komunitetit duke i trajtuar ata si pjesë kryesore të zgjidhjes;
- Ofrimin e një hapësire të sigurt dhe të platformës për dialog që pjesëmarrësit t'i shprehin hapur shqetësimet e tyre dhe ta iniciojnë ndërtimin e besimit, si midis komuniteteve lokale ashtu edhe me strukturat qeveritare;
- Fuqizimin e palëve të interesuara për të krijuar kanale për komunikim dhe bashkëpunim të zgjeruar;
- Identifikimin e sfidave dhe mundësive potenciale për një qasje shumë-palëshe për zbatimin e Strategjisë dhe Planit Aksional;
- Qartësimin e roleve dhe përgjegjësi midis qeverisë qendrore dhe pushtetit lokal, dhe ndërmjet qeverisë dhe shoqërisë civile;
- Identifikimin përmes bashkëpunimit të gjetjeve dhe rekomandimeve që do të shërbejnë si bazë paraprake për zhvillimin e ardhshëm të planeve lokale aksionale.

Ky raport ofron një përmbledhje të diskutimeve të udhëhequra nga palët lokale të interesuara në dhjetë tryezat e rrumbullakëta komunale. Seksioni i ardhshëm jep një përshkrim të metodologjisë së tryezave të rrumbullakëta, i pasuar nga gjetjet dhe përfundimet kryesore. Seksioni i fundit i shtjellon praktikat më të mira të bazuara në gjetjet për zbatimin e programit të P/KEDhRÇT-së. Shtojca ofron një përmbledhje të detajuar të zhvillimeve në

tryezat e rrumbullakëta në Çair, Gostivar, Kumanovë, Strugë dhe Tetovë në formë të raporteve të hartuara nga partneri implementues i Misionit të OSBE-së në Shkup, Qendra për Hulumtim dhe Krijim të Politikave (QHKP).

Si një nga qëllimet e tij kryesore, raporti synon ta potencojë rëndësinë e promovimit të qasjes shumë-palëshe për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për KEDh me një kuptim të përgjegjësisë së përbashkët për sigurinë. Gjetjet e tryezave të rrumbullakëta po ashtu shërbejnë për ta demonstruar dobinë nga sigurimi i një procesi inkluziv në konceptimin dhe hartimin e politikave dhe të strategjive për P/KEDhRÇT, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal.

Raporti është shkruar për një publik të gjerë, duke i përfshirë politikëbërësit dhe praktikuesit të cilët punojnë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave, strategjive, planeve aksionale dhe programeve për P/KEDhRÇT. Ai gjithashtu është shkruar në mënyrë të veçantë për palët lokale të interesuara - duke i përfshirë autoritetet komunale dhe institucionet e tjera lokale, praktikuesit dhe profesionistët lokalë, si dhe anëtarët e shoqërisë civile - të cilët mund të përfshihen në hartimin dhe zbatimin e programeve për P/KEDhRÇT. Më në fund, raporti gjithashtu ka për qëllim të ngrejë vetëdijen për rëndësinë e bashkëpunimit të bazuar në mirëbesim ndërmjet politikëbërësve dhe praktikuesve gjatë hartimit dhe realizimit të këtyre programeve.

**PROMOVIMI I QASJES SHUMË-PALËSHE NË PARANDALIMIN DHE KUNDËRVËNIEN NDAJ EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE RADIKALIZMIT QË ÇON NË TERRORIZËM**

Raport përmblledhës i diskutimeve në tryeza të rrumbullakëta për Strategjinë Kombëtare për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut







## 2. METODOLOGJIA E TRYEZAVE TË RRUMBULLAKËTA ME PALËT E INTERESUARA LOKALE

Misioni e bazoi metodologjinë e tryezave të rrumbullakëta në të njëjtën qasje që e përfshin gjithë shoqërinë, të cilën e zbatoi për dizajnimin dhe kryerjen e konsultimeve publike për hartimin e Strategjisë Kombëtare për KEDh në fillim të vitit 2018. Duke e përdorur për herë të parë një qasje ambicioze dhe inkluzive për ta promovuar angazhimin shumë-palësh në P/KEDhRÇT, metodologjia e tryezave të rrumbullakëta ofron një shembull të vlefshëm të praktikave më të mira për politikëbërësit dhe praktikuesit e përfshirë në hartimin e proceseve të ngjashme të punës në komunitet për strategjitë e tjera kombëtare.

Seksioni vijues ofron një përmbljedhje të qasjes metodologjike që është përdorur në përzgjedhjen e komunave dhe të pjesëmarrësve për tryezat e rrumbullakëta, si dhe për dizajnimin e strukturës së diskutimeve të drejtuara. Në këtë seksion gjithashtu janë shqyrtuar strategjitë për zvogëlimin e dëmit dhe masat për krijimin e besimit që janë përdorur nga Misioni gjatë realizimit të punës në terren me palët e interesuara lokale.

### ***Përzgjedhja e komunave dhe e pjesëmarrësve për tryezat e rrumbullakëta***

Misioni, në koordinim me KKKEDhKT-në, i përzgjodhi dhjetë komunat në bazë të një liste me kritere që siguruan diversitet gjeografik dhe e shmangën stigmatizimin e disa bashkësive etnike pakicë që mund të krijonte perceptim publik se vetëm këto bashkësi etnike kanë probleme me sfidën e EDhRÇT-së. Për më tepër, duke mundësuar mbulim të gjerë të vendit në organizimin e tryezave të rrumbullakëta, fokusi u zhvendos larg zonave ku aktivitetet aktuale dhe

ato të planifikuara P/KEDhRÇT-së tashmë ishin shumë të koncentruara dhe u përforcua mesazhi se do të adresoheshin të gjitha format e EDhRÇT-së .

Në identifikimin e pjesëmarrësve për tryezat e rrumbullakëta, Misioni u mbështet në prezencën e tij në terren për të realizuar kontakt me një rrjet të gjerë të palëve të interesuara midis institucioneve të vetëqeverisjes lokale, shoqërisë civile, mësimdhënësve, të rinjve, udhëheqësve fetarë dhe të komunitetit lokal, ku të gjithë ata luajnë një rol të rëndësishëm në qasjen e bazuar në komunitet, e cila është baza e P/KEDhRÇT-së. Në shumë raste, tryezat e rrumbullakëta paraqisnin rastin e parë ku të gjithë aktorët kryesorë lokalë u tubuan në të njëjtën hapësirë si pjesë e dialogut. U realizuan punime intensive në terren përmes takimeve të shumta përgatitore me palët e interesuara për t'i identifikuar pjesëmarrësit adekuatë dhe për ta adresuar çdo shqetësim, duke përfshirë edhe rreziqet e stigmatizimit. Duke e pranuar mungesën e përgjithshme të vetëdijes publike dhe të ndjeshmërisë së publikut rreth P/KEDhRÇT-së, Misioni u përqendrua në identifikimin e individëve që kishin përvojë paraprake me këtë temë ose që punojnë në fushë të lidhur ngushtë me të.

Në identifikimin e pjesëmarrësve, Misioni u kujdes shumë që të sigurojë përfaqësim të larmishëm të të gjitha bashkësive etnike dhe fetare që janë të pranishme në secilin kontekst komunal. Një element i rëndësishëm të cilit iu kushtua theks i veçantë ishte edhe ajo që të sigurohet se nevojat dhe perspektivat e bashkësive më të vogla pakicë do të reflektohen në diskutimet e zhvilluara në tryezat e rrumbullakëta. U ftuan që të marrin pjesë edhe përfaqësues nga grupet lokale të grave dhe të të rinjve, për ta pasuruar edhe më shumë diskutimin dhe për t'i fuqizuar këto grupe për të krijuar koalicione brenda shoqërisë civile dhe për ta rritur bashkëpunimin me institucionet lokale.

Dizajni i tryezave të rrumbullakëta duhej të përballej me trashëgiminë e P/KEDhRÇT-së, që fokusohej kryesisht në format e frymëzuara nga feja të EDhRÇT-së, gjë që ka rezultuar me stigmatizimin e disa komuniteteve fetare dhe me marrëdhënie të tensionuara midis këtyre komuniteteve nga njëra anë dhe institucioneve dhe organeve të zbatimit të ligjit nga ana tjetër. Një rezultat tjetër i kësaj trashëgimie është se udhëheqësit fetarë shpesh kanë perceptimin se prej tyre pritet që t'i kenë të gjitha zgjidhjet për parandalimin dhe kundërvënien ndaj EDhRÇT-së, madje edhe atëherë kur nuk i kanë kapacitetet, burimet dhe përkrahjen e nevojshme nga palët e tjera të interesuara. Qasja që e përfshin gjithë shoqërinë ndaj P/KEDhRÇT-së i shmanget definimit të EDhRÇT-së si çështje teologjike duke e vendosur kështu barrën e përgjegjësisë vetëm te udhëheqësit fetarë, dhe në vend të kësaj EDhRÇT-së e njeh si një fenomen shoqëror që i vendos udhëheqësit fetarë midis një bashkësie të palëve të interesuara që janë të angazhuar

për ta ndërtuar rezistencën e komunitetit. Gjatë përgatitjeve të tryezave të rrumbullakëta, udhëheqësit fetarë u inkurajuan ta shfrytëzojnë forumin e hapur për t'i shprehur idetë dhe shqetësimet e tyre duke u përfshirë në dialog me palët e tjera të interesuara që ishin të pranishme në diskutim. Përveç kësaj, për ta mbështetur krijimin e besimit, Misioni vendosi kontakte në terren me përfaqësuesit lokalë të bashkësive fetare për ta shpjeguar qartë qëllimin e tryezave të rrumbullakëta dhe për t'i trajtuar problemet e tyre, veçanërisht sa i përket stigmatizimit. Takimet përgatitore ofruan mundësi për ta potencuar kuptimin holistik (gjithëpërfshirës) të P/KEDhRÇT-së, i cili, përveç që e promovon qasjen e përfshirjes së gjithë shoqërisë, i përfshin të gjitha format e ekstremizmit të dhunshëm dhe përmbahet nga synimi i ndonjë grupe të veçantë etnik ose fetar,

Misioni gjithashtu u përpoq që në tryezat e rrumbullakëta t'i përfshijë edhe mësimdhënësit dhe punonjësit e tjerë ndihmës arsimorë (p.sh., psikologët, pedagogët e shkollave), duke pasur parasysh rolin e tyre të rëndësishëm në ndikimin e drejtpërdrejtë mbi botëkuptimet dhe vlerat e të rinjve gjatë një periudhe kritike të jetës së tyre për zhvillimin kognitiv dhe formimin e identitetit të tyre. Mësimdhënësit gjithashtu kanë mundësi të ndërhyjnë dhe ta mbështesin një të ri i cili mund të përballlet me ose të cenohet nga fenomenet negative shoqërore. Në të njëjtën kohë, përpjekjet për P/KEDhRÇT në rajon kanë tendencë të përqendrohen në ndërtimin e kapaciteteve të mësimdhënësve për t'i njohur shenjat e radikalizimit, duke rrezikuar me këtë rast të bëjnë dëm në mungesë të trajnimit adekuat, në vend që ata të fuqizohen me mjetet e duhura për të ndërtuar qëndrueshmërinë e të rinjve ndaj EDhRÇT-së (p.sh., duke i reformuar metodologjitë e mësimdhënies dhe duke vendosur theks më të madh në programet mësimore për nxitjen e të menduarit kritik, respektimin e diversitetit dhe promovimin e sjelljeve jo të dhunshme). Duke pasur parasysh këtë, Misioni i ftoi gjithashtu edhe përfaqësuesit e njësisve rajonale të Byrosë për Zhvillimin e Arsimit që punojnë në zhvillimin e programeve mësimore, si dhe punonjësit lokalë të arsimit nga institucionet fetare, të cilët gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e të rinjve.

Duke u bazuar në praktikat më të mira të përpjekjeve parandaluese në fushën e shëndetit publik, Misioni gjithashtu i ftoi edhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit psiko-social që të marrin pjesë në tryezat e rrumbullakëta. Profesionistët në fushat e mirëqenies sociale dhe të shëndetit mendor kanë përvojë të gjerë nga iniciativat që i mbështesin individët e cenusëm, që janë në rrezik për t'u përfshirë në lloje të tjera të sjelljeve negative shoqërore, siç është delikuenca e të rinjve. Për më tepër, ofruesit e shërbimeve të kujdesit psiko-social janë të detyruar nga kodi etik profesional që i rregullon marrëdhëniet midis klientit dhe ofruesit të shërbimit, që t'i respektojnë parimet e tilla, siç është besimi dhe theksi në mbështetjen e mirëqenies së

individit. Përderisa qasja e bazuar së tepërmi në aspektin e sigurisë ndaj P/KEDhRÇT-së, me përfshirje të konsiderueshme të organeve të zbatimit të ligjit mund të rezultojë me zhvendosje dhe tëhuajësimin e ofruesve të shërbimeve të kujdesit psiko-social, qasja e bazuar në shëndetin publik krijon hapësirën për angazhimin e tyre. Qëllimi i përfshirjes së ofruesve të shërbimeve të kujdesit psiko-social ishte të rritet vetëdija e tyre për EDhRÇLT-në dhe për kontributin e rëndësishëm që mund ta japin në forcimin e faktorëve mbrojtës.

Thelbësore për qasjen për të mos bërë dëm sa i përket EDhRÇT-së është kuptimi i nuancuar i dinamikës dhe i ndjeshmërive të komunitetit. Duke pasur parasysh natyrën e ndjeshme të P/KEDhRÇT-së, Misioni mori parasysh mosbesimin ekzistues të shprehur nga komunitetet - veçanërisht bashkësitë etnike pakicë - ndaj institucioneve dhe organeve të zbatimit të ligjit. Shpesh në përpjekjet për bashkëpunim midis policisë dhe publikut, ekziston një perceptim se agjendat e bazuara në siguri të organeve të zbatimit të ligjit kanë tendencë t'i zhvendosin shqetësimet dhe problemet e tjera të rëndësishme të komunitetit lokal, veçanërisht kur bashkëveprimi është i natyrës së njëanshme. Duku u nisur nga tabutë ekzistuese rreth EDhRÇT-së dhe frikës së shoqëruar për pasojat negative nga diskutimi i kësaj çështjeje në prani të përfaqësuesve të organeve të zbatimit të ligjit, Misioni u dha përparësi tryezave të rrumbullakëta si një hapësirë e sigurt për të gjithë pjesëmarrësit për t'i paraqitur pikëpamjet e tyre mbi problemet dhe shqetësimet lokale. Për pasojë, përfaqësuesit e policisë nuk u ftuan në tryezat e rrumbullakëta në mënyrë që të sigurohet një forum i hapur për diskutim dhe për ta forcuar kuptimin për P/KEDhRÇT-në si një përpjekje shumë-palëshe e bazuar në komunitet, që realizohet në hapësirën para-penale. Kjo qasje kishte për qëllim t'i mundësojë komunitetit të ndjehet i angazhuar për të mirën e tyre dhe se ata gjithashtu kanë një interes të rëndësishëm për të kontribuar për sigurinë dhe mirëqenien e komunitetit të tyre.

### ***Struktura e tryezave të rrumbullakëta***

Duke i njohur tabutë rreth EDhRÇT-së dhe mungesën e përgjithshme të vetëdijes publike në këtë fushë në vjeshtën e vitit 2018, Misioni vendosi t'i strukturojë tryezat e rrumbullakëta si ngjarje njëditore, për të ofruar kohë të mjaftueshme që diskutimet të zhvillohen në thellësi të mjaftueshme. Çdo tryezë e rrumbullakët filloi me një përmbledhje të koncepteve kryesore dhe të terminologjisë, për të siguruar se pjesëmarrësit kishin kuptim të njëjtë për sesionet vijuese të diskutimit. Pas seancës për konceptet vijonte prezantimi i Strategjisë Kombëtare për KEDh, i udhëhequr nga koordinatori kombëtar ose zëvendësi i tij për KEDh. Pjesëmarrja aktive e KKKEDhKT-së në të gjitha tryezat e rrumbullakëta rezultoi me një ndërveprim dinamik midis nivelit qendror



dhe atij lokal, duke iu përgjigjur drejtpërdrejt pyetjeve të pjesëmarrësve, si dhe duke i dëgjuar nga dora e parë perspektivat, problemet dhe idetë e tyre për zgjidhje.

Seancat e diskutimit u organizuan rreth fushave kryesore të gërshetuara dhe u udhëhoqën nga një moderator me përvojë, me mbështetjen e pyetjeve udhëzuese, të përgatitura para se të mbahen tryezat e rrumbullakëta. Në secilën nga seancat tematike, pjesëmarrësve nga të gjitha fushat iu dha mundësia të kontribuojnë në identifikimin e sfidave lokale dhe mundësive që lidhen me zbatimin e Strategjisë dhe Planit Aksional në kontekstin lokal. Pjesëmarrësit u informuan se do të zbatohet rregulli “Chatham House Rule” (rregulli sipas të cilit informatat e shpalosura gjatë takimit mund të raportohen nga të pranishmit, por burimi i informatës nuk mund të identifikohet në mënyrë të qartë) për ta mbrojtur identitetin e tyre dhe për të mundësuar një diskutim të hapur. Seancat e tryezave të rrumbullakëta u organizuan rreth temave të mëposhtme:

1. Ekstremizmi i dhunshëm në kontekstin lokal
2. Fuqizimi i shoqërisë civile dhe shkëmbimi i praktikave më të mira
3. Bashkëpunimi midis komunës dhe komunitetit
4. Ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve dhe qeverisë;
5. Roli i komuniteteve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm
6. Arsimi dhe mbështetja e të rinjve në rrezik
7. Rëndësia e mirëqenies sociale dhe e shëndetit mendor

Duke marrë parasysh ndjeshmërinë e diskutimit të ekstremizmit të dhunshëm me komunitetet lokale, Misioni vuri theks të posaçëm në përzgjedhjen e moderatorëve dhe raportuesve me shkathtësi dhe aftësi të përshtatshme. Një faktor shtesë në identifikimin e moderatorëve dhe të raportuesve ishte ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile në fushën e P/KEDhRÇT-së për të vazhduar punën për ndryshimin afatgjatë të politikave. Për pasojë, Misioni identifikoi se QHKP-ja, një organizatë udhëheqëse për politika, kryente një hulumtim, së bashku me Organizatën Ndërkombëtare për Migracion (IOM), në komunat që përputhen me komunat e përzgjedhura për tryezat e rrumbullakëta, për t'i vlerësuar kapacitetet institucionale lokale për ta zbatuar Strategjinë Kombëtare. Duke promovuar sinerji midis iniciativave, Misioni synoi të sigurojë se hulumtimi dhe diskutimet në tryezat e rrumbullakëta e plotësonin njëri-tjetrin për ta ndihmuar qeverinë, institucionet lokale dhe shoqërinë civile për ta krijuar qasjen më të mirë të mundshme shumë-palëshe ndaj P/KEDhRÇT-së.







## 3. GJETJET

Ky seksion ofron një përmbljedhje të gjetjeve të tryezave të rrumbullakëta. Të organizuara sipas strukturës së sesioneve në shumicën e tryezave të rrumbullakëta, gjetjet në secilën fushë tematike janë plotësuar me theks në specifikat lokale me interes të veçantë.

### 3.1. Ekstremizmi i dhunshëm në kontekstin lokal

Marrë në përgjithësi, tryezat e rrumbullakëta sugjeruan se vetëdija për EDhRÇT-në është përgjithësisht e ulët, dhe se shumica e pjesëmarrësve të tryezave të rrumbullakëta patën qëndrimin se ekstremizmi i dhunshëm nuk është i përhapur në komunën e tyre, megjithëse çështja e qytetarëve lokalë që shkojnë për të luftuar në Siri u ngrit në disa tryeza të rrumbullakëta. Për më tepër, përgjithësisht kishte një nivel të lartë të vetëdijes se megjithëse ekstremizmi i dhunshëm mund të fillojë si diçka e vogël, ai po ashtu mund të rritet shpejt duke marrë parasysh praninë e shembujve/personave që shërbejnë si shembuj për t'u ndjekur. Gjithashtu u theksua se diskutimi i EDhRÇT-së trajtohet si tabu, me ç'rast efekti i ngulfatjes së diskutimit të tillë është kundërproduktiv nga pikëpamja e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm. Pjesëmarrësit po ashtu theksuan se ekstremizmi i dhunshëm më së shpeshti shoqërohet me shfaqje fetare, duke rezultuar në stigmatizimin e disa komuniteteve, si dhe e identifikuan ekstremizmin e krahut të djathtë dhe atë nacionalist si dukuri që gjithashtu janë të përhapura në vend.

Pavarësisht nga qëndrimi i shumicës së pjesëmarrësve në tryezat e rrumbullakëta se ekstremizmi i dhunshëm nuk është shumë i përhapur, tryezat e rrumbullakëta dëshmuar se pranohet ekzistimi i një spektri të gjerë të manifestimeve të këtij fenomeni. Në njërën anë të spektrit, pjesëmarrësit e tryezave të rrumbullakëta i përmendën grafitet që shprehin fyerje dhe qëllime dhe/ose ide të dhunshme si një formë me intensitet të ulët e ekstremizmit të dhunshëm, me ç'rast pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Prilep theksuan gjithashtu se mos-heqja e grafitëve të tilla kontribuon për normalizimin e mesazheve të tilla. Rrënjët e intolerancës dhe të urrejtjes së pari shfaqen gjithashtu si konfrontime verbale para se të shkallëzohen në dhunë fizike, duke i përfshirë këtu kryesisht rrahjet mbi baza ndëretnike midis nxënësve të shkollave të mesme në shkolla dhe në mjetet e transportit publik. Kur bëhet fjalë për gjuhën e urrejtjes dhe dhunën fizike nga grupet e tifozëve sportivë (zakonisht të futbollit), në tryezat e rrumbullakëta u pranua

se ka një përhapje të gjerë të aktiviteteve të tilla, si një formë e ekstremizmit të dhunshëm, me ç'rast pjesëmarrësit në Çair theksuan këtu ka ndikim të pretenduar nga partitë politike. Në Prilep, pjesëmarrësit e identifikuan djegien e Xhamisë së Çarshisë dhe dëbimin efektiv të familjeve etnike shqiptare në vitin 2001 si një manifestim ekstrem të EDhRÇT-së.

Diskutimi i faktorëve që mund të jenë të favorshëm për EDhRÇT-në nxori në pah rëndësinë e shqetësimeve që lidhen me familjen. Pikëpamje e përbashkët e pjesëmarrësve në tryezat e rrumbullakëta ishte se kohezioni i brendshëm i familjeve nuk është aq i fortë sa dikur, duke bërë që të rinjtë të kërkojnë identitet dhe përkatësi në grupe të tjera, siç janë bashkësitë etnike, partitë politike, komunitetet fetare dhe grupet e tifozëve sportivë. Në disa tryeza të rrumbullakëta, pjesëmarrësit iu referuan gjithashtu mungesës së prindërve, shpesh si rezultat i migrimit për shkak të punës që rrjedh nga papunësia e lartë. Në tryezën e rrumbullakët në Çair, pjesëmarrësit e ndërlidhën mungesën e prindit me cenueshmërinë më të madhe ndaj predikuesve ekstremistë. Gjithashtu u përmendën edhe çështje të ndryshme që kanë të bëjnë me gjininë, duke përfshirë dhunën në familje, mungesën e respektit për gratë në përgjithësi, ndërsa në Veles, se vlerat konservatore i pengojnë nënat të marrin pjesë në mbledhje në shkollë.

Përveç dinamikës familjare, pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta identifikuan një varg shkaqesh të tjera për EDhRÇT-në. Siç u përmend më lart në lidhje me migracionin për shkak të punës, kushtet ekonomike shpesh u përmendën si gjendje e favorshme për ekstremizmin e dhunshëm. Siç e tha një pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët në Veles, „Nuk do të diskutonim për këto probleme nëse [standardi i jetesës] do të ishte më i lartë.“ Ndonjëherë nga pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta, në kombinim me varfërinë dhe papunësinë, u përmend edhe marginalizimi në baza etnike dhe/ose fetare. Margjinalizimi etnik dhe fetar u shpjegua si një faktor që ndikon potencialisht në kërkimin e identitetit dhe përkatësisë nga individët në atë mënyrë që i bën grupet e dhunshme ekstremiste më tërheqëse. Përveç kësaj, u theksua se disa segmente të marginalizuara të shoqërisë mund të kërkojnë mbështetje nga grupet alternative fetare, jashtë institucioneve zyrtare fetare, për shkak të perceptimit se këto grupe janë më afër njerëzve dhe nevojave të tyre.

Një nga shkaqet tjera që u identifikua në tryezat e rrumbullakëta kishte të bëjë me qasjen në informata. Siç theksuan pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta, mediat shpesh luajnë një rol destruktiv, duke e përhapur gjuhën e urrejtjes dhe duke i rritur tensionet ndëretnike me mënyrën se si i mbulojnë incidentet kur kryesi është anëtar i një grupi pakicë. Shpesh u përmend edhe qasja, shpesh e parregulluar, e të rinjve në telefonat celularë,

ndërsa gjuha e urrejtjes që është e zakonshme në media dhe në rrjetet sociale u identifikua si një faktor shtytës drejt ekstremizmit të dhunshëm.

Gjithashtu, ajo që u përmend shpesh në tryezat e rrumbullakëta ishte edhe politizimi i jetës dhe i institucioneve në Maqedoninë e Veriut, ndonjëherë në formë të nxitjes për ekstremizëm nga partitë politike në pushtet dhe nga forumet rinore të partive. Futja e dhunshme në parlament më 27 prill të vitit 2017 u përmend në disa tryeza të rrumbullakëta si një shembull i përfshirjes së partive politike në ekstremizëm të dhunshëm. Në Gostivar, pjesëmarrësit theksuan se një ekstrem çon në ekstremin tjetër, veçanërisht kur normalizohet kultura e dhunës dhe kur politika përqendrohet në urrejtje dhe/ose hakmarrje. Nivelet e larta të polarizimit politik e pengojnë funksionimin e institucioneve, duke çuar në këtë mënyrë në mungesë të besimit të publikut në këto institucione.

### 3.2. Fuqizimi i shoqërisë civile dhe shkëmbimi i praktikave më të mira

Në diskutimin e shoqërisë civile në tryezat e rrumbullakëta u pranua gjerësisht roli potencial i shoqërisë civile në identifikimin dhe ndërmarrjen e veprimeve parandaluese kundër formave të ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm. U theksua se ka një dallim të madh në fuqinë dhe marrëdhëniet e organizatave të shoqërisë civile me komunitetet dhe institucionet lokale në vise të ndryshme të vendit. Megjithëse duhet punuar më tepër në ngritjen e kapaciteteve për P/KEDhRÇT, pjesëmarrësit gjithashtu vlerësuan se organizatat e shoqërisë civile (OShC) tashmë kanë përvojë të gjerë në fushat që lidhen me parandalimin e dhunës dhe ndërtimin e kohezionit social, që mund të mbështeten më mirë. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit theksuan se duhet pasur kujdes me përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile që nuk e kanë ekspertizën e duhur për P/KEDhRÇT, dhe sugjeruan se duhet të bëhen më shumë përpjekje për ta lehtësuar shkëmbimin e praktikave më të mira. Pjesëmarrësit gjithashtu identifikuan disa fusha në të cilat OShC-të mund ta rrisin fokusin e aktiviteteve të tyre në P/KEDhRÇT, si për shembull duke i angazhuar prindërit në parandalimin e dhunës, promovimin e të drejtave të njeriut përmes edukimit joformal dhe ofrimit të trajnimeve për mediat mbi ndjeshmërinë e konflikteve në raportimet e tyre.

Gjatë diskutimeve në tryezat e rrumbullakëta, pjesëmarrësit dhanë shembuj të shumtë të kontributeve pozitive nga OShC-të lokale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Në Gostivar, OShC-të kanë realizuar projekte të ndryshme për ta ndërtuar qëndrueshmërinë brenda komunitetit lokal,

me projekte relevante që përfshijnë trajnime për shkathtësi digjitale për të rinjtë e marginalizuar dhe hapjen e një qendre rinore, si dhe iniciativa të tjera të përqendruara në bashkimin e të rinjve me prejardhje të ndryshme. Siç theksuan pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët, marrëdhëniet e mira midis shoqërisë civile dhe pushtetit lokal gjithashtu mundësuan që në Gostivar të krijohet këshilli i parë komunal rinor në vend; megjithatë u theksua se këshilli rinor përballlet me sfida për shkak të mjeteve të pamjaftueshme për aktivitete. Disa OShC në Kumanovë jo vetëm që kanë marrë qëndrim publik kundër ekstremizmit të dhunshëm, por gjithashtu kanë realizuar edhe punë parandaluese me të rinjtë e prekshëm për t'u bashkuar me grupet e dhunshme ekstremiste jashtë vendit. Për më tepër, tryezat e rrumbullakëta në Prilep dhe Tetovë zbuluan se organizatat e shoqërisë civile kishin kapacitete të zhvilluara për të ofruar ndihmë për personat e cenueshëm, që mund të zbatohen edhe për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta në Kumanovë dhe Prilep vunë në dukje se OShC-të kanë vështirësi për të pasur programe afatgjata për shkak të mungesës së fondeve, ndërsa në diskutimin në Kumanovë u identifikua nevoja që donatorët t'i marrin parasysh prioritetet lokale dhe programet ekzistuese gjatë shpërndarjes së fondeve të tyre. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Kumanovë gjithashtu theksuan se megjithëse shoqëria civile lokale është relativisht e fortë në vetvete, bashkëpunimi midis OShC-ve, shkollave dhe autoriteteve komunale ka nevojë për t'u forcuar. Për më tepër, edhe në Gostivar, ku pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët e vlerësuan pozitivisht pozicionin dhe rolin e shoqërisë civile, u theksua se shoqëria civile kishte vuajtur në të kaluarën nga presioni i ushtruar nga shteti përmes kontrolleve dhe inspektimeve të drejtuara nga politika.

Megjithëse diskutimet në tryezat e rrumbullakëta në disa komuna dhanë një pasqyrë të anëve të forta të shoqërisë civile lokale për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, tryezat e rrumbullakëta në Çair dhe Strugë treguan një situatë më pak pozitive. Në këto komuna, bashkëpunimi midis shoqërisë civile dhe institucioneve vendore karakterizohet si i dobët, me nivele të ulëta të besimit dhe të vetëdijes për programet e OShC-ve lokale nga ana e autoriteteve lokale. Pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta në Çair dhe Strugë gjithashtu i potencuan perceptimet negative të publikut për OSHC-të në këto komuna se janë të ndikuara nga agjendat personale, politike, dhe/ose kriminale që në mënyrë efektive e dëmtojnë idenë e vullnetarizmit dhe aktivizmit qytetar. Gjetjet shtesë nga tryeza e rrumbullakët në Çair përfshijnë nivele të ulëta të vetëdijes nga ana e OShC-ve për disponueshmërinë e hapësirave komunale për aktivitetet e tyre, si dhe vështirësitë me të cilat përballen OShC-të për të marrë fonde nga komuna. Në fund, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Çair theksuan se shumica e OShC-ve lokale aktive janë organizata humanitare, me ç'rast pak organizata zbatojnë aktivitete

kulturore ose aktivitete që kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe angazhimit qytetar. Komunitetet fetare gjithashtu ngritën shqetësimin se disa organizata humanitare të financuara nga vendet e huaja gjoja kryenin aktivitete me prapavijë politike ose fetare dhe motive jo transparente.

### 3.3. Bashkëpunimi midis komunës dhe komunitetit

Gjetjet e tryezave të rrumbullakëta sugjerojnë se nivelet e angazhimit midis komunave dhe komunitetit ndryshojnë shumë, në të njëjtën mënyrë sikurse forca dhe roli i shoqërisë civile në nivelin lokal, siç u diskutua më lart. Faktorë që u përmendën shpesh në tryezat e rrumbullakëta për koordinimin midis komunave dhe komunitetit ishin bashkësitë lokale dhe Këshillat Lokalë të Parandalimit (KLP). Sa i përket bashkësive lokale, pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta në Kumanovë dhe Tetovë, shprehën keqardhje për humbjen e statusit të bashkësive lokale në vitin 2002. Si rezultat i kësaj, këto subjekte më nuk kanë llogari bankare dhe vulë zyrtare. Ata i përshkruan bashkësitë lokale si një mekanizëm i rëndësishëm dhe shpesh herë efektiv për bashkëpunimin midis autoriteteve lokale dhe komuniteteve lokale për shkak të njohurive të tyre për zhvillimet në nivel lokal, por thanë se bashkësitë lokale hasin në vështirësi në zgjidhjen e problemeve të komunitetit, sepse që nga viti 2002 ato funksionojnë në baza vullnetare. Prandaj, pjesëmarrësit kërkuan që të miratohet një ligj i ri, me të cilin do të rikthehej statusi i bashkësive lokale.

Sa i përket KLP-ve, në tryezat e rrumbullakëta u bë e qartë se këto mekanizma kanë potencialin për të shërbyer si një mjet i udhëhequr nga komunat për të siguruar se të gjithë aktorët janë të përfshirë në diskutimin e çështjeve të sigurisë publike. Megjithatë, mungesa e detyrimit ligjor për të gjitha komunat që të krijojnë KLP, si dhe duke i marrë parasysh sfidat e tjera për bashkëpunimin midis më tepër agjencive/organeve, e ka penguar krijimin dhe funksionimin e vazhdueshëm të një organi të tillë në të gjitha komunat në të cilat u mbajtën tryezat e rrumbullakëta. Në Kumanovë ekziston KLP-ja, por nga pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët ajo u karakterizua si shumë pak funksionale si rezultat i emërimeve të bëra në bazë të përkatësisë politike, e jo në bazë të ekspertizës. Pjesëmarrësit në tryezat e tjera të rrumbullakëta, KLP-të në komunat e tyre përkatëse i konsideruan si joaktive ose thanë se nuk janë krijuar fare, ndërsa pjesëmarrësit në Prilep deklaruan se nëse do të ishte krijuar një KLP në të ardhmen, do të ishte e rëndësishme të sigurohet që ajo do të ketë një fokus më të gjerë se vetëm në EDhRÇT. Për më tepër, pjesëmarrësit sugjeruan se KLP-ja duhet të sigurojë se individët me kompetenca dhe përkushtim adekuat duhet të përfshihen si anëtarë të përhershëm për të

siguruar konsistencë dhe qëndrueshmëri. Përveç institucioneve të ndryshme, pjesëmarrësit gjithashtu propozuan që përfaqësuesit e OShC-ve dhe të komuniteteve të përfshihen në konfigurimin e KLP-ve.

Në mungesë të një KLP-je funksionale ose të mekanizmave të tjerë që mund të përdoren për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, tryezat e rrumbullakëta të mbajtura në Gostivar dhe Kumanovë ofruan njohuri për organet ekzistuese dhe të planifikuara koordinuese për adresimin e llojeve të tjera të fenomeneve antisociale dhe të dhunshme. Në Gostivar, ku pjesëmarrësit i përmendën mekanizmat relevantë për koordinim, por që nuk janë të financuar (p.sh. organi koordinues për parandalimin e dhunës me bazë gjinore), gjithashtu i bënë thirrje komunës që ta marrë më seriozisht ekstremizmin e dhunshëm. Ata po ashtu e mirëpritën nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit me OShC-në “Search for Common Ground” (Kërkimi i bazës së përbashkët) për të krijuar një Ekip të Veprimit në Komunitet që do të punojë në hartimin e një plani lokal të veprimit për KEDh dhe do ta këshillojë Këshillin komunal për çështje që lidhen me të. Ekipe të Veprimit në Komunitet janë krijuar edhe në komunat e Çairit dhe të Kërçovës. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit në këtë tryezë theksuan se shumica e problemeve me të cilat përballen komunat duhet të adresohen në nivelin qendror. Në Kërçovë, pjesëmarrësit kërkuan që përfaqësuesit e bashkësive më të vogla pakicë dhe nga vendbanimet rurale të përfshihen në çdo organ koordinues që punon në P/KEDhRÇT për të kontribuar në identifikimin e problemeve dhe të zgjidhjeve.

Në Kumanovë, informacionet për çështjet që paraqesin shqetësim publik shkëmbehen midis bashkësive vendore, Komisionit për Marrëdhënie Ndëretnike (KMNE) dhe Komisionit për Siguri të Këshillit Komunal, me ç'rast burimet e informacionit janë të mbrojtura. Në Kumanovë dhe Kërçovë, pjesëmarrësit vunë në dukje se megjithëse është krijuar Komisioni për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, karakteri i tij vullnetar e ka bërë të vështirë adresimin e çështjeve në mënyrë parandaluese, si dhe organizimin e takimit vjetor për hartimin e programit që do të zbatohet nga Seksioni për kulturë i komunës. Përveç kësaj, megjithëse komuna e Kumanovës mban marrëdhënie të mira me organizatat lokale fetare, nuk ka asnjë organ ndërfetar dhe përgjithësisht ka pak bashkëpunim midis bashkësive fetare. Më shqetësuese, sipas pjesëmarrësve në tryezat e rrumbullakëta, është mungesa e besimit në institucione nga ana e qytetarëve, veçanërisht në mesin e segmenteve më të cenueshme të shoqërisë, gjë që shpesh i pengon ata ta marrin ndihmën e nevojshme.

Përderisa në tryezat e rrumbullakëta në Gostivar dhe Kumanovë u dhanë prova të kushteve funksionale për koordinim ndërmjet komunës dhe komunitetit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, diskutimet në tryezat e



rrumbullakëta në Çair, Prilep, Tetovë dhe Strugë u përqendruan në mungesën e kushteve të tilla. Në tryezën e rrumbullakët në Çair, pjesëmarrësit vunë në dukje mungesën e dialogut dhe të bashkëpunimit midis komuniteteve lokale dhe komunës, duke theksuar në të njëjtën kohë potencialin që ka komuna për të iniciuar angazhim të komunitetit përmes aktiviteteve të përbashkëta në sferën e kulturës. Në Prilep, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët e prezantuan Këshillin rinor për delikuencën e të miturve, i cili tani nuk është funksional, si një shembull të praktikës së mirë për tubimin e këshillave të prindërve, përfaqësuesve të arsimit dhe ofruesve të shërbimeve të kujdesit psiko-social. Megjithatë, ata gjithashtu e shprehën perceptimin se autoritetet lokale i janë shmangur kontaktit me Bashkësinë Fetare Islame (BFI), pasi që BFI-ja kërkoi restaurimin e Xhamisë së Çarshisë. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Strugë e karakterizuan mosfunksionimin e KLP-së si simptomë të mungesës më të gjerë të bashkëpunimit ndër-sektorial në komunë, duke i theksuar gjithashtu sfidat në qasjen dhe adresimin e nevojave të komuniteteve rurale përreth qytetit të Strugës. Në fund, një pengesë për bashkëpunimin në mes të komunës dhe komunitetit që u identifikua nga pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët në Tetovë ishin vështirësitë financiare të komunës, duke përfshirë kryesisht bllokimin e llogarisë së saj bankare për disa vite me radhë.

### 3.4. Ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve dhe qeverisë

Në përgjithësi, në tryezat e rrumbullakëta u bë e qartë se ka mungesë të besimit midis komuniteteve dhe organeve të zbatimit të ligjit për një numër arsyesh të ndryshme. Për shembull, në Strugë dhe Tetovë, pjesëmarrësit theksuan se nivelet e ulëta të besimit në organet e zbatimit të ligjit ishin rezultat i joefektivitetit të policisë në zbatimin e ligjit kur besohet se autorët e krimeve kanë lidhje politike. Siç u shpjegua nga pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Strugë, perceptimi për zbatimin jokonsekuent të ligjit nga policia mundëson mosndëshkim për kriminelët e njohur lokalë, duke promovuar kështu se jeta e krimit është një opsion i vlefshëm për të rinjtë. Në Tetovë dhe Çair, qytetarët gjithashtu kanë frikë t'i raportojnë shqetësimet e tyre direkt në polici nga frika e hakmarrjes nga autorët, dhe preferojnë që raportimet të jenë anonime. Përfaqësimi i ulët i shqiptarëve etnikë në organet e ndryshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme gjithashtu u përmend si faktor për mungesën e besimit, pavarësisht se ka veprim afirmativ për përfaqësimin e drejtë të bashkësive etnike në polici. Rekrutimi i policëve në bazë të përkatësisë partiake u përmend në Çair dhe Kumanovë si shkak për nivelet e ulëta të besimit të qytetarëve në organet për zbatimin e ligjit.

Mungesa e përhapur gjerësisht e besimit në polici ishte e dukshme edhe në pikëpamjet e pjesëmarrësve të tryezave të rrumbullakëta të shprehura në lidhje me rolin adekuat të organeve të zbatimit të ligjit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta në Çair, Kumanovë dhe Tetovë shprehën frikë nga stigmatizimi dhe nga implikimi nga ana e policisë në hetime të panevojshme, me ç'rast pjesëmarrësit në Çair theksuan se masat joproporcionale të dhunës nga policia që i synojnë komunitetet lokale rrezikojnë të krijojnë terren pjellor për përhapjen e EDhRÇT-së. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit e tryezës së rrumbullakët në Strugë shprehën shqetësime në lidhje me kapacitetin e policisë për t'u marrë me çështjet e parandalimit përveç rasteve të tyre ekzistuese. Duke reflektuar në lidhje me këto shqetësime, pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta shpjeguan se policia duhet të angazhohet vetëm si mjet i fundit ose nëse ekziston ndonjë kërcënim imediat për sigurinë publike. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Çair sqaruan se iniciativat me bazë në komunitet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në komunën e tyre kanë vendosur të mos i përfshijnë policët nga frika për të mos bërë dëm, ndërsa pjesëmarrësit në Gostivar theksuan se plani strategjik që duhet të hartohet nga Ekipi i Veprimit në Komunitet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duhet t'i shmanget mbështetjes në polici. Në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit bënë thirrje për ngritjen më të madhe të besimit midis komuniteteve dhe policisë përmes një forumi të hapur si mekanizëm për t'i ndarë shqetësimet e tyre për sigurinë e komunitetit; megjithatë, ata theksuan se puna policore nga një nivel shumë i centralizuar paraqet sfida për të qenë në gjendje t'i adresojë në kohë shqetësimet e ngritura.

Duke marrë parasysh nivelet e ulëta të besimit të komunitetit në organet e zbatimit të ligjit, tryezat e rrumbullakëta gjithashtu e testuan bashkëpunimin midis organeve të zbatimit të ligjit nga njëra anë dhe shkollave dhe qendrave për punë sociale nga ana tjetër. Megjithëse bashkëpunimi i tillë në përgjithësi u vlerësua me nota të ulëta nga pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta dhe shumica ishin të mendimit se rastet e delikuencës së të rinjve duhet së pari të trajtohen brenda nga punonjësit për ndihmë psiko-sociale të punësuar në shkollë e jo të përfshihet policia, ndërsa pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta në Strumicë dhe Veles e potencuan bashkëpunimin e mirë midis policisë dhe shkollave. Në fund, pavarësisht nga pikëpamjet kryesisht negative të pjesëmarrësve në tryezat e rrumbullakëta për rolin e policisë në lidhje me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, pjesëmarrësit në disa tryeza të rrumbullakëta i përmendën praktikatat e mëparshme të policimit në komunitet, siç është polici i lagjes<sup>9</sup>, në kuptim pozitiv dhe e nënvizuan rolin e tyre të mundshëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duke mbajtur kontakte në nivelin lokal.

9 A pozornikar is a police officer in charge of a particular area who knows the people and the terrain in that area; a district/ neighbourhood police officer.

### 3.5. Roli i komuniteteve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm

Diskutimi mbi rolin e komuniteteve në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në pjesën më të madhe, u fokusua në familjet dhe komunitetet fetare, me ç'rast shumë pjesëmarrës të tryezave të rrumbullakëta theksuan se parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm fillon në shtëpi dhe në zhvillimin e hershëm të fëmijës. Në disa tryeza të rrumbullakëta, pjesëmarrësit theksuan se fokusi duhet të jetë në forcimin e bashkësisë familjare duke pasur parasysh se ajo është burimi për zhvillimin e vlerave të tolerancës ndërfitare dhe ndëretnike. Gjithashtu duhet të adresohet edhe dhuna në familje për t'iu kundërvënë normalizimit të dhunës në shoqëri në përmasa më të gjera. Deklaratat e ngjashme me këto shpesh u pasuan me mendime që ndërlidheshin me potencialin e këshillave të prindërve në shkolla për të marrë një rol aktiv në ngritjen e vetëdijes për rreziqet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Për më tepër, prindërit duhet të informohen më shumë në lidhje me rolin e tyre në monitorimin e aktiviteteve të fëmijës së tyre në internet dhe të sigurojnë mbrojtjen e tyre nga rreziqet në internet, duke përfshirë edhe nga përmbajtjet që lidhen me EDhRÇT-në. Në tryezën e rrumbullakët në Çair, pjesëmarrësit folën për rolin e rëndësishëm të grave në parandalimin e EDhRÇT-së, duke theksuar se ato mund të marrin rol udhëheqës në familjet e tyre për të nxitur marrëdhënie pozitive ndërfitare dhe ndëretnike, si në mënyrë proaktive ashtu edhe si përgjigje ndaj rrahjeve midis të rinjve në shkolla dhe në mjetet e transportit publik. Në këtë drejtim, nga pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Çair u vlerësua projekti „Shkollat e nënave“ i OJQ-së “Gratë pa kufij” për fuqizimin e grave për t'i udhëhequr familjet dhe komunitetet e tyre në ndërtimin e rezistencës ndaj EDhRÇT-së.

Për sa i përket dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet bashkësive fetare, pjesëmarrësit theksuan se në nivel më të lartë, krerët e bashkësive fetare takohen dy herë në vit për t'i diskutuar aktivitetet, por në nivelin lokal nuk ka komunikim të mjaftueshëm midis Bashkësisë Fetare Islame (BFI) dhe Kishës Ortodokse Maqedonase (KOM). Nevojitet bashkëpunim më intensiv për ta nxitur tolerancën, për shembull duke u përfshirë në aktivitete të përbashkëta me interes të ndërsjellë (p.sh. pastrimi i mbeturinave në ndonjë park) në nivelin lokal. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Kumanovë e veçuan si një shembull të praktikës së mirë forumin për udhëheqësit fetarë, të organizuar pas incidenteve të dhunshme në maj të vitit 2015, për të diskutuar se si të parandalohet përshkallëzimi i mëtejshëm i situatës. Gjithashtu ishin të zakonshme thirrjet nga përfaqësuesit e BFI-së dhe KOM-it për përfshirjen e lëndës së etikës dhe fesë në programet mësimore, që do të ligjëroheshin nga mësimdhënës të kualifikuar për këtë, për ta promovuar etikën dhe tolerancën

fetare. Diskutimet në tryezat e rrumbullakëta gjithashtu i shqyrtuan edhe marrëdhëniet midis ndërtimit të hapësirave fetare për adhurim dhe objekteve simbolike nga njëra anë dhe marrëdhënieve ndëretnike dhe ndërfitare nga ana tjetër. Përderisa në shumicën e rasteve kjo marrëdhënie përshkruhej në kuptimin se si ndërtimi i objekteve fetare mund të provokojë tensione ndërmjet komuniteteve, diskutimi në Strugë gjithashtu nënvizoi sesi udhëheqësit fetarë luajtën një rol konstruktiv në parandalimin e përshkallëzimit në dhunë për shkak të ndërtimit të një kisha pa leje në fshatin Oktisi. Nga një këndvështrim tjetër, pjesëmarrësit sqaruan se disa bashkësi fetare kanë probleme të kamotshme që duhen trajtuar. Siç u përmend në tryezat e rrumbullakëta, si në Prilep ashtu edhe në Gostivar, dështimi i autoriteteve lokale për të restauruar xhaminë e djegur të Çarshisë në Prilep nga konflikti i vitit 2001, e ka penguar pajtimin e mirëfilltë midis bashkësive etnike dhe fetare. Si rezultat i kësaj, mbetet nevoja e konsiderueshme për të punuar në dialogun ndërfitar në atë komunë. Në tryezën e rrumbullakët në Gostivar, shpjegimi për nivelin e ulët të komunikimit midis bashkësive fetare dhe institucioneve lokale ishte se kjo është trashëguar nga komunizmi dhe propaganda komuniste e pikëpamjeve antifetare.

Përtej referencave ndaj komuniteteve konkrete fetare, pjesëmarrësit në disa tryeza të rrumbullakëta kërkuan transparencë dhe rregullim më të madh brenda institucioneve fetare në përgjithësi; siç tha një pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët në Veles: „Nuk mund ta dimë se çfarë thonë prifti dhe imami. Ne duhet të shohim se çfarë predikojnë ata.“ Për më tepër, përfaqësuesit e KOM-it që morën pjesë në njërin nga tryezat e rrumbullakëta treguan raste kur individët që mbështesin besime ekstreme dëshirojnë t'i manipulojnë identitetet kombëtare dhe fetare, duke theksuar se disa priftërinj dhe anëtarë të Kishës kanë qasje ideologjike dhe janë të vështirë për t'u mbajtur nën kontroll.

Ndër shqetësimet e ngritura në tryezat e rrumbullakëta në lidhje me komunitetet myslimane në Maqedoninë e Veriut, më të zakonshmet kishin të bëjnë me sfidat e BFI-së për ta trajtuar keqpërdorimin e fesë në mënyrë që do ta parandalonte EDhRÇT-në. Në disa tryeza të rrumbullakëta, përfaqësuesit e BFI-së folën për organizata të huaja dhe/ose „ekstremiste“ që kryejnë veprimtari fetare jashtë kontrollit të organeve fetare zyrtare, ndonjëherë nën maskën e aktiviteteve kulturore dhe humanitare. Pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta në Gostivar dhe Strugë gjithashtu theksuan se policia nuk ka reaguar ndaj raportimeve të tyre në lidhje me praktikën e tilla. Në Gostivar, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët po ashtu e përmendën qarkullimin e sasive të mëdha të literaturës fetare pa mbikëqyrje të BFI-së, duke theksuar se EDhRÇT-ja mund të parandalohet duke e rritur edukimin fetar dhe duke promovuar një bazë të fortë të traditës hanefite, e cila ndiqet zyrtarisht në vend. Në mënyrë të ngjashme, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët

në Gostivar sugjeruan se udhëheqësit fetarë duhet ta shtojnë prezencën e tyre në rrjetet sociale në internet për ta zvogëluar ndikimin e predikuesve ekstremistë midis të rinjve dhe të ofrojnë narrative alternative. Për më tepër, pjesëmarrësit në Kumanovë theksuan se udhëheqësit fetarë duhet të mendojnë për atë se si mund t'i përfshijnë më mirë të rinjtë për t'i kuptuar sfidat dhe realitetet moderne me të cilat përballen.

Megjithëse pjesa më e madhe e diskutimeve për komunitetet u fokusua në komunitetet fetare, disa pjesëmarrës në tryezat e rrumbullakëta iu referuan edhe fenomeneve më të gjera makro-sociale, siç është huliganizmi midis grupeve të tifozëve sportivë dhe nxitja për dhunë nga forumet rinore të partive politike. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Çair e identifikuan kulturën e dhunës në mesin e disa grupeve të tifozëve sportive si trampolina drejt ekstremizmit politik dhe fetar, nga njëra anë duke nënvizuar një marrëdhënie të veçantë midis grupeve të tilla dhe partive politike, dhe nga ana tjetër duke pretenduar se disa luftëtarë të huaj të njohur terroristë që u larguan nga Maqedonia e Veriut për të luftuar në Siri dhe Ukrainë, më parë kanë qenë pjesë e grupeve të tifozëve sportivë. Në Tetovë dhe Kumanovë, pjesëmarrësit theksuan se puna me klubet e futbollit dhe grupet e tyre të tifozëve duhet të jetë prioriteti kryesor për ta parandaluar përdorimin e gjuhës së urrejtjes dhe ekstremizmin e dhunshëm nacionalist. Sipas mendimit të pjesëmarrësve në Çair, duhet të krijohet një organ i posaçëm për t'i rregulluar grupet e tifozëve sportivë dhe për t'i sanksionuar ata për sjelljet e pahijshme. Ata gjithashtu u bënë thirrje të gjitha llojeve të palëve të interesit të komunitetit që ta dënojnë kolektivisht dhunën dhe urrejtjen e kryer nga grupet e tifozëve sportivë. Në këtë drejtim, pjesëmarrësit në Çair thanë se KOM-i kishte tentuar të vendosë kontakte me një grup të njohur të tifozëve sportivë nga Shkupi, që është i njohur për nxitje të incidenteve të dhunshme në bazë të intolerancës etnike dhe fetare, me qëllim të promovimit të vlerave pozitive morale.

Pjesëmarrësit në shumicën e tryezave të rrumbullakëta shprehën shqetësimin se partitë politike përhapin ekstremizëm dhe retorikë nacionaliste që shkakton polarizim në shoqëri. Në lidhje me forumet rinore të partive politike, pjesëmarrësit në Prilep theksuan se ata mund të luajnë një rol konstruktiv në parandalimin e anëtarëve të tyre për të përhapur narrative negative, gjuhë të urrejtjes dhe dhunë. Pjesëmarrësit në Strugë dhe Kërçovë vunë në dukje se në të kaluarën kishte pasur incidente të dhunës midis të rinjve në shkolla, të nxitura nga partitë politike gjatë periudhave zgjedhore. Në fund, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Kumanovë theksuan se komuniteti lokal në përgjithësi ka vështirësi për ta parandaluar gjuhën e urrejtjes në rrjetet sociale dhe për t'i eliminuar lajmet e rreme që të mos kenë ndikim të dëmshëm në shoqëri.

### 3.6. Arsimi dhe mbështetja e të rinjve në rrezik

Pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta identifikuan sfida të ndryshme me të cilat përballen të rinjtë që kontribuojnë në cënueshmërinë e tyre ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Në disa prej tryezave të rrumbullakëta, pjesëmarrësit e përmendën pesimizmin dhe demoralizimin që janë rezultat jo vetëm i mungesës së mundësive të drejtpërdrejta, por edhe i mungesës së personave që shërbejnë si shembuj për t'u ndjekur në shoqëri, në të cilën suksesi me sa duket vjen nga lidhjet personale e jo nga aftësitë, përvoja dhe integriteti. Në këtë situatë, pjesëmarrësit vunë në dukje se rinia mund të kërkojë një ndjenjë të përkatësisë duke u angazhuar në grupe ekstreme; prandaj të rinjtë kanë nevojë për mundësi për mentorim pozitiv dhe për të fituar aftësi udhëheqëse për të dhënë kontribute domethënëse për shoqërinë. Në mbështetje të tezës se rinia duhet të ndjehet e kuptuar dhe se ata i përkasin komuniteteve të tyre, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Kumanovë e përmendën rastin e një vajze, e cila u largua (dhe në fund u vra) në Siri, sepse ajo u ndje thellësisht e marginalizuar kur vendosi ta shprehë hapur besimin e saj fetar. Në një aspekt më pozitiv, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Gostivar folën për këshillin dhe qendrën rinore të krijuar në këtë komunë si mekanizma premtues për trajtimin e disa prej sfidave me të cilat përballen të rinjtë në rrezik.

Tryezat e rrumbullakëta nxorën në pah mangësi të mëdha në funksionimin e sistemit arsimor në Maqedoninë e Veriut, të cilat në masë të madhe e zvogëlojnë aftësinë e sistemit për të ofruar alternativa të vlefshme për të rinjtë në rrezik. Njëra nga gjetjet më të dalluara të tryezave të rrumbullakëta është se EDhRÇT-ja në mesin e të rinjve në Maqedoninë e Veriut ushqehet nga ndarjet e thella shoqërore, të cilat reflektohen edhe në sistemin arsimor. Në radhë të parë, ndarja sipas gjuhës mësimore i kufizon kontaktet midis nxënësve nga bashkësi të ndryshme etnike, dhe, në shumë raste, edhe atyre fetare. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Tetovë theksuan se situata aktuale e ndarjes së nxënësve është rezultat i pamundësisë së institucioneve relevante për ta trajtuar rrimërtimin e shkollave në mënyrë që nuk do të krijonte „fitues dhe humbës“. Për më tepër, në shumicën e shkollave, është bërë shumë pak për ta promovuar multikulturalizmin midis nxënësve, dhe disa tekste shkollore përmbajnë material fyes dhe me orientim nacionalist, që kontribuon në polarizim dhe marginalizim, veçanërisht kur bëhet fjalë për pakicat etnike. Në fund, pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta në Çair, Kumanovë dhe Prilep shprehën shqetësime për efektet që i kanë pikëpamjet ekstremiste të mësimdhënësve mbi nxënësit, me ç'rast pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Çair e përmendën një rast konkret në të cilin një mësimdhënës kishte nxitur ekstremizëm të dhunshëm në klasë. Mirëpo, një pjesëmarrës në tryezën e rrumbullakët në Shtip përmendi shembull të kundërt në një shkollë fillore lokale, në të cilën kultivimi i marrëdhënive të

mira ndëretnike dhe i miqësive ndërmjet bashkësive etnike kanë rezultuar të efektshme në parandalimin e EDhRÇT-së.

Në disa tryeza të rrumbullakëta, pjesëmarrësit i përmendën manifestimet e polarizimit politik në sistemin shkollor. Disa pjesëmarrës theksuan se tendenca që mësimdhënësit të punësohen në bazë të përkatësisë politike bën që të ketë një pabarazi të konsiderueshme në nivelin e aftësive në mesin e mësimdhënësve. Kjo tendencë i vendos mësimdhënësit në një pozitë të vështirë për të komunikuar me udhëheqjen e shkollës për atë që është e nevojshme për ta rritur cilësinë e arsimit, që e shton edhe më tepër mbingarkesën e mësimdhënësve si rezultat i klasave me numër të madh të nxënësve, gjë që e pengon punën individuale me nxënësit, veçanërisht me të rinjtë në rrezik. Ndoshta më shqetësuese janë rastet e raportuara nga pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta, në të cilat mësimdhënësit dhe nxënësit e lidhur mirë sollën armë në ambientet e shkollës dhe iu kërcënuan mësimdhënësve dhe/ose nxënësve, duke kontribuar kështu në normalizimin e kulturës së dhunës.

Duke marrë parasysh fenomenet e përshkruara në paragrafët e mësipërm, mbasenuka asgjëbefasuese në gjetjen e hulumtimit që u citua nga pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët në Prilep, se nxënësve u mungon besimi tek mësimdhënësit dhe shërbimet profesionale të shkollës dhe për këtë arsye kanë prirje të mos i ndajnë shqetësimet e tyre me ta. Megjithatë, pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta në Çair dhe Kumanovë ofruan shembuj të praktikës së mirë në ofrimin e mbështetjes për të rinjtë në rrezik. Në Çair, kur fëmija shfaq sjellje devijuese, mësimdhënësi i fëmijës i fton prindërit të diskutojnë së bashku me pedagogun dhe psikologun e shkollës. Në Kumanovë, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët raportuan bashkëpunim të shkëlqyeshëm midis shërbimeve profesionale të shkollave dhe OShC-ve lokale.

Pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta u pajtuan plotësisht për vlerën e aktiviteteve jashtë-mësimore për t'u ofruar të rinjve qasje në aktivitete konstruktive gjatë kohës së lirë. Megjithatë, në të njëjtën kohë, pjesëmarrësit theksuan se mbingarkesa e përhapur e shkollave me numër të madh të nxënësve që çon në funksionimin e tyre në dy ose më shumë ndërrime do të thotë që shumë shkollave u mungon hapësira për të ofruar aktivitete jashtë-mësimore, edhe nëse ato janë planifikuar në programin e shkollës. Në tryezat e rrumbullakëta gjithashtu u përmend se nxënësit më të rrezikuar po ashtu kanë më shumë gjasa të përjashtohen nga aktivitetet e tilla, pasi që shpesh përparësi u jepet nxënësve me sukses më të mirë. Në Gostivar dhe Tetovë, autoritetet komunale kanë ndërmarrë hapa për ta adresuar këtë situatë duke shpërndarë resurse për aktivitete jashtë-mësimore: në qendrën rinore dhe të komunitetit në Gostivar mblidhen së bashku gjashtë organizata rinore, ndërsa komuna e Tetovës ka siguruar hapësirë dhe mbështetje logjistike për një rrjet të krijuar së fundmi të vullnetarëve të rinj që shërbejnë si nikoqirë për aktivitete.



Një temë që ngjalli debat midis pjesëmarrësve në tryezat e rrumbullakëta ishte potenciali i Këshillave lokalë për parandalimin e delikuencës së të miturve për të luajtur rol në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Pjesëmarrësit në Tetovë dhe Veles ishin përgjithësisht pozitivë për këtë, ndërsa një pjesëmarrës në Shtip kishte qëndrimin se këto këshilla nuk janë të përshtatshme për trajtimin e EDhRÇT-së. Në tryezat e rrumbullakëta gjithashtu u përmend se organizatat rinore të partive politike duhet të angazhohen në përpjekjet për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm.

### 3.7. Mirëqenia sociale dhe shëndeti mendor

Duke pasur parasysh se nxitësit e mundshëm për EDhRÇT përfshijnë marginalizimin shoqëror dhe papunësinë kronike, diskutimet në tryezat e rrumbullakëta gjithashtu i shtjelluan edhe masat e marra nga institucionet e mirëqenies sociale për t'i adresuar këto fenomene, në veçanti se si ndikojnë ato mbi rininë. Përveç kësaj, u theksua se masat për adresimin e papunësisë kanë tendencë të fokusohen te personat që kanë të kryer arsim të mesëm ose të lartë, duke i lënë jashtë grupet e marginalizuara tradicionalisht, siç janë romët.

Një pikëpamje e përbashkët e pjesëmarrësve në tryezat e rrumbullakëta është se qendrat për punë sociale kanë përvojë të gjerë në trajtimin e formave të ndryshme të sjelljeve antisociale, por atyre u mungon ekspertiza e specializuar për ta kuptuar ekstremizmin e dhunshëm dhe rreziqet që lidhen me të. Për më tepër, qendrat e punës sociale kanë mungesë të burimeve të nevojshme për zhvillimin dhe shpërndarjen e kapaciteteve përkatëse, me ç'rast pjesëmarrësit në Kumanovë theksuan se punonjësit e qendrës lokale për punë sociale tashmë ishin duke punuar në baza vullnetare për ta zbatuar programin ekzistues. Një sugjerim ishte që të formohet një qendër e centralizuar me një grup ekspertësh të lëvizshëm që do t'i këshillojnë praktikuesit në nivel lokal.

Tryezat e rrumbullakëta gjithashtu e theksuan nevojën që qendrat e punës sociale të punojnë më për së afërmi me shkollat fillore dhe të mesme për të ofruar mbështetje për të rinjtë e cenusshëm. Duke pasur parasysh faktin se shumica e mësimdhënësve nuk kanë kohë dhe shkathtësi të nevojshme për ta mbështetur në mënyrë aktive zhvillimin shoqëror të nxënësve, roli i punonjësve për ndihmë psiko-sociale të punësuar në shkollë fiton një rëndësi të veçantë. Megjithatë, polarizimi politik dhe numri tepër i madh i nxënësve në shkolla, në përgjithësi ndikojnë në këtë kategori të punonjësve në të njëjtën mënyrë siç ndikojnë edhe mbi mësimdhënësit, me ç'rast numri i nxënësve në shumë shkolla është tepër i madh për numrin e punonjësve për ndihmë psiko-sociale të punësuar në shkollë, ndërsa disa shkolla nuk kanë pedagog dhe/ose psikolog. Edhe atëherë kur punonjësit e tillë ekzistojnë në numër të mjaftueshëm, ata shpesh nuk kanë ndjekur trajnime për të kuptuar fenomenin



e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe si mund të adresohet.<sup>10</sup> Pjesëmarrësit vunë në dukje se është e rëndësishme që të rinjtë të ndjehen të dëgjuar, të jenë në gjendje t'i shprehin mendimet e tyre dhe të ndjejnë se mund t'i identifikojnë problemet dhe shqetësimet e tyre tek të rriturit tek të cilët kanë besim. Prandaj, mësimdhënësit, pedagogët, psikologët e shkollës dhe prindërit duhet të përfshihen më shumë në bashkëpunimin me të rinjtë. Në adresimin e delikuençës së të rinjve dhe sjelljes së dhunshme, pjesëmarrësit gjithashtu kërkuar që rastet e tilla të trajtohen së pari nga pedagogët dhe psikologët e shkollës, në vend që të përfshihet policia para kohe. Për më tepër, u propozua që të krijohen programe të specializuara që të rinjtë ta shpërbëjnë kulturën e normalizuar të dhunës dhe të ndihmojnë në përpunimin e lajmeve dhe ngjarjeve globale që mund ta shqetësojnë psikikën e të rinjve.

Pjesëmarrësit gjithashtu theksuan se qendrat e punës sociale duhet të përqendrohen më shumë në adresimin e problemit të mosfunksionimit të familjes, pasi dhuna në familje mund të inkurajojë më tej sjelljen e dhunshme dhe ekstremiste të individëve të rinj. Përpyekjet e tilla do ta mbështesnin gjithashtu edhe punën e punonjësve për ndihmë psiko-sociale të punësuar në shkollë, të cilët sipas legjislacionit aktual e kanë të ndaluar të kenë informacione mbi gjendjen familjare të nxënësve, përkundër dëshmimeve thelbësore se një pjesë e madhe e nxënësve që kërkojnë mbështetje vijnë nga familjet në gjendje të pafavorshme sociale dhe/ose familjet jofunksionale. Disa pjesëmarrës në tryezat e rrumbullakëta gjithashtu theksuan se qendrat për punë sociale nuk janë gjithmonë të gatshme t'u ndihmojnë punonjësve për ndihmë psiko-sociale të punësuar në shkollë kur kontaktohen për ndonjë nxënës të veçantë.

Pjesëmarrësit gjithashtu identifikuan se qendrat lokale të punës sociale duhet të angazhohen në zbatimin e programeve për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të referuar, të vlerësuar si të prekshëm ndaj EDhRÇT-së. Në tryezën e rrumbullakët në Strugë gjithashtu u potencua se ka mungesë të njohurive se si personat që lirohen nga sistemi i burgjeve mund të risocializohen në mënyrë adekuate dhe të riintegrohen në komunitete me mbështetje adekuate, për t'u siguruar se ata nuk do të cenohen nga grupet ekstremiste të dhunshme. Në disa tryeza të rrumbullakëta u sugjerua se udhëheqësit fetarë mund të luanin një rol në ofrimin e mentorimit mbi baza teologjike gjatë rehabilitimit dhe riintegrimin, megjithëse shpesh herë atyre u mungon trajnimi më i specializuar për ofrimin e mbështetjes dhe këshillimit psikologjik.

Në fund, në tryezat e rrumbullakëta u theksua se tabutë sociale dhe kulturore rreth shëndetit mendor çojnë në stigmatizim dhe barriera shtesë për individët që të kenë qasje në shërbimet mbështetëse të shëndetit mendor në komunitet.

10 Një trajnim i këtij lloji u krye nga OSBE-ja së bashku me KKKEDhKT-në dhe u fokusua në identifikimin e rreziqeve të radikalizimit







## 4. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Në këtë seksion janë dhënë përfundimet, të kombinuara me disa rekomandime, për çështje që u identifikuan si sfida gjatë diskutimeve. Ato janë sintetizuar nga gjetjet në secilën fushë tematike dhe ofrojnë udhëzime se si të promovohet qasja shumë-palëshe në P/KEDhRÇT.

### 4.1. Kapacitetet për qasjen që e përfshin gjithë shoqërinë ndaj P/KEDhRÇT-së (punonjësit e trajnuar; infrastruktura; mjetet financiare)

#### 4.1.1. Punonjës të trajnuar në mënyrë adekuate

Qasja që e përfshin gjithë shoqërinë ndaj P/KEDhRÇT-së u mbështet në të gjitha tryezat e rrumbullakëta që u organizuan. Megjithatë, njëra nga sfidat kryesore të identifikuar gjatë diskutimeve ishte mungesa e trajnimeve për të siguruar kuptim dhe vetëdijesim për parimet dhe qasjet e promovuara nga qeveria qendrore përmes strategjive kombëtare dhe planeve aksionale. Palët e interesuara ranë dakord se kjo ishte një mangësi sistemore që paraqitet gjatë koordinimit me institucionet e tyre amë, dhe theksuan se kjo mangësi është veçanërisht e dukshme kur asnjë institucion nuk e ka për detyrë të marrë rolin udhëheqës në trajtimin e çështjeve ndërsektoriale.

Pjesëmarrësit ngritën shqetësime në lidhje me përfshirjen e mësimdhënësve në P/KEDhRÇT. Një perceptim i përgjithshëm i mësimdhënësve në të gjitha fushat ishte se ata nuk e konsiderojnë veten të përshtatshëm për t'u përfshirë në parandalim nëse nuk posedojnë një nivel të caktuar të ekspertizës. Trajnimi i specializuar i mësimdhënësve ishte prioritet pothuajse në çdo tryezë të rrumbullakët. Rekomandimi që doli nga këto shqetësime ishte se vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet faktit se ndërhyrjet për P/KEDhRÇT duhet t'i respektojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, duke i përfshirë edhe të drejtat e fëmijëve.

Në shumicën e tryezave të rrumbullakëta, përfaqësuesit e OShC-ve vazhdimisht ua rikujtonin mësimdhënësve dhe të tjerëve se aftësitë ekzistuese mund

të zbatohen në programet e parandalimit. Këto aftësi mund të përfshijnë (por nuk duhet të kufizohen vetëm në) mentorimin dhe këshillimin, mbështetjen pedagogjike, dëgjimin aktiv ose strategjik, aftësitë e komunikimit, ndërmjetësimin dhe të menduarit kritik. Si rezultat i kësaj, pjesëmarrësit në shumicën e tryezave të rrumbullakëta shfaqën një ndryshim të perceptimeve në lidhje me aftësitë e tyre për t'u përfshirë në P/KEDhRÇT pas diskutimeve fillestare, pasi u ngrit vetëdija e tyre për aftësitë ekzistuese që mund të përdoren. Në të njëjtën kohë, nëse trajnimi i mësimdhënësve nuk është adekuat dhe në përputhje me të drejtat e njeriut dhe qasjen për të mos bërë dëm, ekziston rreziku që ai të rezultojë me thjeshtësimin e tepërt të çështjeve kryesore.

Punonjësit socialë dhe psikologët kërkuar respektimin e autonomisë së fushave të tyre profesionale. Megjithatë shprehën gatishmëri për të marrë pjesë në programet e parandalimit, pjesëmarrësit në këto kategori e theksuan nevojën për t'i rezistuar kërkesave nga organet e zbatimit të ligjit për t'i shkelur kodet etike që e sigurojnë besimin e shfrytëzuesve të mbështetjes psiko-sociale. Në disa komuna, punonjësit socialë dhe psikologët që morën pjesë në tryezat e rrumbullakëta prezantuan një bashkëpunim të suksesshëm ndër-institucional në parandalimin e sjelljeve të tjera antisociale, siç është delikuenca e të miturve. Sipas mendimit të këtyre pjesëmarrësve, duhet të rriten kapacitetet e punonjësve profesionalë dhe duhet të ofrohet një kuptim i plotë i koncepteve të P/KEDhRÇT-së përmes trajnimeve të specializuara.

Përfaqësuesit e komunave dhe të institucioneve lokale kërkuar që të ofrohen trajnime të specializuara nga autoritetet e nivelit qendror dhe nga Komiteti Kombëtar për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit (KKKEDhKT). Më konkretisht, secila prej ministrive të përfaqësuara në KKKEDhKT duhet të ofrojë trajnime në nivel lokal përpara se të përpiqet të krijojë plane lokale për zbatimin e P/KEDhRÇT-së.

Ndërrimi i madh i punonjësve në disa institucione e pengon qëndrueshmërinë e ngritjes së kapaciteteve, si dhe të mekanizmave parandalues që mund të krijohen në nivel lokal. Pjesëmarrësit gjithashtu rekomanduan që të bëhet vlerësim i pajtueshmërisë për këdo që dëshiron të përfshihet në ndërhyrjet e P/KEDhRÇT-së, pasi që disa profesionistë në fushën e tyre mund të shprehin pikëpamje mbështetëse ose të favorshme për EDhRÇT-në.

#### 4.1.2. Infrastruktura

Trendet e fundit globale demonstrojnë se komunitetet kanë një rol vendimtar në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, me ç'rast qasjet e bazuara në komunitet për parandalimin janë dëshmuar si të dobishme

në plotësimin e qasjes së bazuar në zbatimin e ligjit ndaj sigurisë. Sfida më e madhe e identifikuar nga komunitetet ishte mungesa e infrastrukturës, goftë fizike apo e butë (d.t.th., institucionet), për sigurimin e hapësirës dhe forumit për komunitetet për të kontribuar në parandalim. Edhe pse të gjithë pjesëmarrësit ranë dakord se qeveritë nuk mund të vetme ta parandalojnë dhe t'i kundërvihen ekstremizmit të dhunshëm, komunitetet kërkuan që strategjitë kombëtare ta reflektojnë nevojën për të ndërtuar infrastrukturë fizike dhe të butë për P/KEDhRÇT.

Pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta i përmendën fondet e kufizuara për aktivitete jashtë-mësimore dhe mungesën sistemore të hapësirës. Ata gjithashtu e theksuan edhe mungesën e psikologëve përkundër kërkesave të vazhdueshme. Në anën tjetër, disa autoritete komunale kanë caktuar vende joformale për të punuar me të rinjtë ose për kontakt me komunitetin. Ekzistonte një pajtim i gjerë midis pjesëmarrësve në tryezat e rrumbullakëta se partneritetet për parandalimin e EDhRÇT-së formohen më së miri nga vetë komunitetet, me mbështetje nga institucionet dhe organizatat e shoqërisë civile. Megjithatë, mbetet nevoja që autoritetet qendrore dhe lokale t'i koordinojnë përpjekjet e komunitetit duke krijuar një infrastrukturë për ta mbështetur punën e komuniteteve, institucioneve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile.

Institucionet lokale pranuan se ekzistojnë paqartësi në përcaktimin e roleve të palëve të interesuara në parandalim. Një nga shqetësimet më të mëdha është mungesa e njohjes së parandalimit si kompetencë e përgjithshme, goftë nga komunat që kanë kompetencë mbi shkollat, ose nga institucionet e kujdesit shoqëror dhe shëndetësor ose institucionet e tjera. Për ta promovuar një qasje shumë-sektoriale, duhet të krijohen kanale të komunikimit dhe të bashkëpunimit. Shumica e institucioneve lokale janë të kufizuara në bashkëveprimet e tyre nga ana e institucioneve të tyre amtare në nivelin qendror dhe nuk u përgjigjen kërkesave të institucioneve të tjera, gjë që rezulton me situatë që veprimet të ndërmerren vetëm kur kjo kërkohet nga institucioni amë ose nga autoritetet e tjera qendrore.

### 4.1.3. Financat

Një nga shqetësimet kryesore të shprehura nga palët e interesuara që morën pjesë në tryezat e rrumbullakëta ishte se atyre u mungojnë mjetet financiare për t'u përfshirë në aktivitetet ose ndërhyrjet e P/KEDhRÇT-së. Palët e interesuara institucionale raportuan se atyre u mungon fleksibiliteti në buxhetet e tyre, të cilat janë të paracaktuara nga institucionet e tyre amë. Nga ana tjetër, udhëheqësit e komunitetit dhe ata fetarë nuk kanë burime dhe kapacitete për



t'i menaxhuar fondet. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e komunave theksuan se ata mund të gjejnë modalitete për t'i financuar ndërhyrjet në P/KEDhRÇT, por fondet do të ishin të kufizuara dhe do të merreshin nga fondet për obligime të tjera të komunës. Në anën tjetër, OShC-të që merren me P/KEDhRÇT-në ose çështje të lidhura me të, deklaruan se financat nuk ishin shqetësimi i tyre më i madh, dhe në vend të kësaj ata e theksuan nevojën për më shumë mbështetje institucionale dhe për trajnime për ngritjen e kapaciteteve.

Gjatë tryezave të rrumbullakëta, koordinatori kombëtar për KEDh dhe KT dhe dy zëvendës-koordinatorët i siguruan palët e interesuara se donatorët janë të interesuar t'i financojnë iniciativat lokale. Në të njëjtën kohë, ata theksuan se për të marrë fonde, duhet të hartohet një plan lokal i zbatimit në përputhje me Strategjinë Kombëtare për KEDh. Në disa komuna, u bënë kërkesa që donatorët të konsultohen me komunitetet për nevojat dhe prioritetet para planifikimit të ndërhyrjeve.

## 4.2. Bashkëpunimi ndërinstitucional

Segmenti më i vështirë për t'u adresuar në promovimin e qasjes shumë-palëshe është bashkëpunimi ndërmjet agjencive. Megjithëse bashkëpunimi i tillë është i vështirë në çdo fushë tematike, në rastin e P/KEDhRÇT-së ai bëhet edhe më sfidues për shkak të trashëgimisë së sekuritizimit. Veçanërisht në komunat ku nuk janë zbatuar iniciativa të P/KEDhRÇT-së, institucionet lokale kishin vështirësi ta kuptojnë rolin e tyre në adresimin e ekstremizmit të dhunshëm kur u kontaktuan gjatë përgatitjes së tryezave të rrumbullakëta. Si rezultat i kësaj, tryezat e rrumbullakëta shërbyen si një forum i shkëlqyeshëm për debat, ngritje të vetëdijes, thyerje të tabuve rreth temave të sekuritizuara, dhe promovim të bashkëpunimit dhe inkluzivitetit të komunitetit.

Në tryezat e rrumbullakëta, u shkëmbyen praktikat e mira dhe mësimet e nxjerra në lidhje me organet shumë-palëshe të formuara për të adresuar çështje të ndryshme. Në përgjithësi, institucionet nuk kishin ndonjë kriter për delegimin ose caktimin e personelit të duhur në komisione ose organe të tilla. Për më tepër, ekspertiza joadekuate e anëtarëve e dëmtoi besueshmërinë dhe funksionimin e përpjekjeve të tilla. Kjo situatë u përkeqësua nga polarizimi politik brenda institucioneve relevante, pasi ekspertët në fushën e tyre nuk u avancuan për të punuar në organet shumë-palëshe sepse individë të tjerë u emëruan politikisht.

Mungesa e hierarkisë dhe e linjave të raportimit për punën e organeve shumë-palëshe rezultoi me mosdhënie të llogarisë për veprimet që ndërmerren. Anëtarët e organeve të tilla raportuan se nuk kishin mbështetje nga menaxherët e tyre, të cilët nuk arritën ta kuptojnë kompetencën e organeve

për parandalimin, si dhe legjitimitetin e përfundimeve dhe vendimeve të marra nga organet e tilla.

Mungesa e stimujve, të tillë si p.sh. kompensimi financiar për pjesëmarrje të rregullt në punën e organeve, po ashtu u identifikua si e dëmshme për organet shumë-palëshe. Arsyetimi për mungesë nga puna gjithashtu u përmend si një çështje që çon në probleme në koordinimin e takimeve.

Ka mungesë të bashkëpunimit vertikal dhe horizontal në fusha të ndryshme që lidhen me P/KEDhRÇT-në. Pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta theksuan se institucionet lokale në përgjithësi punojnë në hapësira të izoluara në komuna. Si rezultat i kësaj, përfaqësuesit e këtyre institucioneve shpesh nuk janë të vetëdijshëm për aktivitetet e të tjerëve dhe përputhen në çështje ose punojnë me të njëjtat palë të interesuara. Në dritën e kësaj shtate, mund të pritet që qasja shumë-palëshe ta ngrejë vetëdijen dhe bashkëpunimin.

Deri më tani, janë formuar organe të ndryshme shumë-palëshe në komunat e përzgjedhura për parandalimin e kategorive të veçanta të sjelljeve anti-sociale, siç është delikuenca e të miturve dhe dëmet që lidhen me alkoolin ose drogën. Këshillat Lokalë për Parandalim dhe Grupet Këshilluese Qytetare, të promovuara fillimisht nga Misioni i OSBE-së në Shkup, u përmendën si shembuj pozitivë të mekanizmave ekzistues parandalues në disa komuna. Megjithatë, në komuna të ndryshme u ngritën shumë sfida në lidhje me krijimin e mekanizmave plotësisht funksional parandalues. Më e rëndësishmja, pjesëmarrësit e theksuan nevojën për t'i vlerësuar mekanizmat e paqëndrueshëm dhe për të mbledhur informacion se pse organet e tilla pushuan së funksionuari, si bazë për ta përmirësuar dizajnimin e mekanizmave parandalues për P/KEDhRÇT që mund të krijohen.

### 4.3. Koordinimi midis autoriteteve qendrore dhe lokale

Shpërndarja e përgjegjësive dhe mekanizmat për bashkëveprim midis autoriteteve lokale dhe atyre qendrore rregullohen nga parimet e përcaktuara në Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale. Dispozita e kompetencave të përgjithshme specifikon se ndarja e kompetencave dhe përgjegjësive sipas ligjit shkon së bashku me njohjen e kompetencës së autoriteteve lokale për të ndërhyrë në çdo çështje me interes lokal. Në përputhje me këtë, pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta kishin qëndrimin se komunat janë në pozitë më të mirë për ta mbështetur mekanizmin lokal parandalues shumë-palësh dhe iniciativat e tjera për P/KEDhRÇT.

Përfaqësuesit e komunave thanë se për të funksionuar si duhet iniciativat e tilla, pushteti qendror duhet të vendosë bashkëpunim dhe të ofrojë trajnime për ngritjen e kapaciteteve. Ata i identifikuan mospërputhjet midis prioriteteve kombëtare dhe lokale të institucioneve dhe vështirësitë për të kërkuar ndryshime në buxhet si sfidat më të mëdha në përpjekjet për ta përqendruar punën e tyre në një fushë të re, siç është P/KEDhRÇT-ja. Kishte konsensus nga të gjitha institucionet lokale në komunat e përzgjedhura se duhet të krijohet mbështetje kombëtare nga lart-poshtë për të gjitha fushat e ndjeshme, e veçanërisht për P/KEDhRÇT-në. Institucionet lokale gjithashtu raportuan vështirësi në shpërndarjen e kohës dhe të burimeve dhe për pamundësinë për t'i zbatuar planet aksionale kur çështjet e nivelit lokal nuk janë të përfshira në planet kombëtare aksionale.

Shkupi dhe Tetova ishin dy komunat që ishin më të hapura për organizimin e tryezave të rrumbullakëta të diskutuara në këtë raport, pasi Misioni i OSBE-së në Shkup më herët gjatë këtij viti kishte bërë konsultime publike për Strategjinë Kombëtare dhe Planin Aksional për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm. Kjo demonstroi se përfshirja e të gjitha palëve të interesuara në vendimmarrje në nivelin lokal e promovon pranimin dhe përkushtimin ndaj planit aksional të nivelit kombëtar, pasi që e trajton dinamikën lokale dhe problemet e komunitetit.

Nga ana e tyre, autoritetet qendrore i pranojnë komunat si institucione që luajnë një rol kritik në ndërmjetësimin me qytetarët. Pjesëmarrësit në tryezat e rrumbullakëta rekomanduan që qeveria qendrore ta konsiderojë krijimin e mekanizmave për integrimin shumë-palësh për menaxhimin e politikave dhe rregulloreve që i prekin komunat, veçanërisht politikën që merren me tema të ndjeshme.

Mungesa e komunikimit horizontal dhe vertikal u përmend si shkak për pasivitetin e institucioneve dhe mungesën e aktiviteteve për parandalimin e EDhRÇT-së. Komunikimi i vazhdueshëm ndër-institucional ka një rëndësi të madhe për zbatimin e suksesshëm të politikave, pasi që favorizon një kuptim më të mirë të politikave dhe mundëson monitorim, ndihmë, këshilla dhe konsultim në lidhje me mosmarrëveshjet. Duke pasur parasysh këtë, institucionet kombëtare duhet të mbajnë informime të rregullta për t'i informuar aktorët relevantë në nivel kombëtar dhe lokal për veprimet strategjike të ndërmarra në adresimin e EDhRÇT-së.

U propozua gjithashtu trajnimi i vazhdueshëm i profesionistëve që punojnë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, pasi trajnimet që mbahen vetëm një herë nuk ofrojnë mbështetje dhe udhëzim të duhur për trajtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm. Kjo kërkesë ishte veçanërisht

e zakonshme në mesin e mësimdhënësve dhe punonjësve të shërbimit profesional të shkollave, të cilët e theksuan nevojën e paplotësuar për zhvillim të vazhdueshëm profesional në fushën e parandalimit të EDhRÇT-së dhe të sjelljeve të tjera anti-sociale. Megjithëse komunat kanë kompetencë të përgjithshme mbi arsimin, për të bërë ndryshime në aktivitetet mësimore nevojitet miratimi i Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, gjë që dëshmon se për trajtimin e P/KEDhRÇT-së nevojitet qasje shumë-palëshe.

Hulumtuesit hasin në vështirësi për të marrë të dhëna dhe statistika për EDhRÇT-në, të cilat kryesisht janë të klasifikuara. Institucionet shtetërore gjithashtu kanë nevojë për të dhëna statistikore për planifikimin e duhur të strategjive dhe planeve aksionale. Në mënyrë ideale, të dhënat e nevojshme mund të merren në nivel lokal nga hulumtuesit që komunikojnë me praktikuesit dhe palët e interesuara lokale, dhe më pas të ndahen me organet kombëtare të koordinimit. Përpjekjet e tilla u përmendën nga përfaqësuesit e shoqërisë civile me përvojë në krijimin e rrjeteve të praktikuesve që punojnë në fushën e njëjtë. Megjithatë, institucionet lokale, komunat dhe aktorët e pushtetit qendror përmendën sfida në krijimin e kornizës për bashkëpunim, veçanërisht kur bëhet fjalë për bashkëpunimin vertikal dhe atë horizontal.

Në përgjithësi, dështimi i institucioneve lokale për ta njohur rolin e tyre në parandalim i ka dëmtuar reagimet institucionale për adresimin e EDhRÇT-së. Perceptimi i përgjithshëm i shumicës së institucioneve lokale ishte se pasi të shfaqet problemi, ata do të veprojnë me qëllim të zbutjes së dëmit dhe trajtimit të pasojave. Vetëm disa komuna që kishin parë praktika të mira dhe rezultate nga qasja shumë-palëshe ishin të hapura për adresimin e EDhRÇT-së përmes organeve shumë-palëshe të ngjashme të koordinuara. Konsensusi i përgjithshëm ishte se duhet bërë më shumë punë për t'u mundësuar institucioneve t'i mbështesin iniciativat e parandalimit në nivel lokal, dhe se koordinimi midis aktiviteteve qendrore dhe atyre lokale është me rëndësi thelbësore për t'i operacionalizuar strategjitë dhe planet aksionale për KEDh.







# 5. PRAKTIKAT MË TË MIRA TË REKOMANDUARA PËR PROGRAMIN E P/KEDHRÇT

Në këtë seksion janë dhënë rekomandimet kryesore për praktikat më të mira që mund të zbatohen në dizajnimin dhe zbatimin e programeve për P/KEDHRÇT. Praktikrat më të mira të rekomanduara rrjedhin nga njohuritë dhe mësimet e nxjerra nga gjetjet e tryezave të rrumbullakëta të marra së bashku si tërësi.

- 1. Përfaqësimi për bashkëpunim të gjerë të palëve të interesuara duke e përdorur qasjen e përfshirjes së gjithë shoqërisë.** Të mblidhen aktorë të rëndësishëm nga shoqëria civile dhe sektorë të ndryshëm institucionalë, duke e siguruar posaçërisht përfshirjen e praktikuesve me përvojë në parandalimin e formave të tjera të dhunës dhe sjelljeve të rrezikshme sociale. Kjo qasje i njeht rrënjët shoqërore të EDhRÇT-së dhe lejon ndërhyrje të hershme dhe zgjidhje jo-detyruese kur individët ose komunitetet janë në rrezik duke i adresuar faktorët që janë të favorshëm për EDhRÇT-në.
- 2. Programe të përshtatura me kontekstin lokal duke u dhënë përparësi zgjidhjeve të udhëhequra nga kërkesat.** Çdo komunë e ka kontekstin dhe sfidat e veta të veçanta që e pamundësojnë qasjen që është e përshtatshme për të gjitha situatat për zbatimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit Aksional. Duhet të bëhet një vlerësim i nevojave lokale që përfshin analizë të të gjitha formave të fenomenit të EDhRÇT-së dhe të burimeve që mund të shfrytëzohen në parandalim. Duhet të bëhen përpjekje për t'i ngritur kapacitetet ekzistuese dhe programet e shoqërisë civile lokale.

- 3. Përfshirja e drejtpërdrejtë e aktorëve lokalë në programet e P/KEDhRÇT-së.** Të promovohet fuqizimi i mirëfilltë i palëve të interesuara lokale përmes konsultimit dhe pjesëmarrjes së tyre në proceset e vendimmarrjes; të lehtësohet përfshirja e grupeve të marginalizuara dhe të nën përfaqësuara, siç janë komunitetet pakicë, të rinjtë dhe gratë, të cilët gjithashtu mund të sjellin zëra dhe nevoja të ndryshme në tryezën e diskutimit.
- 4. Zbatimi i këndvështrimit që është i ndjeshëm ndaj konflikteve në planifikimin dhe dizajnimin e programeve.** Të kuptohet dinamika dhe ndjeshmëritë lokale rreth ndarjeve ndëretnike, fetare dhe politike, që shkaktojnë tensione dhe mosbesim, si dhe nevoja për ndërtimin e besimit midis qytetarëve dhe institucioneve, siç janë organet e zbatimit të ligjit. Të ndërmerren hapa për ta promovuar ndërtimin e besimit dhe dialogun në komunitet për çështje të ndjeshme që lidhen me EDhRÇT-në. Kur është e mundur, të bëhen përpjekje për ta trajtuar trashëgiminë e konflikteve lokale dhe kombëtare dhe problemet e komunitetit si faktorë të favorshëm për EDhRÇT-në.
- 5. T'u jepet përparësi aspekteve që lidhen me të drejtat e njeriut dhe parimit të mosshkaktimit të dëmit.** Është me rëndësi thelbësore të bëhet një vlerësim i plotë i rrezikut në dizajnimin e projektit që të zbutet stigmatizimi i paqëllimshëm ose shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, siç është liria e fesë ose e besimit. Të sigurohet që përpjekjet e P/KEDhRÇT-së të mos përfshijnë në mënyrë disproporcionale ndonjë bashkësi të caktuar etnike ose fetare, që të shmanget interpretimi i përpjekjeve të tilla si profilizim ose diskriminim. Gjithashtu nevojitet etikë profesionale dhe masa mbrojtëse kur punohet me fëmijë dhe adoleshentë, që i mbrojnë të drejtat specifike dhe mirëqenien e personave në këto grupe duke e parandaluar ekspozimin ndaj stigmatizimit të panevojshëm.
- 6. Të sigurohet se zgjidhjet e P/KEDhRÇT-së janë të përqendruara te njerëzit.** Përpjekjet duhet të përqendrohen në forcimin e faktorëve mbrojtës për komunitete rezistuese dhe mbështetjen e mirëqenies së individëve. Qasjet që janë tepër të bazuara në siguri rrezikojnë t'i dëmtojnë partneritetet me komunitetet dhe palët e interesuara institucionale duke u fokusuar në zbulimin e kërcënimeve në vend që t'i adresojnë faktorët themelorë të EDhRÇT-së dhe ta japin mbështetjen e nevojshme për individët në nevojë. Kujdes gjithashtu duhet t'i kushtohet edhe respektimit të pavarësisë, vlerave normative dhe angazhimeve profesionale të praktikuesve në shoqërinë civile, arsim, institucionet fetare, institucionet e shëndetit mendor dhe të mirëqenies sociale.

- 7. Të kihet kujdes rreth përfshirjes së parakohshme të organeve të zbatimit të ligjit.** Ndërtimi i partneriteteve ndërmjet policisë dhe komunitetit të bazuara në besim dhe bashkëpunim kërkon kultivimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me kalimin e kohës, të cila duhet të jenë krijuar para se të angazhohen komunitetet lokale në çështjen shumë të ndjeshme të EDhRÇT-së në mënyrë që të shmangen keqkuptimet dhe stigmatizimi. Në rastet që kanë të bëjnë me individët e cenuseshëm, përfshirja e policisë në hapësirën jo-penale, kur nuk ka asnjë kërcënim të besueshëm që është imediat, mund të çojë në stigmatizim dhe ndoshta mund ta shtyjë individin edhe më shumë në rrugën e radikalizimit.
- 8. Të koordinohen përpjekjet e qeverisë qendrore dhe lokale dhe të komunitetit të donatorëve ndërkombëtarë.** Numri tepër i madh i aktiviteteve dhe niveli disproporcional i vëmendjes që i kushtohet P/KEDhRÇT-së në një komunitet të caktuar mund të rezultojë me zhvendosjen e çështjeve të tjera të rëndësishme. Më pas kjo situatë mund të çojë në stigmatizim të synuar dhe mbingarkesë të burimeve.
- 9. Të përfshihen aspektet gjinore në dizajnimin e iniciativave të P/KEDhRÇT-së.** Të promovohet fuqizimi domethënës i grave në formimin e përpjekjeve për ta parandaluar dhunën duke krijuar mundësi origjinale për të luajtur një rol transformues në shoqëri. Të shmangët instrumentalizimi i pjesëmarrjes së grave me qëllim të avancimit të një agjende të veçantë të sigurisë, duke i anashkaluar me këtë rast shqetësimet e tjera, siç është avancimi i të drejtave të grave. Të sigurohet se përpjekjet për përfshirjen e grave në P/KEDhRÇT nuk i përforcojnë rolet tradicionale gjinore, stereotipet dhe pabarazitë, dhe nuk i vendosin ato në rrezik shtesë.
- 10. Të sigurohet qëndrueshmëria e iniciativave për P/KEDhRÇT.** Të përdoren mekanizmat ekzistues parandalues aty ku është e mundur, dhe të përfshihen mësimet e nxjerra dhe praktikata e mira në krijimin e mekanizmave të rinj. Të krijohet një kornizë për bashkëpunim midis palëve të interesuara duke i përcaktuar rolet dhe kanalet e komunikimit, duke siguruar gjithashtu edhe stimuj dhe mbështetje të përshtatshme për ta siguruar angazhimin e vazhdueshëm. Kur është e mundur, të bëhen përpjekje për t'i angazhuar palët e interesuara që demonstrojnë interes dhe përkushtim të qartë ndaj P/KEDhRÇT-së.







## 6. BIBLIOGRAFIA

Këshilli i Evropës. Karta Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale. Seria e Traktatit Evropian - Nr. 122, Tetor 1985. Qasur në: <https://rm.coe.int/168007a088>

Komiteti Kombëtar për Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundërvënie ndaj Terrorizmit, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Strategjia Kombëtare për Antiterrorizëm për periudhën 2018 - 2022. 2018. Qasur në: [https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/cve\\_national\\_strategy\\_eng\\_translation\\_sbu.pdf](https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/cve_national_strategy_eng_translation_sbu.pdf)

Neumann, Peter. Kundërvënie ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që çon në Terrorizëm: Ide, rekomandime dhe praktika të mira nga rajoni i OSBE-së. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Shtator 2017. Qasur në: <https://www.osce.org/chairmanship/346841?download=true>

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Roli i shoqërisë civile për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Fokusi në Evropën Juglindore, gusht 2018. Qasur në: <https://www.osce.org/secretariat/400241?download=true>

———. Të kuptuarit e mekanizmave referues për parandalimin dhe kundërvënie ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Kapërcimi i sfidave dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut Udhëzues për Evropën Juglindore, prill 2019. Qasur në: <https://www.osce.org/secretariat/418274?download=true>.



# SHTOJCË: RAPORTET NGA TRYEZAT E RRUMBULLAKËTA KOMUNALE

## TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË ÇAIR (26 nëntor 2018)

Çairi konsiderohet si një nga fortesat e radikalizimit fetar dhe nacionalist midis komunave në Maqedonia e Veriut. Edhe para konfliktit të vitit 2001, por veçanërisht pas tij, ndarjet ndëretnike dhe fetare nuk u menaxhuan me sukses, duke krijuar terren pjellor për radikalizimin fetar dhe etnik që çon në dhunë. Kishte një konsensus të qartë midis diskutuesve të pranishëm se duhet të bëhet shumë për ta bërë Çairin një hapësirë të sigurt, rezistuese ndaj radikalizimit. Marrëdhëniet e brishta midis anëtarëve të komunitetit kanë kontribuar për intolerancën fetare midis dy bashkësive më të mëdha fetare në komunë - muslimanëve dhe të krishterëve ortodoksë. Për më tepër, armiqësia midis anëtarëve lokalë të grupeve të tifozëve sportivë, të cilët kanë një histori të urrejtjes etnike dhe fetare, e bën Çairin dhe komunat përreth më pak të sigurta dhe të prira për përplasje ndëretnike dhe ndërfitare. Në fund, ndarja e nxënësve në shkolla është një nga faktorët nxitës që kontribuon drejt radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm.

### Forcimi i shoqërisë civile dhe shkëmbimi i praktikave më të mira

Në lidhje me forcimin e shoqërisë civile dhe shkëmbimin e praktikave më të mira në nivelin e komunitetit, përfaqësuesit e OShC-ve e theksuan nevojën e qartë për krijimin e një baze të dhënash statistikore të luftëtarëve të huaj terroristë (LHT) që janë kthyer në Maqedonia e Veriut. Kjo bazë e të dhënave duhet të vihet në dispozicion të hulumtuesve dhe të profesionistëve për qëllime hulumtuese. Përfaqësuesit e OShC-ve lokale gjithashtu e theksuan nevojën për ta rritur bashkëpunimin me bashkësinë ndërkombëtare për të organizuar diskutime të ndërmjetësuar me grupet e tifozëve sportive në nivel komunal, duke marrë parasysh faktin se krime të shumta me bazë nacionaliste dhe etnikenë territorin e Çairit janë kryer nga anëtarët e këtyre grupeve. Në fund, përfaqësuesit e mediave lokale theksuan se OShC-të duhet të bashkëpunojnë me institucionet lokale dhe komunitetet, si dhe me organizatat ndërkombëtare për ta ngritur vetëdijen për të menduarit kritik, edukimin mediatik dhe promovimin e kulturës demokratike.

## Mediat (me theks në mediat lokale)

Gazetarët lokalë vazhduan ta potencojnë rëndësinë e mediave kombëtare dhe lokale, duke theksuar se mediat kanë përgjegjësi të raportojnë me kujdes, në mënyrë të ekuilibruar dhe jo-senzacionaliste, në mënyrë që të mos provokojnë dhunë dhe radikalizëm që çon në ekstremizëm të dhunshëm.

## Ndërtimi i besimit midis komunitetit lokal dhe institucioneve për zbatimin e ligjit në drejtim të parandalimit - mekanizmat institucionalë

Udhëheqësit e komunitetit lokal, si dhe përfaqësuesit e KKKEDhKT-së, potencuan se ka nevojë të bëhen përpjekje të mëtutjeshme për ndërtimin e besimit midis komuniteteve lokale dhe organeve për zbatimin e ligjit. Në veçanti, u tha se duhen zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme. Shumë palë të interesuara ranë dakord se në kuadër të mekanizmit potencial të referimit, policia duhet të angazhohet vetëm si mundësi e fundit, kryesisht për shkak të natyrës së saj represive. Për më tepër, duhet t'i kushtohet vëmendje e kujdesshme rolit të institucioneve për zbatimin e ligjit në krijimin e mekanizmave lokalë të parandalimit.

## Vetëqeverisja lokale, komunitetet lokale dhe aktorët e tjerë lokalë

Disa diskutues theksuan se të gjithë aktorët lokalë duhet të bëjnë përpjekje për ta parandaluar stigmatizimin e grupeve të caktuara etnike, fetare ose politike se janë të lidhura me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Kjo është me rëndësi shumë të madhe për komunat e përziera në aspekt etnik dhe fetar, siç është Çairi. Përfaqësuesit e OShC-ve përmendën se KLP-ja e formuar në Çair duhet t'i intensifikojë aktivitetet e saj dhe t'i ndjekë nga afër fenomenet e tilla si radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Disa aktivistë të rinj theksuan se Komuna e Çairit duhet të investojë në hapjen e një qendre rinore dhe ta bëjë atë një qendër të angazhimit të të rinjve. Diskutuesit e njëjtë theksuan se Komuna e Çairit duhet të bazohet në përvojën pozitive të Komunës së Tetovës në mënyrë që ta inkurajojë vullnetarizmin e të rinjve dhe të sigurojë hapësirë dhe fonde për të rinjtë që të angazhohen në mënyrë shoqërore për të qenë më kreativë. Si udhëheqësit e shoqërisë civile, ashtu edhe përfaqësuesit e komunës theksuan se forumet rinore të partive politike duhet të angazhohen më tepër si palë të interesuara për P/KEDhRÇT në nivel lokal. Të njëjtat grupe të diskutuesve theksuan më tej se zyrtarët publikë dhe politikë duhet të tregojnë ndjeshmëri të shtuar kur i përdorin simbolet fetare dhe etnike, duke marrë parasysh karakterin multi-etnik të shoqërisë në Maqedonia e Veriut, si dhe karakterin multi-etnik dhe me shumë fe të Çairit.

Në fund, pati konsensus se çdo lloj akti nacionalist duhet të denoncohet dhe të sanksionohet publikisht.

### Udhëheqësit fetarë lokalë

Shumë diskutues me prejardhje të ndryshme profesionale ranë dakord se udhëheqësit fetarë lokalë, të cilët gëzojnë respekt në komunitetet e tyre lokale, duhet të ndikojnë në mënyrë aktive te qytetarët për ta shmangur interpretimin radikal të fesë. Përfaqësuesit nga bashkësitë fetare dhanë disa shembuj se si udhëheqësit fetarë lokalë kanë luajtur rol pozitiv në parandalimin e radikalizimit fetar në vend. Përfaqësuesi i Kishës Ortodokse Maqedonase (KOM) e përmendi një shembull pozitiv kur kjo bashkësi fetare kontaktoi me një grup të mirënjohur të tifozëve sportivë nga Shkupi. Megjithëse takimi ende nuk është mbajtur, vendosja e komunikimit dhe gatishmëria për t'i diskutuar vlerat pozitive morale midis kishës dhe këtij grupi tifozësh, i cili është i njohur për nxitjen e incidenteve të dhunshme në bazë të intolerancës etnike dhe fetare, u mbështet gjerësisht nga diskutuesit e tryezës së rrumbullakët. Diskutuesit u pajtuan se në bazë të shembujve të mëparshëm pozitivë, bashkësitë fetare duhet të bëjnë përpjekje për të bashkëpunuar me grupet e tifozëve sportivë në mënyrë që t'i promovojnë vlerat morale pozitive. Duke diskutuar për dialogun ndër fetar në nivel lokal, si përfaqësuesit e KOM-it ashtu edhe ata të Bashkësisë Fetare Islame (BFI) ranë dakord se megjithëse ekziston dialogu ndërmjet bashkësive fetare, ai duhet të intensifikohet, veçanërisht në nivel lokal përmes veprimeve të përbashkëta. Përfaqësuesit e të dyja bashkësive fetare paraqitën shembuj të ngjarjeve fatkeqe në territorin e Çairit, kur predikuesit lokalë u sulmuan verbalisht nga besimtarët e fesë tjetër, si dhe incidente të izoluara kur vendet e adhurimit u vandalizuan në territorin e Çairit. Në fund, një përfaqësues i BFI-së paraqiti një praktikë të mirë që u implementua në organizatën e tij në formën e një sistemi të kontrollit të brendshëm të cilësisë së punës së imamëve dhe të punonjësve administrativë. U komentua gjerësisht se edhe grupet e tjera fetare duhet ta përvetësojnë këtë praktikë të mirë për ta parandaluar keqinterpretimin e mësimëve fetare.

### Arsimi

Diskutimi mbi arsimin në pjesën më të madhe u përqendrua në sfidat që dalin nga gërshetimi i fesë dhe arsimit. Mësimdhënësit, shërbimi profesional i shkollave, si dhe përfaqësuesit e komunës ranë dakord se ka raste të veçuara të punonjësve të shkollave që nxisin sjellje radikale dhe mendime ekstremiste, dhe se rastet e tilla duhet të sanksionohen menjëherë. Ata ranë dakord se përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe institucionet lokale, duhet të

punojnë për të lobuar për institucionalizimin e trajnimeve dhe të punëtorive për punonjësit e shkollave, si ato që tashmë janë prezantuar nga OSBE-ja dhe QHKP-ja. Përfaqësuesit e bashkësive fetare sugjeruan më tej se duke u bazuar në përvojat pozitive me lëndën Etika e religjionit, institucionet arsimore duhet ta konsiderojnë futjen e kësaj lënde në klasën e 7, 8 dhe 9 të arsimit fillor. Më vonë u diskutua për kushtet e punës dhe sigurinë e mësimdhënësve dhe të punonjësve të shërbimit profesional të shkollave. Të gjithë diskutuesit u pajtuan se kushtet e punës së mësimdhënësve dhe të punonjësve të shërbimit profesional të shkollave duhet të përmirësohen menjëherë, ndërsa siguria e tyre duhet të garantohet vazhdimisht. Disa nga mësimdhënësit diskutuan për efektet negative të ndarjes etnike në shkollat në Çair. Ata sugjeruan se duhet të zbatohen masa të integritimit, duke synuar integritimin multietnik dhe ndërtimin e besimit nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Këto aktivitete duhet të jenë të qëndrueshme dhe jo të varura nga projekte që realizohen për një kohë të kufizuar, me financim ndërkombëtar. Për më tepër, mësimdhënësit dhe punonjësit e shërbimit profesional të shkollave sugjeruan që takimet e shpeshta midis prindërve dhe mësimdhënësve mund ta forcojnë edhe më tej rolin e të dyja palëve të interesuara. Sipas mendimit të tyre, ky shkëmbim i ideve mund t'i parandalojë rastet e radikalizimit që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm. Anëtarët e shërbimit profesional të shkollave, si dhe përfaqësuesit e komunës, komentuan se shërbimet profesionale të shkollave duhet t'i ndjekin nga afër nxënësit asocialë, nxënësit që kanë vështirësi për ta ndjekur materialin mësimor dhe nxënësit që vijnë nga familje jofunksionale. Këto tre grupe të nxënësve mund të jenë më të ndjeshëm ndaj radikalizimit dhe sjelljes së dhunshme. Shumë palë të interesuara ranë dakord se këshillat e prindërve duhet të fuqizohen në mënyrë që të vazhdojnë të luajnë rol kryesor në koordinimin dhe informimin e prindërve për zhvillimin e fëmijëve të tyre. Ky rekomandim ishte në përputhje të qartë me sugjerimin se prindërit dhe mësimdhënësit dhe punonjësit e shërbimit profesional të shkollave duhet të komunikojnë dhe të shkëmbejnë informacione më shpesh. Në fund, mësimdhënësit dhe punonjësit e shërbimit profesional të shkollave theksuan se autoritetet arsimore duhet të fillojnë një proces të reformimit të plan-programeve mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrë që të krijojnë më shumë hapësirë për aktivitete jashtë-mësimore.

### Mirëqenia sociale dhe shëndeti mendor

Tema e fundit që u diskutua gjatë tryezës së rrumbullakët ishte roli i institucioneve të mirëqenies sociale dhe të shëndetit mendor në procesin e parandalimit të radikalizimit që çon në dhunë. Njëri nga diskutuesit, me profesion psikiatër, komentoi se dhuna në familje mund ta inkurajojë sjelljen e dhunshme dhe ekstremiste të të rinjve. Është pranuar gjerësisht se shoqëria

civile duhet të krijojë partneritet me institucionet shtetërore, siç janë qendrat për punë sociale, në mënyrë që të përpigjen dhe t'i parandalojnë rastet e tilla sa më shumë që është e mundur. Tryeza e rrumbullakët u përmyll me diskutime nga përfaqësuesit e shërbimeve profesionale të shkollave, të cilët theksuan se qendrat e punës sociale duhet t'i përdorin plotësisht kompetencat e tyre ligjore dhe të punojnë ngushtë me shkollat fillore dhe të mesme, në mënyrë që ta parandalojnë radikalizimin që çon në ekstremizëm të dhunshëm.

### Përfundime dhe rekomandime

- Ekziston nevojë e qartë për krijimin e një baze të dhënash statistikore të LHT-ve, e cila do të jetë në dispozicion për hulumtuesit dhe profesionistët për qëllime hulumtuese;
- Shoqëria civile të duhet të krijojë partneritet me institucionet lokale dhe komunitetet, si dhe me organizatat ndërkombëtare për ta ngritur vetëdijen për të menduarit kritik, edukimin mediatik dhe promovimin e kulturës demokratike.
- Përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe të bashkësisë ndërkombëtare duhet të angazhohen më shumë në komunikimin dhe bashkëpunimin me grupet e tifozëve sportivë;
- Mediat kanë përgjegjësinë për të raportuar me kujdes, në mënyrë të ekuilibruar dhe jo-senzacionaliste, në mënyrë që të mos provokojnë dhunë, radikalizëm dhe ekstremizëm;
- Duhet të bëhen përpjekje të mëtutjeshme për ndërtimin e besimit midis komuniteteve lokale dhe organeve për zbatimin e ligjit. Nevojiten zgjidhje afatgjata dhe të qëndrueshme;
- Në kuadër të mekanizmit potencial të referimit, policia duhet të angazhohet vetëm si mundësi e fundit, kryesisht për shkak të natyrës së saj represive. Për më tepër, duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje krijimit të mekanizmave lokalë të parandalimit;
- Aktorët lokalë duhet të bëjnë përpjekje për ta parandaluar stigmatizimin e grupeve të caktuara etnike, fetare ose politike se janë të lidhura me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.
- KLP-ja e formuar në Çair duhet t'i intensifikojë aktivitetet e saj dhe t'i ndjekë nga afër fenomenet e tilla si radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm.



- Komuna e Çairit duhet të investojë në hapjen e një qendre rinore dhe ta bëjë atë një qendër të angazhimit të të rinjve.
- Komuna e Çairit duhet të bazohet në përvojën pozitive të Komunës së Tetovës në mënyrë që ta inkurajojë vullnetarizmin e të rinjve dhe të sigurojë hapësirë dhe fonde për të rinjtë që të angazhohen në mënyrë shoqërore dhe të jenë më kreativë.
- Forumet rinore të partive politike duhet të jenë më të angazhuara si palë të interesuara për P/KEDhRÇT në nivel lokal;
- Zyrtarët publikë dhe politikë duhet të tregojnë ndjeshmëri të shtuar kur i përdorin simbolet fetare dhe etnike, duke marrë parasysh karakterin multietnik të shoqërisë në Maqedonia e Veriut;
- Çdo lloj akti nacionalist duhet të denoncohet dhe të sanksionohet publikisht. Komuniteti ndërkombëtar mund të ndihmojë në krijimin e një organi monitorues që do të jetë veçanërisht aktiv gjatë fushatave zgjedhore;
- Udhëheqësit fetarë lokalë të cilët gëzojnë respekt në komunitetet e tyre lokale, duhet të ndikojnë në mënyrë aktive te qytetarët për ta shmangur interpretimin radikal të fesë;
- Në bazë të shembujve të mëparshëm pozitivë, bashkësitë fetare duhet të bëjnë përpjekje për të bashkëpunuar me grupet e tifozëve sportivë në mënyrë që t'i promovojnë vlerat morale pozitive.
- Megjithëse ekziston dialogu ndërmjet bashkësive fetare, ai duhet të intensifikohet, veçanërisht në nivel lokal përmes veprimeve të përbashkëta;
- BFI-ja tashmë ka futur në përdorim një sistem të kontrollit të brendshëm të cilësisë së punës së imamëve dhe të punonjësve administrativë. Kjo praktikë e mirë duhet të përvetësohet edhe nga grupet e tjera fetare në mënyrë që të parandalohet keqinterpretimi i mësimave fetare;
- Rastet e veçuara të punonjësve të shkollave që nxisin sjellje radikale dhe mendime ekstremiste duhet të sanksionohen. Shoqëria civile duhet të punojë për të lobuar për institucionalizimin e trajnimeve dhe të punëtorive për punonjësit e shkollave;
- Në bazë të përvojave pozitive me lëndën Etika e religjionit, institucionet arsimore duhet ta konsiderojnë futjen e kësaj lënde në klasën e 7, 8 dhe 9 të arsimit fillor.

- Kushtet e punës së punonjësve të shkollave duhet të përmirësohen menjëherë;
- Duke pasur parasysh ndarjen etnike të nxënësve në shkollat fillore dhe të mesme, duhet të zbatohen masa të integritimit, duke synuar integrimin multietnik dhe ndërtimin e besimit nën kujdesin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Këto aktivitete duhet të jenë të qëndrueshme dhe jo të varura nga projekte që realizohen për një kohë të kufizuar, me financim ndërkombëtar.
- Takimet më të shpeshta ndërmjet prindërve dhe mësimdhënësve mund ta forcojnë më tej rolin e të dyja palëve të interesuara;
- Shërbimet profesionale të shkollave duhet t'i ndjekin nga afër nxënësit asocialë, nxënësit që kanë vështirësi për ta ndjekur materialin mësimor dhe nxënësit që vijnë nga familje jofunksionale;
- Këshillat e prindërve duhet të forcohen edhe më shumë në mënyrë që të vazhdojnë të luajnë rol kryesor në koordinimin dhe informimin e prindërve për zhvillimin e fëmijëve të tyre.
- Autoritetet arsimore duhet të fillojnë një proces të reformimit të plan-programeve mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm, në mënyrë që të krijojnë më shumë hapësirë për aktivitete jashtë-mësimore.
- Shërbimet profesionale të shkollave (psikologët, pedagogët, sociologët etj.) duhet të jenë vazhdimisht të angazhuar në punë me nxënësit e cenusëm në mënyrë që t'i parandalojnë rastet e mundshme të radikalizimit që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm;
- Dhuna në familje mund ta inkurajojë sjelljen e dhunshme dhe ekstremiste të të rinjve. Shoqëria civile duhet të krijojë partneritet me institucionet shtetërore, siç janë qendrat për punë sociale, në mënyrë që të përpiqen dhe t'i parandalojnë rastet e tilla sa më shumë që është e mundur.
- Qendrat e punës sociale duhet t'i përdorin plotësisht kompetencat e tyre ligjore dhe të punojnë ngushtë me shkollat, në mënyrë që ta parandalojnë radikalizimin që çon në ekstremizëm të dhunshëm.

## TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË GOSTIVAR (21 nëntor 2018)

Fenomeni i radikalizmit nuk është i njohur mirë në Gostivar dhe pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët theksuan se ai duhet të diskutohet më shpesh, veçanërisht pasi radikalizimi është një çështje komplekse që mund të paraqitet në forma të ndryshme. Përfaqësuesit e komunitetit në Gostivar janë të vetëdijshëm se është e rrezikshme që ky fenomen të kategorizohet, të përgjithësohet ose të lidhet vetëm me një grup etnik ose fe. Pjesëmarrësit gjithashtu i identifikuan faktorët e mëposhtëm si të rëndësishëm për shfaqjen dhe përhapjen e këtij fenomeni në komunën e tyre:

- Situata politike dhe polarizimi i vazhdueshëm nuk duhet të anashkalohej, pasi ato potencialisht mund të provokojnë sjellje më radikale;
- Realizimi i regjistrimit të popullsisë pa identifikimin e përkatësisë etnike të qytetarëve shihet si problematik, veçanërisht në mesin e komunitetit rom;
- Mospranimi i problemit si i rëndësishëm, shpërfillja e problemit ose mosnjohja e formave të ndryshme të tij, po ashtu mund të ketë efekt në përhapjen e fenomenit në një mënyrë të pa vërejtur.

### Forcimi i organizatave të shoqërisë civile, bashkëpunimi në nivel shoqëror dhe shkëmbimi i praktikave të mira

Pjesëmarrësit ranë dakord se nevojitet një debat për t'i identifikuar problemet dhe shkaqet e dhunës. Vetëm duke i njohur rrënjët e radikalizimit, aksionet parandaluese mund të planifikohen me sukses dhe të trajtohet fenomeni. Roli i fesë në parandalimin e radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm është shumë i veçantë për përfaqësuesit e bashkësive fetare, ndërsa pjesa tjetër e komunitetit e pranon se ka nevojë që ata të përfshihen në dy nivele: (i) në punën me familjet; dhe (ii) në edukimin e të rinjve dhe ofrimin e interpretimeve alternative për mësimet radikale. Teologët duhet t'u drejtohen së pari familjeve sepse disa nga problemet lindin kryesisht nga marrëdhëniet familjare dhe udhëheqësit fetarë duhet të punojnë me ta. Për sa i përket edukimit, imamët vazhdimisht kanë një rol edukativ dhe sa herë që shfaqet ndonjë problem shoqëror në xhami, ata kalojnë 10-15 minuta duke ligjëruar për etikën dhe moralin para namazit (lutjes). Për këtë qëllim, pjesëmarrësit e diskutuan mundësinë që imamët t'i përdorin ligjëratat e Xhumasë (namazit të ditës së premte) për të predikuar në mënyrë të veçantë rreth radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm si fenomen.

Zgjerimi i arsimit fetar në medrese për femrat u pranua si i rëndësishëm. Roli i nënave është shumë i rëndësishëm, pasi ato mund t'i zbërthejnë interpretimet radikale të fesë dhe/ose të personifikojnë vlera të kundërta me idetë radikale përmes bisedës me fëmijët. Në këtë mënyrë, gratë mund të veprojnë si faktorë të fuqishëm në parandalimin e radikalizimit. Megjithatë, puna e organizatave të grave tregon se komuniteti i Gostivarit ka një kulturë mjaft të dhunshme dhe se dhuna në përgjithësi buron nga familja. Kur bëhet fjalë për dhunën, gratë janë më të interesuara të marrin pjesë aktive në parandalimin e saj sesa burrat. Prandaj, u konkludua se është e nevojshme që bashkësitë fetare të punojnë me burrat për të qenë më aktivë në parandalimin e dhunës në familjet e tyre, si dhe në komunitet.

Për shkak se administrata shtetërore e vetme nuk mund të përballet me ekstremizmin e dhunshëm, nevojitet qasja e përfshirjes së gjithë komunitetit. Kjo operacionalizohet përmes përfshirjes së pjesëve të ndryshme të shoqërisë në forma të ndryshme institucionale siç është Këshilli Rinor, i cili është aktiv në Gostivar, por funksionon me financa të kufizuara. Duke marrë parasysh se buxheti i Këshillit mund të mbulojë zbatimin e 2-3 projekteve në vit, kontributi i tij në ndërtimin rezistencës së të rinjve dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm vlerësohet si i pamjaftueshëm. Nga ana tjetër, përbërja e Këshillit Rinor i ka të gjitha parakushtet për t'u bërë një aktor i rëndësishëm për trajtimin e faktorëve që kontribuojnë në radikalizim, pasi ka përfaqësim të mirë të të gjitha grupeve etnike, e nxit mirëkuptimin multikulturor përmes aktiviteteve të tij, e promovon bashkëpunimin në luftimin e polarizimit etnik dhe i përmirëson marrëdhëniet ndëretnike. Në Gostivar, komuniteti lokal krenohet me faktin se kultivon një kulturë të respektit për diversitetin, që rezulton, në mes tjerash, me aftësinë e shumë anëtarëve të komunitetit për t'i folur gjuhët e komuniteteve të tjera. Dhuna pothuajse nuk ekziston në Gostivar, por pjesëmarrësit e identifikuan përhapjen e dhunës politike. Gjuha e urrejtjes është e përhapur dhe përdoret si mbi baza etnike ashtu edhe fetare, duke e treguar nevojën për ngritjen e vetëdijes dhe ngritjen e kapacitetit për edukimin mediatik.

Organizatrat rinore janë thelbësore me aktivitetet e tyre për ndërtimin e rezistencës, tolerancës dhe zhvillimin e një atmosfere multikulturore midis të rinjve. Organizatat rinore dhe OShC-të që punojnë me të rinjtë në Gostivar zbatojnë aktivitete të tilla si ndërtimi i kapaciteteve, edukimi joformal, edukimi financiar, njohja me menaxhmentin politik, shkathtësitë udhëheqëse dhe të menduarit kreativ. Ato organizojnë seminare, takime dhe ngjarje dhe zhvillojnë shumë aktivitete që mund t'i mbajnë të rinjtë e komunës aktivë dhe të përfshirë, duke siguruar kështu alternativa të zbatueshme për adoptimin e ideve radikale dhe shkuarjen drejt ekstremizmit të dhunshëm.

## Mekanizmat institucionalë për rezistencë dhe forcimin e sigurisë publike

Për shkak të situatës politike në këshill, ndarjeve dhe bashkëjetesës problematike midis shumicës në këshill dhe kryetarit të komunës, komuna nuk arrin të marrë vendime të rëndësishme që janë të rëndësishme për ndërtimin e rezistencës dhe parandalimin e radikalizimit. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët e theksuan mungesën e konsensusit për të punësuar më shumë psikologë, pedagogë, duke deklaruar se kjo e dëmton aftësinë e shkollave për ta identifikuar dhe për ta parandaluar në mënyrë efektive radikalizimin. Përderisa administrata komunale planifikon dhe propozon projekte, këshilli vendos në favor të një numri shumë të vogël të tyre dhe ndan pak mjete financiare për zbatimin e tyre.

Në këtë situatë të vështirë, pjesëmarrësit identifikuan një mekanizëm institucional si të rëndësishëm për nevojat e komunës për krijimin e një mekanizmi për ndërtimin e rezistencës dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Ai është organi koordinues për dhunën në familje që është formuar në baza vullnetare dhe funksionon pa buxhet të vetin. Megjithatë, përgjegjësitë dhe komunikimi midis institucioneve të ndryshme që kanë një rol në mekanizëm janë përcaktuar me protokolle. Një praktikë e mirë për mekanizmin parandalues për ekstremizmin e dhunshëm në nivelin lokal është përfshirja e një numri institucionesh të lidhura me protokoll bashkëpunimi që vendosin për një plan dhe burime të përbashkëta strategjike. Pjesëmarrësit më tej theksuan se nuk ka nevojë për institucionalizim pasi mekanizmat e nivelit lokal mund të funksionojnë si grupe ad-hoc, për sa kohë që ato kanë një mision dhe fushëveprim të qartë, si dhe ekspertizë/njohuri në lidhje me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Këshilli Lokal i Parandalimit (KLP) në Gostivar nuk është funksional. Pjesëmarrësit u ankuan se ky mekanizëm institucional për parandalimin nuk kishte asnjë aktivitet konkret, që tregon se ka mungesë të profesionalizmit dhe të misionit të qartë, si dhe të protokolleve për bashkëpunimin për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, ngritjen e vetëdijes, trajnimin dhe komunikimin. Pjesëmarrësit kishin mendimin se pavarësisht nëse organi ekzistues ka për detyrë parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm ose për këtë do të formohet ndonjë organ i ri, institucionet ekzistuese duhet të përfshihen dhe duhet të rritet niveli i tyre i të kuptuarit të fenomenit, si dhe bashkëpunimi midis tyre.

Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët i përmendën disa praktika të mira që mund të përdoren për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Për shembull, në nivelin lokal në Gostivar ka ekipe ndër-sektoriale që punojnë me fëmijë, gra dhe me viktimat e tjera të dhunës në familje. Përveç që janë



plotësisht funksionale, këto ekipe bashkëpunojnë me shkollat, policinë, qendrat e punës sociale dhe institucionet shëndetësore. Në mënyrë të ngjashme, duhet të hartohet një protokoll për bashkëpunimin ndër-sektorial në parandalimin e radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Përtej komunikimit në nivel lokal midis institucioneve relevante, mekanizmi lokal për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm duhet të lidhet me organin e centralizuar që do të koordinojë, edukojë dhe do të veprojë si burim dhe mbështetje për ekipet lokale. Komiteti Kombëtar për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit mund ta marrë këtë funksion.

Formimi i ekipit për veprim në komunitet është planifikuar në komunën e Gostivarit me mbështetje operationale nga “Search for Common Ground” (Kërkimi i Bazës së Përbashkët) dhe me mbështetje financiare nga Ambasada Britanike. Ky ekip do të ketë 3 përfaqësues nga institucione të ndryshme (komuna, policia, etj.), 3 përfaqësues nga komuniteti (sektori joqeveritar) dhe një përfaqësues nga bashkësitë fetare, si dhe 7 zëvendës-anëtarë. Detyrat e ekipit do të përfshijnë përgatitjen e një plani lokal aksional për zbatimin e strategjisë kombëtare për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe për monitorimin e zbatimit të planit lokal aksional.

Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët ranë dakord për rolin qendror të shkollave midis institucioneve të nivelit lokal. Duke marrë parasysh se përjashtimi dhe marginalizimi janë faktorë kryesorë së bashku me situatën socio-ekonomike që një person i ri të pranojë ide radikale, dhe për shkak se marrëdhënia prind-nxënës është shumë pak e zhvilluar, pjesëmarrësit në diskutimin në tryezën e rrumbullakët arritën në përfundimin se ekziston nevoja për të punuar më intensivisht me mësimdhënësit. Pjesëmarrësit gjithashtu theksuan se marrëdhëniet midis prindërve dhe mësimdhënësve hasin në vështirësi, siç dëshmohet nga mungesa e prindërve në mbledhjet e prindërve. Marrëdhëniet mësimdhënës-nxënës duhet të avancohen në mënyrë që nxënësit të përvetësojnë sjellje të nxënësit dhe të transferojnë aftësi dhe njohuri për qëndrueshmëri.

Të rëndësishëm për një mekanizëm institucional në nivel lokal janë edhe përfaqësuesit e bashkësive fetare. Është e rëndësishme që mësimi fetar të ofrojë kundër-narrative ndaj narrativeve radikale që përhapen dhe shkaktojnë sjellje radikale, pasi që në Gostivar ka grupe dhe forume që janë të favorshme për ekstremizmin e dhunshëm me interpretimin e tyre të fesë. Pjesëmarrësit theksuan se qëllimi i këtyre grupeve është të shkaktojnë mosbesim të BFI-ja. Nga ana tjetër, prania e këtyre grupeve pranohet në mënyrë demokratike nga BFI-ja, edhe pse perceptohet si një rrezik potencial. Duke marrë parasysh përhapjen e librave që e promovojnë ekstremizmin,

përfaqësuesit fetarë gjithashtu duhet të luajnë një rol në rishikimin e librave të botuar, si dhe në parandalimin ose ndalimin e qarkullimit të librave që nxisin ekstremizëm. Për këtë qëllim, BFI-ja duhet ta forcojë sistemin e saj të shqyrtimit të profesional të librave. Një nevojë e ndërlydhur me këtë është institucionalizimi dhe akreditimi i programeve të edukimit fetar, veçanërisht duke pasur parasysh faktin se BFI-ja nuk ka njohuri për mësimet fetare që zhvillohen jashtë institucioneve të veta.

## Rinia dhe arsimit

Mësimdhënësit, pedagogët dhe psikologët kanë nevojë për mjete dhe mbështetje, në mënyrë që të mund të punojnë me nxënësit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në përputhje me strategjinë kombëtare. Ekziston nevoja për të krijuar mundësi për kontakt midis nxënësve të komuniteteve të ndryshme, duke marrë parasysh se sistemi arsimor, i cili bazohet në gjuhën e mësimin, rezulton me ndarje fizike - ndonjëherë madje edhe në ndërtesa të ndryshme shkollore. Në mungesë të aktiviteteve jashtë-mësimore në shkolla, duhet të organizohen aktivitete në të cilat të rinjtë do të takohen, do t'i identifikojnë interesat e përbashkëta dhe do të socializohen përtej barrierave etnike. Për shkak të mungesës së shërbimeve jashtë shkollës për ta mbushur kohën e tyre të lirë, të rinjtë e kalojnë kohën në internet, në kazino, dhe në kafene, ku ata janë të ekspozuar ndaj të gjitha llojeve të përmbajtjeve, gjuhës së urrejtjes dhe vlerave që lehtë mund t'i çojnë ata në adoptimin e sjelljes së dhunshme. Rreziku më i madh është se të rinjtë mund ta humbasin ndjenjën se mund të kontribuojnë për shoqërinë, duke u ndjerë të përjashtuar dhe të marginalizuar. Këta konsiderohen faktorë të rëndësishëm që krijojnë një mjedis të favorshëm për ekstremizmin e dhunshëm në plan afatgjatë.

Pjesëmarrësit konkluduan se Ministria e Arsimit duhet ta forcojë mbështetjen e saj për shkollat profesionale, pasi në to studentët fitojnë aftësi praktike. Arsyetimi i pjesëmarrësve ishte se nxënësit nga shkollat profesionale nuk kanë kohë t'u përkushtohen aktiviteteve devijuese. Për më tepër, pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët ishin të mendimit se të diplomuarit në shkollat profesionale kanë aftësi që mund të zbatohen në ekonomi, që u mundëson atyre të fitojnë për të jetuar. Prandaj, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet ta rishqyrtojë konceptin e arsimit të mesëm të detyrueshëm, duke futur filtra që do të mundësojnë tranzicion në shkollat e mesme profesionale me qëllim që të zvogëlohet trendi i regjistrimit në gjimnaze/shkolla të mesme të përgjithshme.

## Rekomandime

- Të organizohen ngjarje kulturore dhe aktivitete sportive për ta forcuar qëndrueshmërinë, për të mundësuar kontakt dhe bashkëpunim dhe për t'i zvogëluar tendencat e përjashtimit dhe të marginalizimit;
- Të largohet politika nga arsimi, në shkolla të punësohen punonjës profesionalë, të mbahen trajnime dhe të sigurohen mjete për ta parandaluar radikalizimin që çon në ekstremizëm të dhunshëm;
- Të ndërtohet vetëbesimi i të rinjve në mënyrë që ata të mos bëhen të dhunshëm, të pajisen ata me aftësi që do t'i bëjnë ata të jenë rezistues ndaj ideve të dhunshme, t'u ofrohen atyre shërbime që do ta mbushin kohën e tyre të lirë me aktivitete produktive shoqërore dhe do të njihet rëndësia e tyre për shoqërinë;
- Të hartëzohen nevojat e komunitetit në Gostivar dhe të zhvillohet një plan lokal aksional për ta zbatuar Strategjinë Kombëtare për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm që do të përfshijë aktivitete që bazohen në këto nevoja;
- Duke e marrë parasysh rëndësinë e zhvillimit ekonomik lokal, të krijohen vende pune për t'i minimizuar faktorët e radikalizimit dhe për ta përmirësuar mirëqenien sociale;
- Të sigurohet se aktivitetet për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm do të zhvillohen nga afër dhe do të zbatohen në bashkëpunim me Komunën e Gostivarit, e cila është e përkushtuar për ta bashkëfinancuar zbatimin e tyre.

## TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË KUMANOVË (3 dhjetor 2018)

Për dallim nga komunat e tjera në Maqedoninë e Veriut, në Kumanovë dominon bashkëpunimi midis pushtetit lokal dhe organizatave joqeveritare. Pas konfliktit të vitit 2001, marrëdhëniet midis komuniteteve ishin të brishta dhe njerëzit ishin të ndarë, por me punën e përbashkët të organizatave joqeveritare dhe të komunës, ky polarizim është menaxhuar në mënyrë efektive. Madje edhe rasti i Lagjes së Trimave perceptohet gjerësisht më shumë si një konflikt interesi sesa si terrorizëm. Njohuritë për terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm janë të pjesshme dhe kjo pranohet gjerësisht në mesin e grupeve të tifozëve të futbollit, të cilat e inkurajojnë dhunën përmes sloganeve të tyre nacionaliste. Në të njëjtën kohë, autoritetet lokale dhe OShC-të në Kumanovë kanë mungesë të përvojës për t'u marrë me grupet e tifozëve sportivë dhe nuk e dinë se çfarë lloj qasjeje të përdorin.

### Forcimi i shoqërisë civile dhe shkëmbimi i praktikave më të mira

Pjesëmarrësit në diskutim konfirmuan në shkallë të ndryshme se në komunë ka filluar procesi i radikalizimit. Problemi kryesor është se të rinjtë nuk njihen si faktor i rëndësishëm në zhvillimet shoqërore, edhe pse ata përballesh me rrezikun më të madh për t'i pranuar ideologjitë radikale që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm. Në mënyrë të ngjashme, të rinjtë nuk shihen si grup që mund të luajë një rol të rëndësishëm në aktivitetet e radikalizimit, të cilat gjithashtu mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Prandaj, është e nevojshme që të përfshihen aktivitete arsimore jo-formale dhe të lidhen ato me arsimin formal, të mundësohet një ofertë e përhershme e aktiviteteve që do ta plotësojnë kohën e tyre, dhe të mundësohet vetë-realizimi, në mënyrë që t'i bëjë ata të ndjehen si kontribuues të rëndësishëm të komunitetit. Vetëm institucionet arsimore nuk mund ta zbatojnë këtë qasje. Bashkëpunimi midis autoriteteve lokale, shkollave dhe organizatave joqeveritare është thelbësor. Qasja duhet të konsistojë në përmbytje formale arsimore, shërbime (p.sh., sporte, klube rinore, seksione tematike, gara) si dhe aktivitete arsimore joformale që do të kontribuojnë në forcimin e komunitetit duke e ndërtuar rezistencën midis të rinjve që më vonë do të rezultojë me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Faktori i dytë që u diskutua ishte marginalizimi i grupeve të caktuara në baza etnike, socio-ekonomike dhe fetare. Një marginalizim i tillë krijon kushte në të cilat disa individë nuk mund ta gjejnë veten, duke e lehtësuar kështuradikalizimin midis personave që keqkuptohen në mjedisin e tyre dhe që kërkojnë mbështetje. Thënë ndryshe, kushtet në të cilat ideologjitë

ose grupet radikale janë të disponueshme, mund t'i frymëzojnë njerëzit e marginalizuar që të radikalizohen dhe kjo mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Duke marrë parasysh faktin se mentaliteti i njerëzve në komunë është që t'i fshehin ata që janë radikalizuar dhe t'i shmangen të folurit publik për këto probleme (siç është përjashtimi social), të njëjtat probleme po ashtu nxisin edhe tendenca të tjera, siç është emigracioni. Për shembull, rasti i Lagjes së Trimave nuk u diskutua asnjëherë, duke bërë që popullsia jo shqiptare të emigrojë nga kjo pjesë e qytetit. Arsytet ishin të panjohura dhe kjo çoi në ndarje shtesë brenda qytetit. Nevoja për ndërtimin e besimit përmes diskutimeve publike për format e ndryshme të ekstremizmit është e qartë pasi që pjesëmarrësit pajtohen për ekzistencën e pikëpamjeve ekstremiste që fshihen.

Që nga konflikti i vitit 2001, ka pasur një proces të ndërtimit të rezistencës dhe të kohezionit të komunitetit në bashkëpunim me organizatat joqeveritare. Ende mbetet nevoja për lidhje dhe bashkëpunim, si dhe për kapacitete për t'u marrë me radikalizimin duke ndërtuar rezistencë ndaj ideologjive ekstremiste. Fokusi kryesor duhet të vendoset te shkollat, përmes bashkëpunimit me trajnuesit profesionistë dhe OShC-të e specializuara në këto çështje. Meqenëse çështja është aktuale, dhe ka një interes të madh për të, nevojitet koordinim më i madh me donatorët në mënyrë që të parandalohet përputhja e aktiviteteve. Përveç shkollave, është e nevojshme të forcohen kapacitetet e organizatave joqeveritare për edukimin për të drejtat e njeriut.

Për ta ruajtur qëndrueshmërinë, është i nevojshëm ndërtimi i kapaciteteve të prindërve. Burimi kryesor i urrejtjes vjen nga brenda familjes dhe të rriturit janë ata që i drejtojnë dhe i mbjellin idetë radikale tek të rinjtë. Rritja e vetëdijes është e rëndësishme sepse të rinjtë mësojnë për ideologjitë ekstremiste në moshë të re. Prindërit duhet të edukohen dhe të jenë të vetëdijshëm për procesin e radikalizimit në mënyrë që të mund t'i udhëzojnë fëmijët e tyre. Një praktikë e mirë relevante që është zhvilluar në Kumanovë në trajtimin e radikalizimit është vullnetarizmi. Megjithatë, kjo është në rënie, kryesisht për arsye ekonomike. Thelbi i punës vullnetare është bashkimi njerëzor dhe respektimi i njëri-tjetrit duke ofruar mundësi për vetë-realizim, në mënyrë që vullnetarët e rinj të ndjehen se i përkasin një shoqërie që kujdeset për të gjithë. Vendosja e vullnetarëve të rinj në komunitetet lokale si faktorë aktivë në proceset e parandalimit të ekstremizmit radikal nuk përdoret sa duhet. Në veçanti, nxënësit e shkollave të mesme mund të angazhohen më shumë në OShC-të ekzistuese.



## Ndërtimi i besimit midis komunitetit dhe organeve për zbatimin e ligjit, roli i komuniteteve në parandalim - Mekanizmat institucionalë

Pjesëmarrësit në diskutim ishin të mendimit se ekziston një ekstremizëm i fshehur në Kumanovë, dhe se komuna duhet të hartojë strategji në nivel lokal për çdo institucion që do të merret me radikalizimin që mund të çojë në dhunë. Meqenëse shkollat janë mjet kryesor kundër një radikalizimi të tillë, nevojiten strategji të bazuara në shkollë, por gjithashtu janë të nevojshme edhe strategji në nivel të institucioneve të tjera (p.sh. spitale, teatro). Këto strategji duhet t'i parashohin procedurat përkatëse dhe të sugjerojnë se çfarë sjellje duhet pasur në rastet kur radikalizimi tregon shenja të lëvizjes drejt ekstremizmit të dhunshëm. Ato duhet të zhvillohen së bashku me strategjinë e qeverisë dhe të harmonizohen me të për të ofruar udhëzime.

Këto strategji duhet të kenë një qasje gjithëpërfshirëse dhe duhet të jenë të ndërlidhura me politikat e tjera. Për shembull, njëri nga faktorët që shkakton radikalizim është margjinalizimi, dhe njëra nga arsyet e margjinalizimit është papunësia kronike. Politikat dhe strategjitë për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm duhet t'i adresojnë shkaqet e krijuara nga faktorët e radikalizimit dhe duhet të zhvillohen dhe të zbatohen për t'i përbushur nevojat në nivel lokal. Për shembull, plani i punësimit, i cili e mat numrin e të papunëve me arsim të mesëm, duhet të përfshijë metoda të punësimit për personat me arsim fillor ose me arsim të papërfunduar fillor/të mesëm, sepse këta njerëz mund të manipulohen me lehtësi dhe të indoktrinohen në ideologji radikale që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm.

Në trajtimin e këtij fenomeni, shkathtësitë për ta parandaluar gjuhën e urrejtjes janë të rëndësishme, siç janë edhe shkathtësitë për trajtimin e stresit post-traumatik, komunikimit jo të dhunshëm dhe menaxhimit të konflikteve. Ka disa organizata në Kumanovë që punojnë në këto çështje me vite të tëra, të tilla si OShC-ja "Doverba" (Besimi), Qendra për Dialogu Ndërkulturor, KHAM-i dhe Shoqata e Grave të Kumanovës.

U konkludua se mediat, bashkësitë fetare dhe policia mund të luajnë një rol të rëndësishëm në parandalimin e radikalizimit. Mediat nuk kanë njohuri adekuate për këtë fenomen dhe nuk informojnë për ekstremizmin e dhunshëm dhe nuk e parandalojnë atë. Nga ana tjetër, bashkësitë fetare nuk arrijnë ta ngrenë vetëdijen për vlerën e respektit të ndërsjellë. Ato nuk janë aktive në krijimin e kundër-narrativeve të interpretimeve radikale të fesë me përjashtim të Forumit Rinor Islam. Nuk ka bashkëpunim midis bashkësive fetare, përkundër faktit se mobilizimi është i rëndësishëm për parandalimin. Ato nuk e dallojnë rolin e tyre në pengimin e këtij fenomeni

dhe nuk e orientojnë fuqinë e tyre drejt këtij procesi. Futja e aktiviteteve jashtë-mësimore për ta inkurajuar bashkëpunimin ndërtnik dhe fetar në shkollat e mesme duhet të konsiderohet si një mundësi. Roli i policisë reflektohet në punën e tyre me familjet në ndalimin e radikalizimit. Për ta arritur këtë në mënyrë efektive, komuniteti nuk duhet t'i stigmatizojë ata që bashkëpunojnë me policinë. Departamenti i Parandalimit duhet ta forcojë komunikimin me nxënësit në mënyrë që ta përmirësojë besimin midis tyre. Një praktikë e mirë e ndërtimit të besimit është puna e policisë për sigurinë e komunikacionit. Ky model duhet të përdoret edhe për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në nivel lokal, tashmë ekzistojnë tashmë disa modele të bashkëpunimit institucional ndër-sektorial për çështje të ndryshme, siç është Këshilli Lokal i Parandalimit (KLP), një organ lokal për parandalimin e rreziqeve sociale. Programi i dhunës në shkollë i UNICEF-it dhe projekti për shkolla të sigurta i OSBE-së gjithashtu janë identifikuar si të rëndësishëm në trajtimin e dhunës. Është e nevojshme të emërohen përfaqësues profesionistë dhe të motivuar në KLP, në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive në menaxhimin e ekstremizmit të dhunshëm. Është gjithashtu shumë e rëndësishme që sundimi i ligjit dhe drejtësia të zbatohen për të gjithë në mënyrë të barabartë dhe jo selektive. Komuna nuk ka as plan aksional për ta zbatuar Strategjinë kombëtare për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, e as program riintegrimi për njerëzit që morën pjesë në ISIS si luftëtarë të huaj, dhe ka vetëm ndihma financiare që jepen vetëm në herë. Ligji i ri për mbrojtjen sociale duhet të mundësojë punë të integruar me individët, që mund të jetë përgjigje ndaj nevojave. Sipas pjesëmarrësve në diskutim, masat e parandalimit dhe të riintegrimit varen nga bashkësitë lokale, pasi ato mund të jenë në gjendje që më së miri t'u përgjigjen nevojave të njerëzve. Megjithatë, me Ligjin e ri për vetëqeverisjen lokale, këto bashkësi nuk kanë subjektivitet juridik, prandaj edhe nevojiten ndryshime në ligj.

### Arsimi

Sfida më e madhe e identifikuar në sistemin arsimor nga pjesëmarrësit është ndarja gjuhësore e nxënësve që e inkurajon polarizimin në komunë. Ndarja aktuale e nxënësve mund të adresohet përmes ndërtimit të shkollave të reja ku fëmijët do të mësonin së bashku, por tani për tani kjo zgjidhje është e shtrenjtë dhe e pamundur të aplikohet. Në të njëjtën kohë, u theksua se përfaqësimi dhe aktivizmi i organizatave joqeveritare e parandaluan me sukses marginalizimin e mëtejshëm duke i dhënë fundndarjes së fëmijëve romë në shkollat e Kumanovës. Institucionet lokale komunale këshillohen ta promovojnë statusin e fëmijëve romë duke e nxitur mirëkuptimin midis

bashkësive më të mëdha etnike dhe komunitetit rom. Për më tepër, duke pasur parasysh situatën e cenueshme ekonomike të shumicës së familjeve rome, shpenzimet për edukim janë një barrë e madhe për buxhetet e familjeve, kështu që zyrtarët lokalë duhet të gjejnë fonde adekuate, nëse është e mundur.

Zgjidhjet e paraqitura deri më sot për ndarjen e nxënësve nuk janë sistemore, me ç'rast integrimi në përgjithësi nuk është prezantuar si një vlerë qytetare dhe kryesisht është mbështetur nga projektet e financuara nga organizatat ndërkombëtare për menaxhimin e situatave të konflikteve. Përkundrazi, zgjidhjet sistemore për zbatimin e mësimin të përbashkët do të çojnë në njohjen dhe shkëmbimin me „tjetrin“. Duke u bazuar në praktikën e mira në nivel kombëtar nga OSBE-ja, zyrtarët lokalë duhet t'i mbështesin OSHC-të nga rajoni në zbatimin e projekteve për ndërtimin e besimit. Për më tepër, futja e temave dhe metodave pedagogjike në procesin mësimor do ta zhvillojë më tej mendimin kritik, tolerancën dhe bashkëpunimin.

Pjesëmarrësit në diskutim arritën në përfundimin se formati i zhvilluar nga OSBE-ja përmes Projektit për shkolla të sigurta për bashkëpunimin në nivel shkollor dhe ndërmjet shkollave dhe komunës është i rëndësishëm për krijimin e një modeli për zbulimin dhe parandalimin e radikalizimit përmes përfshirjes së disa subjekteve. Në këtë rast, përvoja e klubit për ndërmjetësim duhet të përdoret dhe të shkëmbehet me shkollat e tjera. Theks i veçantë duhet të vihet në ndërtimin e kapaciteteve dhe vetëdijes për fenomenin e radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm në mesin e mësimitdhënësve, në mënyrë që ata t'i formësojnë deklaratat, sjelljet dhe mesazhet që i dërgojnë. Shërbimet pedagogjike dhe psikologjike duhet të forcohen për monitorimin e mësimitdhënësve për të kontrolluar nëse ata tregojnë shenja të radikalizimit dhe se a mund ata të reagojnë ndaj sjelljes radikale me mbështetjen e duhur. Ndërtimi i kapaciteteve të tilla nuk u perceptua si një detyrë e vështirë, veçanërisht pasi mësimitdhënësit tashmë kanë kaluar trajnime në lidhje me këtë fenomen dhe mund t'i përdorin aftësitë e reja të fituara rishtas në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Mësimitdhënësit duhet të zhvillojnë masa, metoda dhe aktivitete për përfshirje në programet e tyre vjetore të punës, ndërsa komunat duhet ta monitorojnë zbatimin e masave përkatëse.

Është e rëndësishme të përdoren përmbajtje jashtë-mësimore në arsim për ta parandaluar radikalizimin. Në përshkrimin e detyrave të punës së mësimitdhënësve theksohet se ata duhet të zhvillojnë aktivitete pas shkollës, klube, seksione tematike, gara dhe aktivitete të tjera përveç mësimin standard në klasë. Megjithatë, është e nevojshme të stimulohen mësimitdhënësit për t'i zbatuar këto, me ç'rast pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët propozuan që këto aktivitete të përfshihen në vlerësimin e punës së mësimitdhënësve. Për më tepër, komunat kanë rol për t'u ndihmuar shkollave të organizojnë

aktivitete të lira duke i lidhur ato me organizatat joqeveritare. Bashkëpunimi tashmë i shkëlqyeshëm midis shërbimit profesional dhe organizatave joqeveritare është një bazë shumë e mirë për këtë. Një bashkëpunim i tillë duhet të orientohet drejt aktiviteteve përmes të cilave do të kultivohen vlera të tilla si simpatia, bashkëpunimi, respekti i ndërsjellë dhe empatia.

Shkollat kanë nevojë për udhëzime se si të sillen në raste të radikalizimit dhe duhet të lidhen me një sistem më të gjerë për parandalim. Puna me prindërit është thelbësore, por ekziston një trend që prindërit të mos vijnë në mbledhjet e prindërve, që rezulton me bashkëpunim më të vogël.

### Mbrojtja sociale dhe shëndeti mendor

Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Qendrës për Punë Sociale është shumë i kufizuar, që tregon se ka nevojë për bashkëpunim dhe trajnim që do t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve. Është e nevojshme të caktohet një pikë kontakti në shkolla për t'u koordinuar me shërbimet sociale duke ruajtur me këtë rast konfidencialitetin. Pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët gjithashtu theksuan se Këshilli komunal së bashku me përfaqësuesit e këshillave të prindërve dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme kanë një praktikë që mund të përdoret për parandalimin e delikuencës së të miturve gjatë verifikimit në vendngjarje.

### Rekomandime

- Mund t'i përmirësojmë trendet përmes arsimit cilësor. Kemi mësimdhënës të arsimuar me përvojë të madhe, por ka shumë punë për t'u bërë në trajnimin e pjesës tjetër të popullatës. Kjo zakonisht bëhet përmes ose në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe ndërkombëtare.
- Është e nevojshme të bëhen ndryshime në procesin arsimor për programet vjetore të punës përmes shkollave dhe këshillave komunalë dhe në plan-programet mësimore përmes Byrosë për Zhvillimin e Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- Duhet të ligjërohen mësimet fetare në mënyrë që ta njohim dhe ta respektojmë njëri-tjetrin dhe të zvogëlohet hapësira për devijim dhe interpretim radikal.
- Ekziston nevojë e qartë për t'u përqendruar në zhvillimin e kohezionit social dhe multikulturalizmit.

- Dokumentet strategjike kombëtare duhet të konsultohen në nivelin lokal, si pjesë e qasjes nga poshtë-lart për zbatim.
- Ekziston nevoja për mbledhjen sistematike të të dhënave për atë se cilat lloje të grupeve ekstremiste janë të pranishme dhe çfarë rrjetesh kanë, si bazë për t'iu kundërvënë atyre.
- Këshilli komunal duhet ta inkurajojë sektorin arsimor që në programet vjetore të shkollave të përfshijë aktivitete për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm. Të menduarit kritik dhe vendimmarrja duhet të forcohen si aftësi e fituar përmes procesit arsimor.
- Është thelbësore të bëhet një përzgjedhje e mirë e personave që do të përfshihen në mekanizmin për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, në mënyrë që të shmangët përsëritja e gabimeve të bëra gjatë përzgjedhjes së anëtarëve të komisioneve për marrëdhënie ndërmjet bashkësive. EDhRÇT-ja është shumë më tepër se një çështje politike dhe cilësia e jetës së njerëzve të përfshirë duhet të vendoset mbi gjithçka tjetër.
- Ekziston nevoja për ta përmirësuar bashkëpunimin midis autoriteteve që kanë rol dhe kompetencë në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe midis qytetarëve dhe OShC-ve.



## TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË STRUGË (5 dhjetor 2018)

Struga është njëra nga komunat në Maqedoninë e Veriut që konsiderohet si djep i kohezionit fetar dhe ndëretnik. Megjithatë, aktet sporadike të radikalizimit dhe të dhunës fetare dhe nacionaliste janë të pranishme në territorin e komunës. Këto fenomene ishin më të dukshme gjatë kohës së konfliktit të armatosur në vitin 2001 dhe menjëherë pas tij, por gjithashtu edhe pak para dhe pas ndarjes së re territoriale të komunave në vitin 2004. Shtytësi kryesor i këtyre tensioneve sporadike është krimi i organizuar, i manifestuar kryesisht përmes vrasjeve të pazgjdhura të qytetarëve të njohur me histori serioze kriminale, trafik droge, trafikim njerëzor, kontrabandë, zhvatje dhe koncesione të tokës. Të gjitha këto çështje e kanë lëkundur seriozisht besimin e qytetarëve në institucionet qendrore dhe vendore, veçanërisht besimin në organet e zbatimit të ligjit dhe institucionet gjyqësore. Kishte një konsensus të qartë midis diskutuesve të pranishëm se duhet të bëhet shumë për ta bërë Strugën një hapësirë të sigurt, rezistuese ndaj radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Mungesa e infrastrukturës u theksua gjithashtu si një nga problemet kryesore që duhen adresuar me qëllim që Struga të bëhet një qytet i fortë. Në përgjithësi, diskutimi gjatë tryezës së rrumbullakët nuk ishte shumë i gjallë, dhe ekzistonte një ndjenjë frike midis pjesëmarrësve për të folur hapur për disa nga çështjet, kryesisht për shkak të pranisë së zyrtarëve të lartë nga vetëqeverisja lokale.

### Mediat (me theks në mediat lokale)

Përfaqësuesit e shoqërisë civile, të cilët dëshironin ta theksojnë rolin e mediave lokale dhe kombëtare, e hapën diskutimin. Është pranuar gjerësisht se duke i marrë parasysh specifikat e komunës së Strugës dhe ngjarjet e kaluara (kryesisht duke iu referuar incidenteve ndëretnike pas konfliktit të vitit 2001 dhe ndarjes territoriale të komunave në vitin 2004), mediat kanë përgjegjësi të raportojnë me kujdes, në mënyrë të ekuilibruar dhe jo-senzacionaliste, për të mos nxitur shfaqje të sjelljes së dhunshme, radikalizimit ose pikëpamjeve ekstremiste.

### Ndërtimi i besimit midis komunitetit lokal dhe institucioneve për zbatimin e ligjit në drejtim të parandalimit - mekanizmat institucionalë

Diskutimi më vonë kaloi në çështjet që kanë të bëjnë me ndërtimin e besimit midis komuniteteve lokale dhe organeve të zbatimit të ligjit, veçanërisht në drejtim të zhvillimit të mekanizmave parandalues institucionalë. Për ta

shpërndarë përbajtjen e Strategjisë Kombëtare për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe për ta lehtësuar zbatimin e saj, duhet të zhvillohet një komunikim i vazhdueshëm dhe konstruktiv midis Komisionit në nivel qendror dhe pushtetit lokal. Kjo u theksua nga përfaqësuesit e institucionit të burgut në Strugë, si dhe nga përfaqësuesit e KKKEDhKT-së. Të njëjtët bashkëbisedues gjithashtu ranë dakord se sundimi i ligjit është shtylla kryesore për zbatimin e çdo strategjie kombëtare në nivel lokal. Prandaj, kjo tregoi se është e domosdoshme një qasje sistematike në forcimin e institucioneve, respektimin e ligjeve dhe parandalimin e selektivitetit në proces. Vetëm „qasja që e përfshin gjithë shoqërinë“ mund të rezultojë me sukses afatgjatë. Përfaqësuesit e shoqërisë civile, si dhe përfaqësuesit e shërbimeve të mirëqenies sociale, theksuan se nevojiten aktivitete shtesë policore për t'i shtypur aktivitetet kriminale, të cilat shërbejnë si shembull i keq për të rinjtë. Aktivitetet kriminale në nivelin lokal kontribuojnë në procesin e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Këto palë të interesuara insistuan në potencimin e një sërë vrasjesh të pazgjydhura në nivel lokal. Krimet për të cilat bëhet fjalë janë të lidhura ngushtë me krimin e organizuar: trafikun e drogës, prostitucionin, trafikimin e qenieve njerëzore dhe koncesionet e tokës lokale. Këto fenomene kanë rezultuar me besim të lëkundur të qytetarëve në institucionet lokale dhe ato qendrore. Kjo ka të bëjë kryesisht me policinë, e cila gëzon një besim të ulët rekord midis qytetarëve lokalë në Strugë. U potencua disa herë se rikthimi i besimit të qytetarëve në institucionet lokale dhe qendrore është shtylla kryesore mbi të cilën duhet të ndërtohet parandalimi i radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Në mënyrë të ngjashme, disa diskutues e përmbyllën diskutimin me përfundimin se transparenca dhe llogaridhënia e vetëqeverisjes lokale duhet të përmirësohet në mënyrë që ajo ta rifitojë besimin e qytetarëve të saj.

### Vetëqeverisja lokale, komunitetet lokale dhe aktorët e tjerë lokalë

Diskutiminë tryezën rumbullakët vazhdoi me tema që lidhen me kompetencat e vetëqeverisjes lokale, kontekstin në të cilin veprojnë komunitetet lokale, si dhe rolin e palëve të tjera të interesuara lokale. Përfaqësuesit e shoqërisë civile lokale ranë dakord se duhen bërë përpjekje shtesë për ta parandaluar etiketimin dhe stigmatizimin e individëve/grupeve fetare/politike dhe paraqitjen e tyre si arsye kryesore për ekzistencën e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Është e nevojshme një qasje më kohezive shoqërore. Punëtorët socialë, mësimdhënësit dhe punonjësit e shërbimit profesional të shkollave dhe udhëheqësit fetarë lokalë e theksuan rëndësinë e familjes në procesin e krijimit të vlerave morale dhe etike tek të rinjtë. Ata bënë thirrje për një angazhim më të madh të të gjithë aktorëve lokalë për t'i ruajtur dhe për t'i zhvilluar vlerat e familjes. Përfaqësuesit e vetëqeverisjes

lokale theksuan se është e nevojshme të hetohen dhe të potencohen mangësitë e procesit të decentralizimit, i cili mund të jetë pengesë për një zbatim efektiv të përpjekjeve për ta parandaluar radikalizimin që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Nga ana tjetër, u theksua se ekstremizmi i krahut të djathtë, i nxitur nga „bllloqet e zeza“ të tifozëve sportivë, nuk është i pranishëm në Strugë, dhe se autoritetet lokale duhet të vazhdojnë të bëjnë përpjekje për ta ruajtur këtë stabilitet. Mësimdhënësit dhe punonjësit e shërbimit profesional të shkollave dhe përfaqësuesit e shërbimeve të mirëqenies sociale theksuan gjithashtu se aktivitetet sportive kanë një rëndësi thelbësore në aspiratën për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm. Investimet komunale në infrastrukturën sportive janë mjeti më i mirë për të krijuar terren pjellor për më shumë aktivitete sportive në të cilat do të angazhohet rinia lokale. Prandaj, është e nevojshme të ndahen më shumë fonde për një sallë sportive, një pishinë dhe hapësira të tjera të ngjashme sportive.

### Udhëheqësit fetarë lokalë

Tema tjetër që u diskutua ishte roli i rëndësishëm i udhëheqësve fetarë lokalë. U arrit një konsensus i menjëhershëm se bashkësitë fetare në komunë duhet të përfshihen në mënyrë aktive në procesin e parandalimit duke i promovuar vlerat pozitive në përputhje me mësimet e përcaktuara fetare. Përfaqësuesit e dy bashkësive më të mëdha fetare bashkërisht nënvizuan se është me shumë rëndësi dhe domosdoshmëri që të rikthehet shembulli pozitiv nga e kaluara, kur Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM) dhe Bashkësia Fetare Islame (BFI) kanë qenë të përfshira në mënyrë aktive në rolet e ndërmjetësve midis popullatës lokale duke i promovuar vlerat në frymën e kohezionit. Ata e komentuan shembullin e disa viteve më parë, kur një konflikt i mundshëm fetar në fshatin Oktisi u parandalua përmes një ndërhyrjeje të përbashkët nga udhëheqësit fetarë lokalë. Për më tepër, disa palë të interesuara i përqaftuan dhe i mbështetën përpjekjet e BFI-së, e cila vazhdimisht komunikon me anëtarësinë e saj, për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin. Gjithashtu, pozitivisht u vlerësua edhe konsistenca me të cilën BFI-ja distancohet nga individët dhe grupet që predikojnë jashtë institucioneve dhe xhamive, duke theksuar se BFI-ja nuk mund të ketë njohuri nëse individët ose grupet e tilla promovojnë ekstremizëm të dhunshëm. Në të njëjtën kohë, u ngritën shqetësime për mungesën e aktivitetit dhe të hetimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme pas denoncimeve të parashtruara nga BFI-ja për sjellje radikale. Të dy udhëheqësit fetarë dhe bashkëbiseduesit e tjerë të përfshirë në diskutim komentuan se nevojitet një bashkëpunim më i mirë midis policisë dhe bashkësive fetare.

## Arsimi

Në fund, diskutimi u zhvendos nga roli i bashkësive fetare në rolin e arsimit në parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, duke diskutuar për efektet e studimit të koncepteve fetare në plan-programet shkollore. Udhëheqësit fetarë lokalë theksuan qartazi se lëndët e Historisë së feve dhe Etikës së religjionit kanë rëndësi të jashtëzakonshme për udhëzimin e hershëm të nxënësve dhe ndërtimin e klimës së bashkëjetesës, si dhe të mirëkuptimit midis brezave të rinj. Kjo është arsyeja pse këto lëndë duhet të ligjërohen nga teologë, të cilët e kanë përvojën dhe njohuritë e nevojshme për t'i përcjellë në mënyrë të saktë mësimet morale të feve. Mësimdhënësit dhe punonjësit e shërbimit profesional të shkollave komentuan se institucionet e arsimit fillor nuk janë të angazhuara sa duhet në promovimin e mjediseve inkluzive dhe multikulturore për nxënësit e tyre. Ata ngritën shqetësimin se kjo krijon një efekt që rezulton me një atmosferë të tensionuar në shkollat e mesme më vonë gjatë edukimit të të rinjve. Pjesëmarrësit ranë dakord në mënyrë konsensuale se roli i arsimit është thelbësor në procesin e parandalimit të radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Një parakusht i rëndësishëm është sigurimi i ngritjes së vazhdueshme të nivelit të njohurive, si midis studentëve ashtu edhe midis mësimdhënësve. Reformat e plan-programeve mësimore, si dhe riorganizimi i aktiviteteve jashtë-mësimore, u përmendën nga përfaqësuesit e shoqërisë civile si disa nga mënyrat për t'i arritur këto qëllime. Në fund, u nënvizua shembulli pozitiv i Islandës me patrullimet e kombinuara të përbëra nga prindërit dhe policët për monitorimin e sjelljes së adoleshentëve. Për më tepër, u theksua se rivendosja e paralajmëruar e „policëvetë lagjes“ do të luajë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e komunitetit lokal paqësor dhe koheziv.

## Përfundime dhe rekomandime

- Duke i marrë parasysh specifikat e komunës së Strugës dhe ngjarjet e kaluara, mediat kanë përgjegjësi të raportojnë me kujdes dhe në mënyrë të ekuilibruar dhe jo-senzacionaliste, për të mos nxitur shfaqje të sjelljes së dhunshme, radikalizimit ose pikëpamjeve ekstremiste.
- Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm duhet të zhvillohet përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe konstruktiv midis Komisionit në nivel qendror dhe pushtetit lokal;
- Sundimi i ligjit është shtylla kryesore për zbatimin e çdo strategjie kombëtare në nivel lokal. Kjo tregon se është e domosdoshme një qasje sistematike në forcimin e institucioneve dhe promovimin e zbatimit konsekuent të legjisllacionit;

- Nevojiten aktivitete shtesë policore për t'i shtypur aktivitetet kriminale, të cilat shërbejnë si shembull i keq për të rinjtë. Aktivitetet kriminale në nivelin lokal kontribuojnë në procesin e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm;
- Besimi i qytetarëve në institucione është lëkundur. Kjo ka të bëjë kryesisht me policinë, e cila gëzon një besim të ulët rekord midis qytetarëve lokalë në Strugë. Transparenca dhe llogaridhënia e vetëqeverisjes lokale duhet të përmirësohet në mënyrë që ajo ta rifitojë besimin e qytetarëve të saj.
- Duhet bërë përpjekje shtesë për ta parandaluar etiketimin dhe stigmatizimin e individëve/grupeve fetare/politike dhe paraqitjen e tyre si arsye kryesore për ekzistencën e radikalizimit që çon në ekstremizëm të dhunshëm;
- Duke marrë parasysh rëndësinë e familjes në procesin e krijimit të vlerave morale dhe etike tek të rinjtë, nevojitet një angazhim më i madh i të gjithë aktorëve lokalë;
- Është e nevojshme të hetohen dhe të potencohen mangësitë e procesit të decentralizimit, i cili mund të jetë pengesë për zbatimin efektiv të përpjekjeve për ta parandaluar radikalizimin që çon në ekstremizëm të dhunshëm.
- Fenomeni devijues i ekstremizmit të krahut të djathtë, i nxitur nga „bllloqet e zeza“ të tifozëve sportivë, nuk është i pranishëm në Strugë;
- Aktivitetet sportive kanë një rëndësi thelbësore në aspiratën për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm. Investimet komunale në infrastrukturën sportive janë mjeti më i mirë për të krijuar terren pjellor për më shumë aktivitete sportive në të cilat do të angazhohet rinia lokale. Prandaj, është e nevojshme të ndahen më shumë fonde për një sallë sportive, një pishinë dhe hapësira të tjera të ngjashme sportive;
- Bashkësitë fetare në komunë duhet të përfshihen në mënyrë aktive në procesin e parandalimit duke i promovuar vlerat pozitive në përputhje me mësimet e përcaktuara fetare;
- Është me shumë rëndësi dhe domosdoshmëri që të rikthehet shembulli pozitiv nga e kaluara, kur Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM) dhe BFI-ja kanë qenë të përfshira në mënyrë aktive në rolet e ndërmjetësve midis popullatës lokale duke i promovuar vlerat në frymën e kohezionit;



- Palët e interesuara i përqaftuan dhe i mbështetën përpjekjet e Bashkësisë Fetare Islame (BFI), e cila vazhdimisht komunikon me anëtarësinë e saj, për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin. Në të njëjtën kohë, u ngritën shqetësime për mungesën e aktivitetit dhe hetimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme pas denoncimeve të parashtruara nga BFI-ja për sjellje radikale;
- Lëndët e Historisë së feve dhe Etikës së religjionit kanë rëndësi të jashtëzakonshme për udhëzimin e hershëm të nxënësve dhe ndërtimin e klimës së bashkëjetesës, si dhe të mirëkuptimit midis brezave të rinj. Kjo është arsyeja pse këto lëndë duhet të ligjërohen nga teologë, të cilët e kanë përvojën dhe njohuritë e nevojshme për t'i përcjellë në mënyrë të saktë mësimet morale të feve;
- Institucionet e arsimit fillor nuk janë të angazhuara sa duhet në promovimin e mjediseve inkluzive dhe multikulturore për nxënësit e tyre. Për më tepër, kjo krijon një efekt që rezulton në atmosferë të tensionuar në shkollat e mesme;
- Roli i arsimit është thelbësor në procesin e parandalimit të radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Një parakusht i rëndësishëm është sigurimi i ngritjes së vazhdueshme të nivelit të njohurive, si midis studentëve ashtu edhe midis mësimitdhënësve;
- U nënvizua shembulli pozitiv i Islandës me patrullimet e kombinuara të përbëra nga prindërit dhe policët. Për më tepër, u theksua se rivendosja e paralajmëruar e „policëve të lagjes“ do të luajë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e komunitetit lokal paqësor dhe koheziv.

## TRYEZA E RRUMBULLAKËT KOMUNALE NË TETOVË (19 nëntor 2018)

Sipas pjesëmarrësve të punëtorisë, mungesa e suksesit në menaxhimin e konflikteve ndëretnike në Tetovë e ka shtuar rrezikun e ekstremizmit të dhunshëm, që do të thotë se miratimi i masave për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Tetovë është i vonshëm. Përveç kësaj, marrëdhëniet midis komuniteteve vlerësohen si të brishta. Faktorët kryesorë që u identifikuan në diskutim se ndikojnë për një mjedis në të cilin pranohen idetë radikale dhe që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm janë:

- Intoleranca fetare ndaj njerëzve që i përkasin një feje tjetër. Diskutimi nxori në pah nevojën që njerëzit në Tetovë ta duan dhe ta vlerësojnë fenë e tyre, por gjithashtu edhe të mësojnë se si t'i respektojnë liritë fetare dhe zgjedhjet fetare të të tjerëve.
- Ndarja e nxënësve në shkolla. Kjo situatë kontribuon për ndarjet midis komuniteteve, ndërsa mungesa e kontaktit na privon nga mundësia për t'u takuar dhe për ta njohur tjetrin. Mungon praktika e dialogut ndërmjet komuniteteve, përveç kur inkurajohet nga projekte të financuara nga vendet e huaja.
- Ndarjet brenda komunitetit. Shembull i këtij trendi të përsëritur që u diskutua në punëtori ishin ndarjet në burgje midis grupeve që e praktikojnë islamit ose në mënyrë të ngjashme midis grupeve të tifozëve të ekipeve lokale të futbollit.

### Mekanizmat institucionalë për bashkëpunimin e komuniteteve:

Këshilli Lokal i Parandalimit (KLP) në Tetovë u vlerësua si jo-funksional, kryesisht për faktin se institucionet e përfshira kanë frikë të angazhohen pasi veprimtaria e tyre do të përputhej me KLP-në, kurse krijimi i protokolleve për komunikim do të ishte i dobishëm për ta rritur funksionalitetin, ndërsa efektiviteti do të varet nga vazhdimësia dhe ndërrimi i anëtarëve të keshillit me ndryshimin e qeverisë. Për këtë qëllim, është e rëndësishme që komuna ta marrë përsipër koordinimin e KLP-së me qëllim të kundërvënies dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm ose KLP-ja të zëvendësohet me një këshill lokal për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, i cili do të paraqiste një organ të decentralizuar të keshillit kombëtar.

Pjesëmarrësit e punëtorisë diskutuan gjithashtu edhe për mekanizmat e tjerë të mundshëm që mund të jenë të dobishëm për parandalimin dhe kundërvënien

ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Për shembull, Këshilli rinor që ende nuk ka filluar të funksionojë dhe Këshilli lokal për parandalimin e delikucencës së të miturve që është duke u formuar. Me qëllim të parandalimit dhe ndërtimit të rezistencës të rinjtë në arsimin parashkollor dhe fillor, pjesëmarrësit propozuan të formohen të paktën dy ekipe të përbëra nga psikologë, sociologë dhe pedagogë, të cilat do të realizonin një program trajnimi duke përdorur lojëra, role, dhe do t'i zhvillonin aftësitë për dialog dhe bashkëpunim.

Praktika e komunës për të financuar aktivitete multikulturore rinore duhet të vazhdohet dhe duhet të sigurohet mbështetje më e madhe. Për këtë qëllim, organizatat e shoqërisë civile që punojnë me të rinjtë duhet të kontaktojnë me komunën dhe të iniciojnë aktivitete që do ta zhvillojnë bashkëpunimin dhe dialogun ndërmjet komuniteteve. Komuna duhet ta konsiderojë financimin e aktiviteteve jashtë-mësimore të shkollave që e lehtësojnë bashkëveprimin midis komuniteteve (siç janë debatet, garat, aktivitetet sportive), si dhe të aktiviteteve që e stimulojnë përvetësimin e aftësive të tilla si të menduarit kritik dhe zgjidhja e konflikteve, si dhe kulturën e dialogut.

### Shoqëria civile dhe shkëmbimi i praktikave më të mira

Përfundimi më i rëndësishëm nga diskutimi ishte se institucionet nuk duhet t'i transferojnë përgjegjësitë për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm ndërmjet vete. Qasja e përfshirjes së gjithë shoqërisë duhet të zbatohet në rastet kur përgjegjësitë duhet të ndahen midis të gjitha palëve të interesuara në komunitet.

Shoqëria civile dhe mediat kanë një rol kryesor në menaxhimin e gjuhës së urrejtjes, konflikteve dhe armiqësisë, si dhe në parandalimin e pranimit të ideve radikale që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm. Për këtë qëllim, duhet të merret në konsideratë puna me mediat dhe/ose financimi i aktiviteteve që do të rezultojnë në prodhimin e materialeve dhe përmbajtjeve që do t'i informojnë qytetarët për radikalizimin. Trajnimi është gjithashtu i nevojshëm në mënyrë që mediat të mos bëhen faktor për nxitjen e ekstremizmit të dhunshëm.

Organizatave të shoqërisë civile varen nga financat e organizatave ndërkombëtare, pasi komuna nuk siguron fonde të mjaftueshme për aktivitetet e tyre. Më e rëndësishmja, pasi që momentalisht nuk ka fonde që janë në dispozicion për punën e P/KEDhRÇT-së, Qeveria në nivelin qendror, si dhe përmes njërive të vetëqeverisjes lokale, duhet të sigurojë fonde për parandalimin nga radikalizimi. Duhet t'i jepet përparësi punës me klubet e futbollit dhe grupet e tyre të tifozëve. Për këtë qëllim, duhet të përdoret

autoriteti i menaxherëve të klubeve për ta parandaluar përdorimin e gjuhës së urrejtjes ndaj grupeve të tjera etnike, duke marrë parasysh faktin se ekipet janë etnikisht të përziera, tifoza në baza etnike mund të ndikojë në performancën e anëtarëve të ekipit. Këto përpjekje mund të çojnë në parandalimin e polarizimit dhe ndarjes së komuniteteve.

Me qëllim të parandalimit nga radikalizimi, pjesëmarrësit e punëtorisë theksuan se është thelbësore për komunën që t'i aktivizojë bashkësitë lokale. Përmes tyre, komuniteti mund të angazhohet në parandalimin e hershëm nga radikalizimi. Megjithatë, bashkësitë lokale duhet të mbështeten nga qasjet dhe metodologjia e rekomanduar për ta mobilizuar komunitetin. Në partneritet me shoqërinë civile, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, bashkësitë lokale duhet të angazhohen në mënyrë aktive në ngritjen e vetëdijes për të menduarit kritik, edukimin mediatik dhe promovimin e përgjithshëm të kulturës demokratike.

### Rritja e besimit midis komuniteteve lokale dhe policisë

Përfaqësuesit e institucioneve të ndryshme që marrin pjesë në punëtori deklaruan se punojnë ngushtë dhe bashkëpunojnë me policinë. Megjithatë, ata konkluduan se policia nuk është shumë efektive në punën e saj. Në fakt, për shkak se policia mund t'i ndalojë, por jo edhe t'i burgosë ose t'i largojë nga rruga kriminelët, besimi i qytetarëve në punën e policisë është i ulët. Efektiviteti i policisë mund të rritet nëse zbatohen disa ndryshime ose nëse bëhet riorganizimi i procedurave, siç është futja në përdorim e regjistrimit anonim dhe forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm. Besimi në punën e policisë do të përmirësohet nëse policia zhvillon më shumë aktivitete edukative dhe parandaluese (duke përfshirë edhe për P/KEDh), siç është rasti me sigurinë në komunikacion.

Pjesëmarrësit e punëtorisë theksuan se policia nuk ka kapacitet ose procedura se si ta zbatojë edukimin publik/ngritjen e vetëdijes për radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Mementalisht mungon një platformë në nivel të komunitetit, të cilës mund t'i bashkëngjitet policia. Më e rëndësishmja, policia duhet të bëhet më aktive në nivel të komunitetit, të njihet me nevojat e qytetarëve dhe t'u përgjigjet atyre, duke i bërë komunitetet lokale më të sigurta. Në të njëjtën kohë, u vlerësua se policia nuk është e përgatitur me programe për riintegrimin dhe risocializimin e ekstremistëve të dhunshëm ose luftëtarë të huaj që janë kthyer. Kjo mund të shkaktojë rreziqe shtesë për kuptimin e fenomenit të radikalizimit nëse komuniteti nuk është i përgatitur siç duhet. Prandaj, rekomandohet që policia të jetë më e pranishme në komunitet. Pjesëmarrësit shohin se policimi në komunitet kontribuon në

ndërtimin e besimit, por vetëm nëse është efektiv për t'i bërë lagjet më të sigurta.

### Bashkëpunimi me bashkësitë fetare, prindërit dhe organizatat e grave

Bashkësitë fetare duhet të përfshihen në aktivitetet e bazuara në komunitet, si dhe në burgje dhe shkolla, sepse ato janë të rëndësishme për risocializim. Puna me familjet është thelbësore për të zhvilluar një kulturë të mirëkuptimit dhe bashkëpunimit ndëretnik, dhe ajo duhet të luajë një rol aktiv në krijimin e narrativeve që ofrojnë një interpretim të moderuar të fesë që do ta parandalonte përhapjen e ideologjisë radikale. Zyrtarët fetarë me ekspertizën dhe reputacionin e tyre kanë një rol vendimtar dhe mund të kenë një ndikim të rëndësishëm në popullatë për t'i shmangur interpretimet alternative fetare dhe për t'i ndjekur mësimet tolerante fetare në kisha, xhami dhe vende të tjera të adhurimit.

Përfaqësuesit e bashkësive kryesore fetare ranë dakord për propozimin që t'u lejohet priftërinjve dhe imamëve të hyjnë në burgje dhe në institucionet e paraburgimit në mënyrë që t'i kryejnë shërbimet fetare siç duhet. Ata propozuan një qasje më liberale ndaj sekularizmit të shtetit, ku udhëheqësit fetarë mund të punojnë më aktivisht me familjet dhe fëmijët, veçanërisht me nxënësit në shkolla në mënyrë që ta ofrojnë mbështetjen që është shumë e nevojshme, dhe të japin përgjigje dhe shpjegime si reagim ndaj radikalizimit. Për këtë qëllim, u kërkua gjithashtu që liderët politikë dhe zyrtarët e tjerë të tregojnë ndjeshmëri ndaj përdorimit publik të simboleve fetare, veçanërisht për shkak të karakterit multikulturor dhe me shumë fe të shoqërisë në Maqedonia e Veriut.

Këshillat e prindërve nuk janë shumë aktivë dhe puna me to duhet të intensifikohet, veçanërisht kur kihet parasysh fakti se as komunitetet e as familjet nuk janë të vetëdijshme për përhapjen e problemit/fenomenit të radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Vetëm përmes njohjes së rolit të rëndësishëm që e luajnë familjet në paralajmërimin e hershëm dhe parandalimin dhe stimulimin e organizatave të qytetarëve që të punojnë ngushtë me prindërit për këtë problem, mund të arrihet zbatimi i misionit parandalues të Këshillit kombëtar.

Organizatave të grave në Tetovë veprojnë si ndërmjetësuese midis institucioneve dhe viktimave, si dhe pjesëtarëve të komunitetit në përgjithësi. Kjo është dëshmuar në fushën e dhunës në familje, ku OShC-të, në koordinim me organizatat e rrjetit të platformës gjinore, angazhohen për të drejtat e viktimave para institucioneve. Për shkak se mësimet relevante për



parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm mund të mësohen nga përvojat e tilla, kapacitetet me të cilat disponon shoqëria civile, veçanërisht organizatat që ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës (gjinore), duhet të përdoren si burim.

### Roli i arsimit

Edukimi ka një rol kryesor në sistemin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, duke ofruar shkathtësi për rezistencë dhe duke shërbyer kështu si një instrument për parandalimin e radikalizimit. Në Tetovë, disa aktivitete që tashmë janë zbatuar nëpër shkolla janë relevante dhe kompatible me parandalimin e radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm. Ato janë Projekti i shkollave të sigurta i OSBE-së; Projekti për bashkëpunim ndëretnik i Nansen-it, Projekti për ndërtimin e urave i OSBE-së dhe projekti i ri që do ta mundësojë bashkëpunimin me prindërit. Aktivitetet e tilla duhet të ndërlihen në mënyrë që mësimdhënësit të jenë të vetëdijshëm se shkathtësitë e fituara përmes projekteve të ndryshme janë relevante dhe të dobishme për parandalimin e radikalizimit.

Radikalizimi parandalohet duke aplikuar mjete kundër diskriminimit dhe përjashtimit të të rinjve, duke pasur parasysh faktin se rinia ka më shumë rrezik që t'i pranojë idetë radikale. Prandaj, komuna planifikon t'i përfshijë të rinjtë në vendimmarrje në shkolla dhe në nivel të komunitetit, me qëllim që të rinjtë të ndihen të përfshirë në shoqëri. Për këtë qëllim, është duke u organizuar trajnim për vendimmarrjen në shkolla, nxënësit i zgjedhin përfaqësuesit e tyre në shoqatat e nxënësve dhe iniciativat e tyre implementohen (siç janë aktivitetet e kohës së lirë, organizimi i ngjarjeve sportive, etj.). Këshilli Rinor i komunës ende nuk është funksional, por pasi të aktivizohet, të rinjtë duhet të përfshihen në marrjen e vendimeve të rëndësishme në nivel komunal. Komuna duhet të bëjë përpjekje shtesë për të siguruar përfaqësues në organet shkollore të nxënësve dhe në Këshillin rinor të komunës, si dhe t'ua shpërndajë vendimet të rinjve që ata i përfaqësojnë.

Për këtë grup të synuar - të rinjtë - pjesëmarrësit në tryezën e rrumbullakët ishin të mendimit se interneti ende mbetet sfidë. Shkollat kanë bllokuar faqe të internetit, por nuk kanë një programi të sigurisë në internet ose politikë të sigurisë elektronike (në internet) që do t'i këshillojë fëmijët se si duhet t'i vlerësojnë në mënyrë kritike përmbajtjet në internet dhe ta ndërtojnë rezistencën e tyre. Përveç kësaj, në Tetovë ende nuk ka filluar ngritja e vetëdijes së prindërve dhe puna e përbashkët me prindërit për ta monitoruar aktivitetin e fëmijëve të tyre në internet. Në përgjithësi, pjesëmarrësit arritën në përfundimin se ekziston një nevojë shumë e madhe për të punuar me

familjet në përmirësimin e të menduarit kritik të fëmijëve të tyre.

Në parim, të menduarit kritik zhvillohet në klasë përmes përmbajtjeve arsimore duke përdorur metoda të ndryshme pedagogjike. Përveç kësaj, pjesëmarrësit i identifikuan aktivitetet jashtë-mësimore si një pikë fillestare për të zbatuar më shumë aktivitete që lidhen me të menduarit kritik. Megjithatë, për shkak të mbingarkesës me aktivitetet e rregullta mësimore, pothuajse asnjëra nga shkollat nuk realizon aktivitete jashtë-mësimore. Duhet të shqyrtohen mundësitë që komuna ta stimulojë realizimin e aktiviteteve jashtë-mësimore. Opsionet e mundshme për këtë përfshijnë sigurimin e fondeve për aktivitete dhe reformën e përgjithshme të sistemit që i përfshin aktivitetet jashtë-mësimore.

Në fund, pjesëmarrësit diskutuan për rolin që e kanë shërbimet pedagogjike dhe psikologjike të fëmijët e shkollës. Ky shërbim profesional shihet si një lidhje e rëndësishme në sistemin e parandalimit nga radikalizimi, pasi që ata mund të punojnë për çdo ditë me nxënësit në rrezik të lartë të përvetësimit të ideve radikale, duke biseduar rregullisht me ta, qoftë individualisht ose duke punuar përmes programeve të terapisë në grup. Është thelbësore që mësimdhënësit dhe punonjësit e shërbimeve profesionale të shkollave të punojnë vazhdimisht me nxënësit asocialë, me ata që kanë qenë problematikë gjatë orëve të mësimin dhe me ata që vijnë nga familjet jofunksionale. Vendosja e një sistemi që do të monitorojë dhe do të raportojë rregullisht për përparimin e tyre është një parakusht për sistemin e ri të parandalimit në nivel komunal. Megjithatë u pranua se roli i shërbimeve pedagogjike dhe psikologjike të shkollave është shumë i rëndësishëm gjatë orëve të mësimin, pjesëmarrësit gjithashtu theksuan se ndikimi i përgjithshëm i tyre është i kufizuar për shkak të mungesës së shërbimeve të tilla mbështetëse pas orëve të mësimin. Kjo veçanërisht ndodh në Tetovë sepse në këtë komunë nuk ka komunitete terapeutike dhe lloje të tjera të grupeve të mbështetjes psiko-sociale.

## Rekomandime

1. Komuna duhet ta përcaktojë burimin e urrejtjes ndëretnike dhe nxitjen e dhunës dhe të planifikojë dhe të zbatojë aktivitete që e parandalojnë përhapjen e urrejtjes ndëretnike dhe nxitjen e dhunës;
2. Këshillat lokale të parandalimit janë detyrim ligjor dhe komuna e Tetovës duhet t'i riaktivizojë ato, por, nuk ka mjete financiare në dispozicion për aktivizimin e KLP-së. Kapërcimi i problemeve me përgjegjësitë dhe financimet që përputhen duhet të zgjidhet në bashkëpunim me qeverinë qendrore;

3. Duke pasur parasysh ndarjen ekzistuese, inkurajimi i socializimit, bashkëpunimit dhe i shkëmbimit pa barriera etnike, duke filluar nga çerdhet, e duke vazhduar me shkollat fillore dhe të mesme, duhet të jetë prioriteti numër një i komunës, në mënyrë që të mundësohet kontakti me, të tjerët në komunitet;
4. Duhet të vendoset monitorimi dhe hartimi i vazhdueshëm i sjelljes së rrezikshme në shkolla, me ç'rast ngritja e vetëdijes dhe trajnimi i mësimitdhënësve, psikologëve dhe i pedagogëve se si ta vërejnë dhe ta parandalojnë radikalizmin është parakusht për këtë;
5. Komuna ka nevojë për një sistem për të reaguar ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Për ta bërë reagimin më efektiv, ky sistem duhet të përbëhet nga një organ koordinues me përfaqësues të të gjitha institucioneve në nivel lokal, si dhe të ketë një model komunikimi midis institucioneve të tilla;
6. Udhëheqësit fetarë kanë rol udhëheqës në promovimin e integritit, bashkëpunimit dhe mospërdorimit të dhunës në Tetovë. Prandaj, ata duhet të përfshihen në mënyrë aktive në parandalimin e radikalizimit që mund të çojë në ekstremizëm të dhunshëm.



Misioni i OSBE-së në Shkup | [osce.org/skopje](https://osce.org/skopje)  
Bulevari 8-mi septemvri nr.16,  
MK-1000 Shkup

[www.osce.org/mission-to-skopje](https://www.osce.org/mission-to-skopje)

Follow OSCE

